



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 419 Akti

Nr. 585 Vendimi
Tiranë, më 8.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 4.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Etleva Gjamo**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 20.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Etleva Gjamo, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Në datën 10.1.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
6. Në datën 17.10.2022 Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Etleva Gjamo për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 28.10.2022 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Po në datën 17.10.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 11 ditëve. Në datën 28.10.2022 subjekti dërgoi në mënyrë elektronike shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.
8. Trupi gjykues, në datën 31.10.2022, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Etleva Gjamo në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 1.11.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 4.11.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Etleva Gjamo u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci

Petkovic. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Etleva Gjamo. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 4.11.2022, për të rifilluar në datën 8.11.2022, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Etleva Gjamo ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 31.8.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Etleva Gjamo, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 30.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga

¹Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 30.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Depozitë bankare me afat 3-mujor, çelur në vitin 2009 në “Union Bank”, dega Korçë, në shumën fillestare 250.000 lekë, gjendja aktuale 309.308 lekë, nga të cilat 59.308 lekë interesa, depozitë e çelur me të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Vlera: 309.308 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie datë 24.1.2017, nga Union Bank, e cila konfirmon se znj. Etleva Gjamo ka depozitë në shumën 309.308 lekë².

17.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga “Union Bank”.*

Hetimi i Komisionit

17.2 Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë depozitë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, me përshkrimin “depozitë me afat 3-mujor (e rinovueshme), çelur në datën 27.7.2009 pranë ‘Union Bank’, dega Korçë (nr. klienti ***), në shumën fillestare 250.000 lekë, nga rroga”.

17.3 Nga korrespondenca e Komisionit me “Union Bank”³ rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 27.7.2009 në vlerën 250.000 lekë dhe për çdo vit ka gjeneruar interesa. Gjendja e kësaj depozite në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting* është në vlerën 309.308 lekë. Totali

² Aneks nr.*** në dosjen e IKDKPKI-së.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2020.

i interesave të përfituara nga viti 2009 (momenti i çeljes së depozitës) deri në datën 30.1.2017 është në shumën 59.308,4 lekë.

17.4 Në tërësi, nga verifikimi i të dhënave të administruara, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga “Union Bank”.

17.5 Njësia e Shërbimit Ligjor, për të konkluduar mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj depozite, kreu analizën financiare (sikurse pasqyrohet në tabelën nr. 1) në datën e çeljes së saj dhe nga përlllogaritjet e kryera i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në çeljen e saj, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	1.1.2009 – 27.7.2009
1	TË ARDHURA	567,812
	Të ardhura nga paga subjekti	567,812
2	SHPENZIME	123,589
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	79,695
	Shpenzime TIMS	43,894
3	PASURI	219,990
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti⁴</i>	219,990
	DIFERENCA (1-2-3)	224,233

17.6 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka deklaruar këtë depozitë në deklaratën *Vetting* 2017 saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka pasur mundësi financiare të investojë në çeljen e kësaj depozite, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

18. Gjendje në “Union Bank” në datën 24.1.2017, në shumën 355.766 lekë, si pagë e patërhequr. Vlera: 355.766 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie datë 24.1.2017 nga “Union Bank”, e cila konfirmon se znj. Etleva Gjamo ka llogari page me gjendje në shumën 355.766 lekë⁵.

18.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Union Bank”.*

18.2 Gjatë hetimit të Komisionit, “Union Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2020, informoi se znj. Elteva Gjamo ka llogari page pranë kësaj banke me gjendje në datën 30.1.2017, kohë kur është depozituar deklarata *Vetting*, në vlerën 355.766,07 lekë.

18.3 Nga dokumentacioni i administruar dhe verifikimi i kryer, trupi gjykues konkludoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Union Bank”.

19. Tokë bujqësore me sipërfaqe 15.790 m², e fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, në F, Devoll, plotësuar AMTP në emër të babait S.Ç, nga e cila është përfituar ¼ pjesë, prej 3.950

⁴ Diferenca e likuiditeteve (bankë dhe *cash*) mes datës 27.7.2009, kur është krijuar depozita, dhe datës 1.1.2009. Gjendja e kursimeve *cash* në datën 27.9.2009 është marrë e njëjtë me atë të fundvitit 2008, konkretisht në vlerën 450.000 lekë.

⁵ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

m² në bashkëpronësi, e pandarë, sipas gjendjes familjare datë 1.8.1991. Pjesa në takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶.

Hetimi i Komisionit

19.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e parë të deklarimit të pasurive në vitin 2003, ka deklaruar në rubrikën “Pjesëtar të familjes me pasuri të regjistruar më vete”, babain e saj S.Ç, me pasurinë truall me sip. 385 m² dhe tokë bujqësore.

19.1.i ZVRPP-ja Devoll⁷, me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2018 (bashkëlidhur informacionit të dhënë), konfirmon se shtetasi S.A.Ç është trajtuar me tokë në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, në z. k. ***, F, me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 15.4.1993, dhe se në kartelat e pasurive të paluajtshme figurojnë të regjistruara pasuritë e poshtëshënuara:

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 2.420 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 2.457 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 3.200 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 3.162 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 2.920 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 2.930 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. *** f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 4.500 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 4.500 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. *** f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 1.000 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 518 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 1.250 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 1.283 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 342 m², sipas AMTP-së nr. ***, s’ka, dhe sipas LN ***, 342 m², z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “pemëtore”, me sipërfaqe totale 200 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN ***, 200 m², z. k. ***, F, Devoll, në emër të z. S.A.Ç.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë + truall”, me sipërfaqe totale 273 m², nga këto 273 m² truall dhe 76 m² ndërtesë, me ref. ***, z. k. ***, F, Devoll.

- Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë + truall”, me sipërfaqe totale 544 m², nga këto 300 m² truall dhe 73 m² ndërtesë, me ref. ***, z. k. ***, F, Devoll.

19.1.ii ASHK Drejtoria Vendore Devoll⁸ nuk konfirmon 3 prej këtyre pasurive, më konkretisht, pasuritë nr. ***, nr. *** dhe nr. ***.

19.1.iii Sipas certifikatës së gjendjes familjare⁹ të vitit 1991, lëshuar nga Njësia Administrative M, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në këtë kohë ka qenë pjesë e trungut familjar dhe, për pasojë, gëzon edhe bashkëpronësinë e barabartë në këto pasuri, në mbështetje të ligjit nr. 7501/1991.

⁶ Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. *** regj., nr. *** akti, datë 15.4.1993; certifikatë familjare; vërtetim datë 24.10.2016, nga ZVRPP-ja Devoll, në të cilën vërtetohen se z. S.Ç ka të regjistruar pasuritë në fshatin F (aneks nr.***në dosjen e ILDKPKI-së).

⁷ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 7.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

19.1.iv Në pyetësin nr. 1 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në kohën e fillimit të detyrës si gjyqtare në datën 1.6.1998 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë ka qenë me banim në rrethin Devoll, fshati F, dhe ka jetuar në banesën pronë e babait të saj S.A.Ç, banesë e ndërtuar prej tij para viteve '90, të cilën e disponon edhe sot. Subjekti, për të provuar këtë fakt, ka depozituar kartelën e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***¹⁰, pasuri e ndodhur në F, Devoll, ku konfirmohet truall me sip. 273 m², nga të cilat 76 m² ndërtesë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se për periudhën mars 2002 – shtator 2007 ka jetuar në qytetin e Korçës në një apartament të ndodhur në bulevardin “****”, p. ***, ***, Lagjja Nr. ***, në pronësi të shtetasës A.F¹¹, me qira në vlerën 8.000 lekë/muaj dhe se qiraja i është paguar qiradhënësit nga babai S.Ç. Subjekti është shprehur se në këtë apartament kanë jetuar të gjithë si familje. Vërehet se kjo adresë rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të kohës.

19.1.v Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni vërejt se dukej se pasuria me nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë + truall” me sipërfaqe totale 273 m², që përfshin edhe ndërtesën 76 m², është e njëjtë me pasurinë e përshkruar më sipër në informacionin e ZVRPP-së Devoll, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2018¹², si pasuri e përfituar nga ligji nr. 7501/1991.

19.1.vi Subjekti është pyetur¹³ lidhur me arsyet e mosdeklarimit të dy ndërtesave të konfirmuara nga ASHK-ja, përkatësisht për ndërtesën me sip. 76 m², ndodhur në pasurinë me nr. ***, dhe për ndërtesën me sip. 73 m², ndodhur në pasurinë me nr. ***, për kostot e ndërtimit, si dhe për burimin e krijimit të tyre, për të cilat ka deklaruar se sipas dokumentacionit të disponuar prej saj dhe të depozituar me deklaratën *Vetting*, vërtetim datë 24.10.2016, i ish-ZVRPP-së Devoll, me nr. rendor ***, pasuria me nr. *** është e regjistruar në vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “arë + truall”, me sipërfaqe totale 273 m² truall dhe 76 ndërtesë me ***. Po sipas të njëjtit vërtetim në nr. rendor *** figuron pasuria me nr. ***, e regjistruar në vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “truall + arë”, me sipërfaqe totale 544 m², 300 m² truall dhe 76 ndërtesë, me reference LN (libri i ngastrave) maj ***, nga akti ***. Subjekti, referuar dokumentacionit që disponon, por edhe origjinës së regjistrimit të tyre (citurar në vërtetimin më sipër), sqaron se pasuria nr. *** përfaqëson shtëpinë e banimit të ndodhur në fshatin F të rrethit Devoll, e cila është ndërtuar nga babai i saj S.Ç rreth vitit 1965, pasi ai ka qenë me profesion *** dhe sipas deklarimeve të tij (është shprehur subjekti), është ndihmuar edhe nga familjarët (i ati dhe vëllezërit). Për të vërtetuar faktin e ndërtimit të banesës në këtë vit, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 28.9.2022, të Bashkisë Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, bashkëlidhur të cilit është edhe procesverbali datë 27.9.2022, i kryetarit të fshatit F, rrethi Devoll, i konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e pushtetit vendor.

19.1.vii Subjekti ka deklaruar se në këtë pasuri nuk ka dhënë asnjë lloj kontributi dhe se nuk tërheq të drejta pronësie/bashkëpronësie në asnjë nga mënyrat e fitimit të pronësisë/bashkëpronësisë të parashikuara në legjislacionin shqiptar.

19.1.viii Subjekti ka sqaruar se fakti që kjo pasuri është regjistruar nga ish-ZVRPP-ja Devoll në emër të babait të saj jo si pasuri personale e tij, por si “përfaqësues i familjes”, nuk e bën automatikisht bashkëpronare dhe, për këtë arsye, nuk ka deklaruar pjesë takuese të pandarë në emër të saj. Subjekti ka depozituar vërtetimin datë 24.10.2016, të ZVRPP-së Devoll, ku krahas tokave bujqësore që janë dhënë për anëtarët e familjes bujqësore sipas gjendjes familjare datë 1.8.1991, figuron edhe kjo ndërtesë dhe trualli i saj.

¹⁰ Akt i lëshuar në datën 16.1.2020 nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Devoll.

¹¹ Deklaratë noteriale e deklarueses A.F, me nr. ***, datë 20.1.2020, e Noterisë Korçë, deklaruar për periudhën mars 2002 – shtator 2007, përcjellë me pyetësin standard.

¹² Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³ Me pyetësin nr. 4, datë 21.9.2022.

19.1.ix Subjekti ka referuar VKM-në Nr. 432 datë 14.5.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonat urbane të fshatit”¹⁴, duke shpjeguar se ky akt nënligjor rregullonte procedurën e regjistrimit fillestar të atyre ndërtesave të banimit të bëra para vitit 1991, sipas së cilës është bërë regjistrimi i banesave në fshat, të cilat mund të kenë edhe pjesë oborri funksional dhe që janë të paregjistruara, për të cilat regjistrimi do të bëhej në bazë të një formulari të emërtuar “lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive”, formular që hartohej nga kryetari i fshatit dhe miratohej detyrimisht nga komuna.

19.1.x Më tej subjekti ka sqaruar se: “Bazuar në këtë akt nënligjor, duke iu referuar AMTP-së nr. ***, datë 15.4.1993, plotësuar në emër të babait tim S.Ç si përfaqësues i familjes, rezulton e pasqyruar toka arë, pemëtore dhe truall, nga të cilat tokë arë 15.790 m² dhe në këtë sipërfaqe nuk është përfshirë trualli i banesës pasqyruar me sip. 400 m² pasi ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’ (neni 3 i tij) parashikonte dhënien në pronësi vetëm të tokës bujqësore, në konceptin e së cilës (neni 1 i ligjit) nuk përfshihen tokat e zëna me ndërtimet e banimit dhe oborret (avllitë) e tyre, të cilat konsiderohen ‘toka jobujqësore’, ndërsa sipas konceptit të nenit 1 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, ‘Për shitblerjen e trojeve’, konsiderohen ‘troje’. Ky fakt evidentohet edhe në ‘vërtetimin nr. *** prot., datë 2.9.2009’ të ish-ZVRPP Devoll, ku konfirmohet se S.A.Ç si përfaqësues i familjes bujqësore ka gjithsej të regjistruara 15.636 m² tokë arë, përfutur nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’.

Banesa e ndërtuar nga babai im ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit F të rrethit Devoll dhe trualli për ndërtim i është dhënë babait tim S.Ç me akt nga pushteti vendor i kohës së ndërtimit, por që në mungesë të këtij dokumentacioni, regjistrimi është bërë me listën *** të trojeve dhe shtëpive. ...referuar dokumentacionit që disponoj, por edhe origjinës së regjistrimit të tyre (cituar në vërtetim),... informoj se pasuria nr. *** përfaqëson shtëpinë e banimit të ndodhur në fshatin F të rrethit Devoll, e cila është ndërtuar nga babai im S.Ç rreth vitit 1965, pasi ai ka qenë me profesion *** dhe sipas deklarimeve të tij, i ndihmuar edhe nga familjarët (i ati dhe vëllezërit). Fakti i ndërtimit të banesës nga babai im në këtë vit konfirmohet edhe nga vërtetimi nr. *** prot., datë 28.9.2022, i Bashkisë Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, bashkëngjitur të cilit është edhe procesverbali datë 27.9.2022, i kryetarit të fshatit F, rrethi Devoll, i konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e pushtetit vendor”.

19.1.xi Sa i takon pasurisë nr. ***, e cila është e regjistruar në vol. ***, f. ***, lloji “truall + arë”, me sipërfaqe totale 544 m², 300 m² truall dhe 73 ndërtesë, me referencë LN maj ***, nga akti nr. ***, subjekti ka sqaruar se nga shpërbërja e pasurisë së ish-Kooperativës Bujqësore F, Devoll, babai së bashku me vëllezërit e tij N dhe N.Ç me “kontratë noteriale shitblerje” nr. ***, datë 10.1.1992, kanë blerë një objekt të emërtuar “zyrat e ish-kooperativës”, i formës 2 KT, me sipërfaqe ndërtimore 225 m², sipërfaqe e pandërtuar 915 m², kundrejt vlerës 69.000 lekë (paguar në datën 15.12.1991), e cila është regjistruar fillimisht në Zyrën e Hipotekës Korçë, ndërtesë e cila sot është pothuajse e rrënuar. Subjekti ka sqaruar se sipas shpjegimeve të babait të saj, referuar edhe vendndodhjes së objektit, por edhe përmbajtjes së kontratës dhe skicës bashkëngjitur, rezulton se kjo ndërtesë ka qenë e ndërtuar jashtë vijave kufizuese të fshatit dhe në kohën e ndarjes së tokës bujqësore dhe plotësimit të AMTP-ve oborri përreth saj është ndarë nga ish-Komisioni i Ndarjes së Tokës si tokë “arë”, duke ju dhënë babait (dhe vëllezërve të tij) nga 300 m² tokë në pronësi, e cila edhe në AMTP-në nr. ***, datë 15.4.1993, plotësuar në emër të babait S.Ç, figuron: Vendi ku ndodhet ngastra “zyrat”, lloji i pasurisë

¹⁴ 1) Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në zonën urbane të fshatit, komuna ose bashkia i kërkon pronarit dokumente të pronësisë sipas kriterëve të përcaktuara në ligj për pronësinë e ndërtesave dhe trojeve në këtë zonë; (2) madhësia e sipërfaqes së truallit në pronësi të pronarit të ndërtesës që ka kryer ndërtimin mbetet ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7633, datë 7.4.1993, “Për urbanistikën”; (3) dokumentacioni i azhurnimit për pasuritë e paluajtshme të zonës urbane të fshatit sipas formularit që i bashkëngjitet këtij vendimi vihet në dispozicion të komunës, miratohet nga ky organ dhe bëhet regjistrimi i kësaj pasurie.

tokë arë dhe sip. 300 m². Për këtë arsye regjistrimi i tokës ka referencë LN. maj ***, nga akti nr. ***.

19.1.xii Subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: “...edhe në blerjen e kësaj pasurie nuk kam dhënë asnjë lloj kontributi, pasi kam qenë në shkollë dhe nuk tërheq të drejta pronësie/bashkëpronësie në asnjë nga mënyrat e fitimit të pronësisë/bashkëpronësisë të parashikuara në legjislacionin shqiptar. Fakti që edhe kjo pasuri (ndërtesë) është regjistruar në emër të babait tim (në 1/3 pjesë të saj) jo si pasuri personale e tij, por si përfaqësues i familjes, nuk më bën automatikisht pronare/bashkëpronare dhe për këtë arsye nuk kam deklaruar pjesë takuese të pandarë në emrin tim, por kam depozituar vërtetimin datë 24.10.2016, të ZVRPP-së Devoll, ku krahas tokave bujqësore që janë dhënë për anëtarët e familjes bujqësore sipas gjendjes familjare datë 1.8.1991, figuron edhe kjo ndërtesë, si dhe shtëpia e banimit. Sa i takon tokës bujqësore prej 300 m² në ‘zyrat’, është pjesë e totalit të tokës së dhënë në pronësi familjes ku kam përfutuar edhe unë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’ dhe kam bërë deklarimin përkatës”. Subjekti ka depozituar disa dokumente¹⁵.

19.1.xiii Komisioni, në gjendjen që ndodheshin aktet, konstatoi se: (a) origjina e këtyre dy pasurive është ligji nr. 7501/1991, sipas AMTP-së dhe lista e trojeve *** plotësuese e këtij ligji për ndërtimet përpara vitit 1991; (b) qëllimi i zbatimit të ligjit nr. 7501/1991 kushtëzohet me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.8.1991, kohë në të cilën subjekti ka qenë pjesë përbërëse e trungut familjar; (c) regjistrimi i pasurisë me sip. 76 m² është bërë në emër të z. S.GJ, por si kryefamiljar i familjes bujqësore (me status F); dhe se (ç) nuk pasqyrohet se në emër të kujt është regjistruar pasuria me sipërfaqe ndërtimore 73 m².

19.2 Nën këto konstatime, me gjithë shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të vijonte dhënien e shpjegimeve dhe të depozitonte dokumentacion mbështetës, pasi dukej se: (i) nuk ishin deklaruar në deklaratën *Vetting* ndërtesa me sip. 76 m² ndërtuar në pasurinë nr. ***, zëri kadastral “arë + truall”, në fshatin F, Devoll, dhe ndërtesa me sip. 73 m², ndërtuar në pasurinë nr. ***, zëri kadastral “arë + truall”, me ref. ***, fshati F, Devoll; (ii) ishin të paqarta investimet e kryera ndër vite, si dhe kontributi i subjektit në pasurinë nr. ***, ku ndodhet ndërtesa me sip. 76 m² dhe për këtë subjektit i është kërkuar të paraqesë edhe foto të ambienteve brenda e jashtë banesës, si dhe të qartësonte statusin e tri pasurive, përkatësisht me nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, të cituara më sipër në pikën (19.1.ii), pasi nga hetimi rezultoi se ASHK Zyra Vendore Devoll¹⁶ nuk kishte paraqitur informacion.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

19.3 Në parashtrimet e saj subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe depozituar dokumentacionin mbështetës, si vijon:

19.3.i Subjekti ka deklaruar se i qëndron pretendimit të saj se nuk tërheq të drejta pronësore mbi ndërtesën e ndërtuar përpara vitit 1991 nga babai i saj.

19.3.ii Subjekti thekson se nuk ka fituar ndonjë të drejtë me një nga mënyrat e fitimit të pronësisë të parashikuara në Kodin Civil apo në ligje të veçanta.

19.3.iii Subjekti ka deklaruar se nuk është sjellë asnjëherë si bashkëpronare, nuk ka kryer veprime me këtë pasuri, përveçse ka jetuar në atë banesë me familjen e origjinës.

¹⁵ Vërtetim datë 24.10.2016, i ish-ZVRPP Devoll (2 fletë); listë emërore e trojeve dhe shtëpive, fshati F (2 flete); kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 10.1.1992, së bashku me skicën planimetricke (2 fletë); Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 15.4.1993, me emër të z. S.Ç; vërtetim nr. *** prot., date 2.2.2009, i ish-ZVRPP Devoll; fotografi e gjendjes aktuale të banesës në fshatin F; fotografi e gjendjes aktuale të ndërtesës së ish-Zyrave të Kooperativës (2 copë); vërtetim nr. *** prot., datë 28.9.2022”, i Bashkisë Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, bashkëngjitur të cilit është edhe procesverbal i datë 27.9.2022, i kryetarit të fshatit F, rrethi Devoll, i konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e pushtetit vendor, si dhe fotografi të objekteve (praktika e plotë përmban 7 fletë).

¹⁶ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 7.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

19.3.iv Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri ka si origjinë VKM-në Nr. 432/1995, “Për procedurat e regjistrimit të ndërtimeve në zonën urbane të fshatit”, si dhe ka vijuar të referojë ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën” (neni 3 i tij), ku parashikohet dhënia në pronësi vetëm e tokës bujqësore, konceptin e nenit 1 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, si dhe vendimin unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, të Gjykatës së Lartë, tek i cili bazohet në qëndrimin e saj. Ajo ka sqaruar se edhe përgjatë ushtrimit të detyrës së saj në të tilla raste gjykimi ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse është shprehur edhe ASHK-ja në informacionin e saj. Subjekti ka depozituar dy vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë¹⁷.

19.3.v Në lidhje me mosdeklarimin e banesës së ndërtuar në fshatin Fitore në deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar informacionin e marrë nga ASHK Drejtoria Vendore Korçë¹⁸.

19.3.vi Në lidhje me ndërtesën ish-zyrat e kooperativës, subjekti, në prapësimet e saj ka deklaruar:

a) Kjo pasuri është blerë nga babai së bashku me dy vëllezërit e tij, bazuar në VKM-në Nr. 266, datë 8.8.1991, “Për ndarjen e pasurisë në kooperativat bujqësore” dhe se pjesa takuese është 1/3 secili. Subjekti ka theksuar se pasuria është blerë me kontratë shitblerjeje para noterit dhe se duke mos qenë palë blerëse në kontratë, nuk mund të tërheqë asnjë lloj të drejte në objektin e shitur. Ajo ka deklaruar se asnjëherë nuk ka pasur as cilësinë e “anëtarit të kooperativës” që të kishte të drejta për të përfutur falas nga shpërndarja e pasurisë. Prona e blerë në bazë të këtij akti nënligjor është vetëm pronë individuale e blerësit dhe, për këtë arsye, duhet të regjistrohet në emrin e tij personal nga ZVRPP-ja.

b) Subjekti ka depozituar vendimin nr. 164, datë 25.2.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për të cilin ka shpjeguar se standardizohet detyrimi i ZVRPP-së për të regjistruar ndërtesën në favor të individit që ka blerë pasurinë, që në këtë rast gjykimi, sipas vendimit, objekti ka qenë mensë.

c) Në lidhje me gjendjen aktuale faktike të pasurisë ish-zyrat e kooperativës, subjekti ka sqaruar se kjo pasuri është drejt rrënimin dhe për këtë ka depozituar edhe foto të objektit.

ç) Sa i takon gjendjes juridike të tri pasurive, ku përfshihet edhe ndërtimi i ish-zyrave të kooperativës, subjekti ka vënë në dispozicion “informacion zyrtar të pasurisë”¹⁹ të ASHK-së Devoll, duke sqaruar se sipas këtij informacioni nuk konfirmohen ndryshime mbi gjendjen juridike të tyre.

d) Subjekti, në qëndrimin e saj, dhe në seancën dëgjimore ka parashtruar se nuk e ka pasur të mundur të vihet në lëvizje pas informacionit të ASHK-së Zyra Vendore Korçë për të kërkuar rregullimin e regjistrimit të pasurisë në ASHK, pasi i ati ka ndërruar jetë në datën 8 tetor 2022 dhe nuk është bërë çelja e trashëgimisë.

19.3.vii Në lidhje me investimet në shtëpinë e ndërtuar në fshatin Fitore përpara vitit 1991, subjekti ka parashtruar se me sa mban mend janë kryer vetëm shpenzime të karakterit të mirëmbajtjes në funksion të sigurimit të kushteve normale të banimit. Sipas informacionit të marrë nga prindërit kjo shtëpi ka qenë e ndërtuar prej vitit 1965 dhe nuk ka pësuar asnjë ndryshim në strukturën e saj (shtesa anësore apo shtesa kati në lartësi). Sipas subjektit, ajo ka jetuar në një përbërje familjare me prindërit, vëllain, bashkëshorten dhe fëmijën e tij dhe se nga momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe realizimit të të ardhurave, ka kontribuar me pagën e saj për të përballuar shpenzimet e jetesës. Në vijim ka deklaruar se *në këtë shtëpi nuk ka dhënë asnjë kontribut personal që të mund të vlerësohet, pasi shtëpia ka qenë dhe vijon të*

¹⁷ Vendim nr. ***, datë 13.6.2012, dhe nr. ***, datë 25.10.2013, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shkresë nr. *** ap., datë 20.10.2020, dhe informacioni i dhënë nga Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes me shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2022.

¹⁹ Shkresë nr. *** ap., datë 10.10.2022.

jetë ekzistuese, se me kalimin e viteve në këtë shtëpi kanë vepruar faktorët atmosferike (lagështira nga themelet për shkak se objekti është në kuotën 00 nga toka), se nga ana e vëllait, siç ai e ka informuar, e vetmja ndërhyrje që është bërë para 5 vitesh, por e konstatuar edhe prej saj, është vendosja e dritareve me grila dhe ndërrimi i derës së jashtme në katin e parë dhe derës së ballkonit në katin e dytë për të penguar veprimin e mëtejshëm të faktorëve atmosferikë. Subjekti ka depozituar:

- foton aktuale të shtëpisë për të pasqyruar gjendjen e saj të jashtme dhe të brendshme;
- aktvlerësimin mbi gjendjen teknike të objektit banesë 2-katëshe;
- kontratën e furnizimit me energji elektrike për këtë ndërtesë dhe njëkohësisht edhe printimet e faturimeve përkatëse, të cilat datojnë prej majit të vitit 2007.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

19.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorë dhe prapësime, si dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson dhe arsyeton si vijon:

19.4.i Në tërësi, nga hetimi i kryer në lidhje me origjinën e pasurisë objekt i këtij hetimi administrativ, bazuar në certifikatën e përbërjes familjare datë 1.8.1991²⁰, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është anëtare e familjes bujqësore në përputhje me kriteret përcaktuese për të qenë përfitues i pasurisë së përkrahur në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr. ***, datë 15.4.1993, sipas ligjit nr. 7501/1991. Në këto kushte, konkludohet se subjekti ka deklaruar me saktësi pjesën e saj takuese në pasurinë me sip. 15.790 m², përfituar sipas kësaj AMTP-je²¹.

19.4.ii Në lidhje me ekzistencën e dy objekteve të ndërtuara në pasurinë e lartpërmendur, origjinën e fitimit të tyre, kontributin e dhënë në këto investime, marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me to, si dhe konstatimin e mosdeklarimit të tyre në deklaratën për *Vetting*, provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit, parë në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm, pasqyruan rrethanat faktiko-ligjore, sikurse do të arsyetohet në vijim:

19.4.iii Nga verifikimi i AMTP-së rezultoi se në këtë sipërfaqe toke të deklaruar nga subjekti përfaqësohet edhe sip. 300 m², e cila përkon me pasurinë e përkrahur “zyrat”.

Nisur nga dokumentacioni i depozituar u provua se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes nr. ***, datë 10.1.1992²², lidhur midis Kooperativës Bujqësore F dhe shtetasve N, N dhe S.Ç (babai i subjektit të rivlerësimit), të gjithë vëllezër me njëritjetrin, pasuri e cila e është regjistruar në hipotekë me nr. ***, datë 28.2.1994. Realizimi i kontratës së kësaj pasurie është rezultat i qenies së babait të subjektit të rivlerësimit ish-punonjës i ish-kooperativës bujqësore.

19.4.iv Nisur nga origjina e fitimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konkludon se përjashtohet çdo dyshim i arsyeshëm ndaj subjektit për të pasur titull pronësie në të.

19.4.v Sa i përket zhvillimit ndërtimor të kësaj pasurie vërehet se fotografimet dhe verifikimet e kryera në terren, të konfirmuara me procesverbalin datë 27.9.2022, mbajtur nga kryeplaku i fshatit F, nga prezenca e përfaqësuesit të Bashkisë Devoll dhe administratorit, si dhe informacioni i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të kësaj Bashkie²³, pasqyrojnë gjendjen e rrënuar të zyrave, nga ku duket se nuk ngrihen dyshime për ndonjë investim të mundshëm nga ana e subjektit. Në tërësi për këtë pasuri, trupi gjykues nuk evidenton ndonjë

²⁰ Lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njesisë Administrative M, në datën 24.01.2017, administruar në Dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Përcjellë me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 21.9.2022.

²³ Nr. *** prot., datë 28.9.2022, përcjellë nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 21.9.2022.

problematikë që ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të saktë dhe të plotë.

19.4.vi Në lidhje me ndërtesën dy kate, shtëpi, e deklaruar nga subjekti në pyetësin nr. 1 (standard) se ka jetuar aty së bashku me familjen e saj të origjinës deri në vitin 2002, prej ku edhe janë shpërngulur për të jetuar në qytetin e Korçës me qira²⁴, për të cilën, gjithashtu, rezultoi gjatë hetimit se subjekti nuk e ka deklaruar pjesën e saj takuese në deklaratën *Vetting*, dokumentacioni i administruar²⁵ konfirmoi që ndërtimi është kryer rreth vitit 1965, kohë kur subjekti ende nuk kishte ardhur në jetë²⁶. Nga informacioni i pasqyruar dhe verifikimi i kryer në terren²⁷ për këtë pasuri informohet se ajo ka qenë ndërtuar me mur balti rreth vitit 1965, me sipërfaqe ndërtese 76 m², në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit dhe se kjo ndërtesë është e pabanueshme. Konfirmimet institucionale janë bashkëshoqëruar edhe me fotografime të pasurisë nga terreni. Në harmoni me aktet e administruara është edhe akteksperimenti mbi gjendjen teknike të objektit, i përgatitur²⁸ nga një ekspert vlerësues i licencuar²⁹, i cili, gjithashtu, nga të dhënat e grumbulluara dhe përpunuara, ka konkluduar dhe rikonfirmuar se ndërtimi është i para viteve 1970 dhe se ndërtesa është e pabanueshme. Edhe nga verifikimi i kontratës së furnizimit me energji elektrike për këtë objekt, duket se ka faturime vetëm për tarifa shërbimi dhe jo konsum real të energjisë. Nën këto fakte dhe rrethana, si dhe duke mbajtur në konsideratë deklaramin e subjektit që në pyetësin standard se ajo dhe familja e saj e origjinës kanë jetuar prej vitit 2002 me qira në qytetin e Korçës, pra janë shpërngulur nga kjo ndërtesë, bëhet bindës deklarami i subjektit se ajo nuk ka kontribuar në këtë ndërtesë.

19.4.vii Nga ana tjetër, parë në kontekstin e mënyrës se si është krijuar pasuria/ndërtesa, si dhe lidhjen e subjektit të rivlerësimit me këtë objekt, për të deklaruar bashkëpronësinë, provat dhe faktet tregojnë se edhe një vlerësim i trupit gjykues për deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* çmohet i paqëllimshëm dhe pa efekt në procesin e rivlerësimit. Ky konkludim i trupit gjykues është rrjedhojë e fakteve provuese, të tilla si: (a) rezultoi se ndërtesa është regjistruar në listën emërore (***)³⁰ të pronarëve të trojeve dhe shtëpive në numrin rendor ***, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit; (b) vërtetimi i ZVRPP-së Devoll³¹, ndër të tjera, konfirmon se babai i subjektit të rivlerësimit si përfaqësues i familjes bujqësore ka gjithsej të regjistruar 15636 m² tokë arë, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, dhe 273 m² truall, nga e cila 76 m² janë ndërtesë, ndodhur në fshatin F; (c) ky akt konfirmues që veçon pasurinë e përfituar nga ligji nr. 7501/1991 me pasurinë truall daton prej vitit 2009 dhe qartëson pozitën e përfituesit sipas ligjit të kohës për tokën bujqësore, tek e cila nuk rezulton të përfshihet, gjithnjë sipas objektit dhe fokusit të këtij ligji, edhe zëri kadastral “truall”; (ç) provohet se regjistrimi i pasurive të kësaj natyre është kryer përmes VKM-së Nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, që kishte si qëllim regjistrimin e pasurive të pasqyruara në listën e trojeve, pasi ky akt normativ ka shërbyer si një mjet për të legalizuar ndërtimet para viteve 1991. Por, pavarësisht se ndërtimi ka veshur me pronësi një individ, babain e subjektit të rivlerësimit, rezultoi se regjistrimi i pasurisë është bërë

²⁴ Sikurse subjekti ka deklaruar në pyetësin standard, por edhe referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 20.1.2020, përcjellë me këtë pyetësor.

²⁵ Referuar shkresës nr. ***3 prot., datë 28.9.2022, të Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Devoll, procesverbalit datë 27.9.2022, mbajtur nga kryeplaku i fshatit F, prezenca e përfaqësuesit të Bashkisë Devoll, administratori, si dhe fotove, akte të përcjella me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 21.9.2022.

²⁶ Subjekti, sipas regjistrimit të gjendjes civile, rezulton e datëlindjes 1972.

²⁷ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 28.9.2022, të Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Devoll, përcjellë me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 21.9.2022.

²⁸ Datë 24.10.2022, i përcjellë me prapësimet nga subjekti i rivlerësimit.

²⁹ Me licencë ***, dhënë z. H.H nga Ministria e asaj kohe e Punëve Publike dhe Turizmit.

³⁰ Administruar në praktikën e Zyrës Vendore të ASHK-së Devoll, me nr. *** prot., datë 7.2.2020, si dhe depozituar nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 21.9.2022.

³¹ Nr. *** prot, datë 2.2.2009, përcjellë nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 21.9.2022.

nën statusin “F”³² dhe për sa kohë statusi juridik i pronës ka mbetur i tillë duket se ka impaktuar pozitën e subjektin për të deklaruar këtë fakt.

19.4.viii Në mbështetje të faktit që pasuritë, pjesë e listës së trojeve në fshat i atribuohen individit që i ka përfituar e ndërtuar ato, apo edhe bashkëshortit/es për shkak të regjimit pasuror, në raport me regjistrimin e tyre, nën statusin “F”, është informacioni i dhënë nga autoriteti përgjegjës³³, ku Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë shprehet se *pasuria “truall” nuk ka qenë objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, trojet dhe objektet mbi to në zonën urbane të fshatit janë regjistruar pranë ish-ZVRPP-ve, sot Drejtoritë Vendore të ASHK-së, sipas listave të trojeve me referencë ***, referuar VKM-së Nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.* Pronarë legjitim të këtyre pasurive janë individët të cilët janë përcaktuar në listat e trojeve, si dhe individët sipas regjimit pasuror martesor, referuar dispozitave të Kodit të Familjes.

19.4.ix Nga analizimi i burimit të krijimit të pasurive nuk u provua ndonjë kontribut i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si në pasurinë e ndodhur në zërin kadastral “zyrat” dhe as në banesën dykatëshe/shtëpi e ndërtuar prej vitit 1965, për më tepër kur u provua se ato rezultojnë të rrënuara apo teknikisht të pabanueshme dhe të dëmtuara nga kushtet atmosferike.

19.4.x Në kontekstin e përgjithshëm të hetimit të kësaj pasurie objekt hetimi, arrihet në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasuritë për të cilat tërheq të drejta pronësore sipas objektit të ligjit nr. 7501/1991.

19.4.xi Ndërsa, në mënyrë të veçantë për pasurinë nr. ***, mbi të cilën është ndërtuar shtëpia dykatëshe, për të cilën subjektin iu kalua edhe barra e provës, trupi gjykues çmon se pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për mosdeklarim të pjesës takuese se nuk tërheq të drejta pronësore, duke qenë se pasuria vazhdon të figuronte e regjistruar në emër të babait të saj si kryefamiljar i familjes bujqësore, subjekti mund të kishte deklaruar statusin aktual të kësaj pasurie në raport me pozitën e saj. Por, ky konstatim në raport me mungesën e kontributit të subjektit në këto pasuri, mënyrën e përfitimit sipas ligjit nr. 7501/1991, depozitimin e dokumentacionit prej saj me deklaratën *Vetting*, konfirmimet institucionale nga ASHK-ja, pavarësisht qasjes ligjore të subjektit mbi zbatimin e këtij ligji, edhe në eventualitetin e një pasaktësie, çmohet nga trupi gjykues se subjekti nuk ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit për të kryer deklarim të saktë dhe të plotë.

19.4.xii Në lidhje me qartësimin e statusit të tri pasurive, përkatësisht me nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, për të cilat ASHK Zyra Vendore Devoll³⁴ nuk kishte paraqitur informacion, kjo e fundit³⁵ ka rikonfirmuar se nuk ka ndryshime mbi gjendjen juridike të tyre, sikurse ka informuar më parë me vërtetimin e datës 24.10.2016³⁶, pra nuk ka tjetërsime të tyre. Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk krijon dyshime për vijueshmërinë e ekzistencës së këtyre pasurive në emër të babait të subjektit të rivlerësimit si kryefamiljar i familjes bujqësore.

20. Apartament banimi me sip. 60 m², në përdorim, me nr. pasurie ***, ndodhur në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, p. ***, Korçë, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pronësi të bashkëshortit. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Shtesë apartamenti me sip. 109.8 m², në përdorim, me nr. pasurie ***, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, p. ***, Korçë, në pronësi të bashkëshortit. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Komisioni ka vlerësuar t’i trajtojë

³² Referuar kartelës së pasurisë e administruar në praktikën e Zyrës Vendore të ASHK-së Devoll, me nr. *** prot., datë 7.2.2020, depozituar nga subjekti me pyetësorin standard.

³³ Depozituar nga subjekti në prapësime, shkresë nr. *** ap., datë 20.10.2022, së cilës i është bashkëngjitur shkresa me nr. *** prot., datë 20.9.2022.

³⁴ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 7.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁵ Shkresë nr. *** ap., datë 10.10.2022, përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në prapësime.

³⁶ Administruar në aneksin nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

këto pasuri në vijim në këtë vendimmarrje, konkretisht tek deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

20.1 Gjithashtu, Komisioni ka trajtuar tek deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje edhe “të ardhurat e deklaruara nga subjekti”, të kursyera nga paga si gjyqtare dhe të ardhurat nga puna e bashkëshortit si noter, gjendje *cash* të paregjistruara në shumën 1.000.000 lekë, në pjesë takuese 50% me bashkëshortin.

Detyrime financiare

21. Kontratë nr***, datë 5.10.2012, për kredi bankare afatgjatë e marrë me bashkëshortin në shumën 10.000.000 lekë, me interes 7.88% në vit, me afat shlyerjeje 144 muaj, pranë “Societe Generale Albania Bank”, me këst aktual 95.075,87 lekë (siguruar me hipotekë). Detyrimi i mbetur: 7.196.601 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁷.

Hetimi i Komisionit

21.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, me përshkrimin “kredi bankare afatgjatë, marrë me bashkëshortin për blerje shtëpie në shumën 10.000.000 lekë, interes 7.88%, afat 144 muaj, datë 5.10.2012”.

21.2 Bashkëshorti i subjektit, në deklaratën e tij po në vitin 2012, në rubrikën e detyrimeve financiare deklaroi kredinë e marrë në shumën 10.000.000 lekë me të njëjtin përshkrim si edhe subjekti i rivlerësimit. Ndërsa në rubrikën e të dhënave konfidenciale ai e përshkruan në mënyrë të detajuar këtë kredi, qëllimin e saj dhe se ku është përdorur. Më konkretisht, ai ka deklaruar: *“Bashkëpronësi në pasurinë truall + ndërtesë (e cila funksionon si karburant) në Bilisht, pasuria nr. *** dhe pasuria nr. ***, z. k. ***, bashkëpronar E.G, banues në Tiranë. Kredia e marrë me bashkëshortin nuk është përdorur për blerje shtëpie, por është parapaguar tërësisht shitësit N.K në shumën 9.800.000 lekë për blerjen e këtyre dy pasurive (transfertë ‘ProCredit Bank’, Korçë, datë 11.10.2012. Diferenca e vlerës së parapaguar për pjesën tjetër të pasurisë për të cilën nuk është formalizuar shitja brenda datës 31.12.2012 për shkak të gjendjes së regjistrimit). Deklaratë noteriale e bashkëpronarit E.G për shlyerje të kredisë ndaj bankës nr. ***, datë 15.10.2012”.*

21.3 Nga korrespondenca e Komisionit me OTP Bank³⁸ (ish-Societe Generale Albania Bank) konfirmohet kredia e marrë në datën 10.10.2012 në vlerën 10.000.000 lekë. Së bashku me informacionin e dhënë, OTP Bank ka depozituar edhe dokumentacion përkatës për përfitimin e kësaj kredie.

21.4 Nga verifikimi i *statement*-it konfirmohet detyrimi i mbetur deri më 30.1.2017, i cili është në vlerën 7.196.601 lekë.

21.5 Trupi gjykues, duke iu përmbajtur hetimit të kryer për deklarimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në rubrikën “detyrime financiare”, konstaton se të dhënat e pasqyruara në dokumentacionin bankar të OTP Bank përputhen me deklarimin, sa i takon shumës së kredisë së disbursuar 10.000.000 lekë, si dhe vlerës së mbetur pa u shlyer nga kjo kredi deri në datën

³⁷ Kontratë kredi bankare afatgjatë për shtëpi, me nr. ***, datë 5.10.2012, në “Societe Generale Albania Bank”, në emër të J.GJ dhe Etleva Gjamo dhe dorëzues J.GJ, të kredisë në shumën 10.000.000 lekë; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 5.10.2012; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 5.10.2012; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 5.10.2012, me hipotekues J.GJ, barrë siguruuese pasuri nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji apartamentit me sip. 86.95 m²; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 5.10.2012, me hipotekues J.GJ, barrë siguruuese pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji apartamentit me sip. 69.63 m², Bilisht, në emër të J.GJ; certifikatë për vërtetim pronësie nr.***, datë 7.12.2011; harta treguese; kartela e pasurisë së paluajtshme; plan amortizimi i kredisë bankare datë 26.1.2017; konfirmim bankar nr.*** prot., datë 23.1.2017, nga “Societe Generale Albania Bank”, në emër të J.GJ dhe Etleva Gjamo, ka marrë kredi në shumën 10.000.000 lekë, me detyrim financiar të mbetur në vlerën 7.196.601 lekë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.10.2012, aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2020.

e dorëzimit të deklaratës *Vetting* dhe, për pasojë, konkludon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi detyrimin financiar.

21.6 Trupi gjykues, pavarësisht konstatimit se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, me përshkrimin “...shtetasi E.G bashkëpronar me bashkëshortin. Marrje përsipër e shlyerjes së ½ së kredisë. ‘***’ sh.p.k., me ortak të vetëm E.G. Bashkëpronar me bashkëshortin. Marrje me qira e pjesës së bashkëshortit në pasurinë nr. ***, Bilisht. J.GJ, vëllai i bashkëshortit. Vendosi hipoteke e pronës si garanci për shlyerjen e kredisë së marrë me bashkëshortin”, në kushtet që rezultojnë se ky deklarim ndërlidhet me veprime vijuese të ndërmarra nga bashkëshorti i saj, hetimin dhe arsyetimin e kësaj çështjeje e ka trajtuar në vijim në këtë vendim dhe, për rrjedhojë, çmon të mos bjerë në përsëritje.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit

22. Apartament banimi me sip. 60 m², me nr. pasurie ***, me adresë: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, p. ***, Korçë, blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.10.2006, së bashku me një shtesë informale³⁹ të ndërtuar nga shitësi, aplikuar për legalizim nga blerësi, pasuri e blerë me të ardhurat nga puna dhe kontributi i prindërve nga pensionet e marra në shtetin grek si homogjenistë për vitet 2003 – 2012. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁰.

Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi si vijon:

22.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010⁴¹, ka deklaruar apartament banimi me sip. 60 m², blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.10.2006, në vlerën 1.000.000 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit.

22.2 ASHK Drejtoria Vendore Korçë⁴² konfirmon se në emër të z. J.GJ.GJ figuron pasuria apartament me sip. 60 m², nr. ***, vol.***, f. ***, z. k. ***, Korçë. Nga aktet e përcjella nga kjo drejtori, rezultojnë e administruar kontratë shitjeje (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 26.10.2006, me palë shitëse B.D dhe palë blerëse J.GJ, për pasurinë apartament me sip. 60 m², në Korçë, me vlerën 1.000.000 lekë.

22.3 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat nga puna dhe kontributi i prindërve nga pensionet e marra në shtetin grek si homogjenistë për vitet 2003 – 2012.

22.4 Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare mbi të dhënat e grumbulluara nga aktet e administruara në dosje, për periudhën kohore 1995 – tetor 2006, kohë kur edhe është blerë pasuria⁴³, për të verifikuar mundësitë financiare të bashkëshortit të subjektit për të investuar në këtë pasuri.

22.4.i Gjatë hetimit⁴⁴ rezultoi se bashkëshorti i subjektit është administrator i subjektit “J.GJ” person fizik, i vetëpunësuar i vetëm për periudhën 24.8.2005 e në vazhdim. Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim DRT) Korçë ka përcjellë informacion lidhur me fitimin e realizuar për vitet

³⁹ Kjo pasuri rezultoi të jetë blerë përpara martesës ligjore së subjektit të rivlerësimit.

⁴⁰ Certifikatë për vërtetimin pronësie datë 27.10.2006, në emër të z. J.GJ, për apartament me sip. 60 m², nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, rruga “****”, p. ***, Korçë; kontratë shitje (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 26.10.2006, me palë shitëse B.D dhe palë blerëse J.GJ, të apartamentit me sip. 60 m², në Korçë, me vlerën 1.000.000 lekë (mënyra e pagesës është e menjëhershme); deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.1.2015, deklaruesit GJ.GJ dhe T.GJ janë përfitues të pensioneve të akorduara nga shteti grek dhe me rastin e martesës së djalit J.GJ i kanë dhuruar shumë më 25.000 euro; fletë informacioni e pensioneve në emër të shtetasve GJ.GJ dhe T.GJ, në datën 1.6.2011, në shumë më 345 euro, dokumentacion në gjuhën greke (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴¹ Vit në të cilin bashkëshorti i subjektit është bërë person i lidhur për shkak të martesës ligjore në datën 24.5.2010.

⁴² Shkresë nr.*** prot., datë 6.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³ Blerja e pasurisë daton 4 vite përpara martesës me subjektin e rivlerësimit.

⁴⁴ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.2.2020, të DRT-së Korçë.

2009 – 2018. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, subjekti ka deklaruar se prej vitit 2005 ai ka punuar si noter.

22.4.ii Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 13.7.2022, subjekti ka depozituar vërtetimin⁴⁵ nga Bashkia Devoll, i cili vërtetoi se subjekti “J.GJ” me NIPT *** ushtron aktivitetin në qytetin e Bilishtit nga data 24.8.2005 me veprimtari “***”, i klasifikuar në xhiron 2-3 milionë dhe ka paguar shumën 43.000 lekësh në vit për periudhën 2005 – 2010.

22.4.iii Meqenëse Komisioni administroi informacion për fitimin e realizuar pas vitit 2009, vlerësoi që të përlllogarisë fitimin për vitet 2005 – 2008, duke u bazuar në mesataren e përqindjeve të fitimit për vitet që ka informacion, pra për periudhën 2009 – 2021⁴⁶. Kjo përqindje rezultoi rreth 50%. Ndërsa për xhiron ka vlerësuar të marrë fiks fitimin për vitet 2005 – 2008 në vlerën 2.500.000 lekë, si një mesatare e klasifikimit 2-3 milionë.

22.4.iv Për të ardhurat e prindërve të përfituara nga pensioni në shtetin grek, subjekti ka depozituar në ILDKPKI⁴⁷ (sipas procesverbalit të mbajtur në datën 10.2.2015) dhe në deklaratën *Vetting* vërtetim pensioni përmbledhës për vitet 2005, 2008, 2010 dhe 2011.

22.4.v Gjatë hetimit subjekti ka depozituar mandate postare⁴⁸, që pasqyrojnë pagesën e pensionit për secilin nga prindërit e bashkëshortit. Nga verifikimet përkatëse të mandateve postare të depozituara duket se nuk janë ruajtur të gjitha (edhe për shkak të kohës së largët), pasi nuk pasqyrohen të gjithë muajt, por meqenëse pensioni është një e ardhur e përmuajshme dhe për sa kohë ekzistojnë prova të mjaftueshme që pasqyrojnë se është marrë pensioni i muajit apo vitit pasardhës, Komisioni ka vlerësuar t'i përlllogarisë edhe muajt për të cilët nuk disponohet mandati në vlerën e muajit paraardhës për të cilin ka dokumentacion. Nga përlllogaritjet rezultoi se të ardhurat nga pensioni për periudhën 2003 – tetor 2006 janë në shumën 16.010,76 euro.

22.4.vi Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për 3 persona për të gjithë periudhën e analizuar, pavarësisht se nuk rezultojnë të ardhura të dokumentuara për bashkëshortin e subjektit për periudhën 2001 – 24.8.2005 (kohë kur është regjistruar me aktivitet privat si noter).

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	1995 – 26.10.2006
1	TË ARDHURA	6,347,358
	Të ardhura nga paga 1995 – 2000	1,008,077
	Të ardhura nga noteria 2005 – tetor 2006	2,291,667
	Të ardhura nga pensioni shqiptar (prindërit) 1995 – 1999	299,770
	Të ardhura nga pensioni shqiptar (prindërit) 2000 – tetor 2006	781,033
	Të ardhura nga pensioni grek (prindërit) 2005 – tetor 2006	1,966,811
2	SHPENZIME	3,036,658
	Shpenzime jetese 1995 – 1999 (66%)	797,633
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së, 2000 – tetor 2006 ⁴⁹	2,010,524
	Shpenzime TIMS	228,502
3	PASURI	1,000,000
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	

⁴⁵ Nr.*** prot., datë 14.1.2020.

⁴⁶ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë 24.6.2022, të DRT-së Korçë, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 13.7.2022.

⁴⁷ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020.

⁴⁸ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe pyetësori nr. 2, datë 13.7.2022, dokumentacioni i përkthyer në formën e kërkuar nga ligji.

⁴⁹ Shpenzimet e jetesës për vitet 2000 - 2002 janë marrë në të njëjtën vlerë me atë të vitit 2003.

	Apartament me sip. 60 m ² + shtesë	1,000,000
	DIFERENCA (1-2-3)	2,310,699

22.5 Nga analiza e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor vërehet se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

22.6 Komisioni⁵⁰ i kërkoi subjektit të japë shpjegime për mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën për vitin 2010.

22.7 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka deklaruar se meqenëse këto të ardhura nuk kanë qenë të ndara, ashtu siç e ka informuar bashkëshorti në ILDKPKI në vitin 2015, ajo ka deklaruar në emër të tij si burim krijimi të ardhurat nga puna dhe kontributi i prindërve nga pensionet e marra në shtetin grek, pra të ardhurat e gjithë familjes.

22.8 Pavarësisht rezultatit pozitiv të rezultuar në analizën financiare të kryer për bashkëshortin e saj, sikurse paraqitet në tabelën më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në prapësime ndryshime të disa zërave.

22.8.i Më konkretisht, subjekti ka pretenduar ulje të shpenzimeve të jetesës, pasi bashkëshorti i saj dhe familja e tij kanë jetuar në fshat⁵¹, si dhe ulje të shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit.

22.8.ii Gjithashtu, subjekti ka pretenduar një balancim mes të ardhurave të përfituara përgjatë kohës që bashkëshorti i saj kishte ushtruar profesionin e avokatit, me shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, pasi sipas subjektit, edhe pse nuk konfirmohen detyrimet tatimore të paguara në të gjithë përfitimet e të ardhurave si përfaqësues kryesisht në proceset gjyqësore⁵², provat e depozituara tregojnë ushtrimin e këtij aktiviteti.

22.9 Trupi gjykues, në analizë të provave të depozituara, në harmoni edhe me vlerësimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵³ lidhur me çmuarjen e shpenzimeve të jetesës në fshat, sikurse është rasti objekt hetimi, vlerëson se pretendimet e subjektit për analizën e kryer për bashkëshortin e saj qëndrojnë, porse marrja në konsideratë e tyre thjesht rrit balancën pozitive për periudhën 1995 – 26.10.2006.

22.10 Trupi gjykues, duke vlerësuar në tërësi hetimin e kryer për këtë pasuri, dokumentacionin e administruar, analizën financiare e cila rezultoi pozitive, faktin që kjo pasuri është krijuar nga bashkëshorti i subjektit përpara lidhjes martesore me këtë të fundit, me burime të cilat rezultuan të ligjshme, faktin që mosdeklarimi i burimit të krijimit që i përket vitit të parë të lidhjes së martesës është korrigjuar në deklaratën *Vetting*, si dhe nuk ka ndryshuar përgjatë hetimit, çmon se ky konstatim mbetet në nivelin e një pasaktësie nga personi i lidhur dhe nuk ndikon në rivlerësimin e subjektit.

22.11 Në lidhje me shtesën e kësaj pasurie, deklaruar nga bashkëshorti i subjektit me përshkrim “Shtesa e apartamentit, me sip. 109.8 m², ndërtuar nga shitësi, ndodhur në Korçë, me nr. pasurie ***, regjistruar në ZVRPP-në Korçë në datën 8.5.2012 sipas ‘lejes së legalizimit nr. ***, datë 6.4.2012, të ‘ALUIZNI Korçë’, për të cilën janë bërë shpenzime përshtatjeje si ambient banimi

⁵⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁵¹ Për këtë pretendim subjekti ka referuar vendimin e Kolegjit nr.***, datë 8.6.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit D.B, konkretisht pikën 36.4, ku thuhet: “Ndërsa në versionin e dytë të analizës, shpenzimet e jetesës së prindërve të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 - 2002 u përlllogaritën në vlerën 0 lekë, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e përfituara kanë qenë ‘të ardhura neto’, pasi prindërit e tij kanë jetuar në fshat dhe kanë siguruar vetë produktet bujqësore e blegtorale...”

⁵² Për të cilat ka depozituar 46 vendime me pyetësorin nr. 3, datë 14.9.2022.

⁵³ Referuar vendimit nr. ***, datë 8.6.2022, të subjektit të rivlerësimit D.B.

ndër vite, nga të ardhurat nga puna dhe kontributi i prindërve. Vlera e deklaruar: 1.000.000 lekë. Zotëron 100%.”, për të cilën subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵⁴, rezultoi si vijon:

22.12 Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 ka deklaruar se apartamenti me sip. 60 m² është blerë së bashku me një shtesë me sip. 80 m², në proces legalizimi (proces i filluar nga shitësi).

22.13 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar legalizimin e shtesës së apartamentit me sip. 109.8 m², e regjistruar në ZVRPP-në Korçë.

22.14 ASHK Drejtoria Vendore Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020, informon se në emër të shtetasit J.GJ.GJ figuron pasuria apartament me nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 109.8 m², z. k. ***, Korçë, me leje legalizimi nr. ***, datë 6.4.2012, në emër të shtetasve N.T, V.S dhe J.GJ.

22.15 Në aktet e administruara vërehet se kontrata e shitjes së pasurisë për apartament me sip. 60 m², me nr. ***, datë 26.10.2006 (veprim noterial i formalizuar nga bashkëshorti përpara martesës me subjektin e rivlerësimit), me palë shitëse B.D dhe palë blerëse J.GJ, ka përcaktuar si vlerë të shitblerjes shumë 1.000.000 lekë dhe në përmbajtje të saj gjithashtu është parashikuar me dakordësi mes palëve se së bashku me apartamentin shitësit i shesin blerësit brenda çmimit të shitjes edhe të drejtën e legalizimit të një shtese të ndërtuar me leje ndërtimi, por që i ka përfunduar afati, duke deklaruar se nuk kanë asnjë pretendim dhe të drejtë mbi këtë shtesë.

22.16 Referuar dokumentacionit të administruar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, kur është pyetur⁵⁵ në ILDKPKI në lidhje me vlerën e blerjes së apartamentit dhe shtesën e tij, burimin e krijimit, si dhe për sipërfaqen e saktë të saj, ka deklaruar: (i) sipërfaqja e përgjithshme e pasurisë është 60 m² plus 109.8 m²; (ii) shtesa e pasurisë ka qenë e ndërtuar nga shitësi dhe se vetëdeklarimi është bërë po prej shitësit më 28.8.2006⁵⁶; (iii) sipërfaqja e shtesës është deklaruar me përafërsi pa deklaruar ballkonet, ndërsa në përfundim të procesit të legalizimit rezultoi të jetë miratuar e gjithë sipërfaqja prej 109.8 m². Gjithashtu, lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë, subjekti ka deklaruar se pasuria është blerë në çmimin 1.000.000 lekë, ku është përfshirë edhe shtesa dhe se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e bashkëshortit të saj dhe kontributi i prindërve të tij.

22.17 Sipas dokumentacionit për legalizimin e shtesës⁵⁷ anësore tre kat rezultoi se është legalizuar me lejen nr. ***, datë 6.4.2012, ku përfitues janë tri bashkëpronarë të apartamenteve (pallatit), përfshirë edhe bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Sipas kartelës së pasurisë, pasuria është regjistruar me sip. 109.8 m². Më parë legalizimit të pasurisë i është realizuar edhe kontrata e shitjes së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 23.1.2012. Sipas të dhënave të administruara vërehet se njëri prej bashkëpronarëve të apartamenteve, konkretisht shtetasi N.T, në emrin e të cilit është dhënë edhe leja e ndërtimit, miratuar me vendimin nr. ***, datë

⁵⁴ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; leje legalizimi nr. ***, datë 6.4.2012, nga ALUIZNI Korçë, me objekt shtesë anësore e kombinuar 3 kat, e cila i jepet shtetasve N.T, V.S dhe J.GJ në z. k. ***, me nr. pasurie ***, Korçë, me sipërfaqe totale të ndërtimit 219.6 m² dhe për aktivitet 68.8 m²; kontratë e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. *** kol., datë 23.1.2012; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 8.5.2012, të pasurisë nr. ***, në z. k. ***, vol. ***, f. ***, Korçë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.1.2015, deklaruesit GJ.GJ dhe T.GJ; fletë informacioni e pensioneve në emër të shtetasve GJ.GJ dhe T.GJ, në datën 1.6.2011, në shumë mujore 345 euro; dokumentacion në gjuhën greke (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵⁵ Shihni procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 10.2.2015, dërguar me shkresën nr. ***1 prot., datë 5.10.2020, administruar në dosjen e hetimit administrativ.

⁵⁶ Ky akt (vetëdeklarimi/shtojca A1) është plotësuar nga tri bashkëpronarët e apartamenteve, ku përfshihet edhe shitësi i pasurisë, shtetasi B.D. Akti renditet në faqen 136 të praktikës së ASHK-së, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020.

⁵⁷ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 17.4.2012, administruar brenda praktikës së ASHK-së me nr. *** prot., datë 6.2.2020.

29.7.1999, të KKRRT-së, ka kryer pagesën për pasurinë që prej vitit 1999⁵⁸, konkretisht 2% të vlerës së investimit dhe 50% të vlerës së truallit. Nga të dhënat e grumbulluara dhe të analizuar lidhur me ndërtimin e shtesës me sip. 109.8 m² provohet se ajo është ndërtuar përpara se t'i shitej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

22.18 Në praktikën e legalizimit vërehet se në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale pasuria është vlerësuar në vitin 2011 në vlerën 1.375.969 lekë, paguar në datën 20.10.2011. Praktikës me nr. vetëdeklarimi *** i është bashkëngjitur ortofoto dixhitale⁵⁹ me datë fotografimi 14.4.2007, sipas së cilës pasuria rezulton e përfunduar dhe e mbuluar.

22.19 Në aktkualifikimin⁶⁰ e Drejtorisë Rajonale ALUIZNI, Qarku Korçë, nr. ***, datë 6.10.2011, kjo pasuri është identifikuar me ortofoton dixhitale, fotografuar në datën 14.4.2007.

22.20 Në lidhje me shumën 1.000.000 lekë, të deklaruar nga bashkëshorti i subjektit se është shpenzuar ndër vite për adaptimin dhe përshtatjen e shtesës, me burim krijimi të ardhurat e tij ndër vite dhe kontributi i prindërve të tij, Komisioni e ka pyetur subjektin se çfarë nënkupton apo se çfarë ka përfshirë ky shpenzim dhe si është kryer ai.

22.21 Në përgjigje⁶¹, subjekti ka deklaruar se kjo është një pasuri e krijuar nga bashkëshorti i saj, përpara lidhjes së martesës. Bashkëshorti e ka informuar se nga momenti kur është blerë pasuria apartament me sip. 60 m² së bashku me shtesën, kanë filluar edhe shpenzimet për përshtatjen e saj në shtëpi banimi dhe kryerjen e punimeve të brendshme. Po ashtu e ka informuar se nuk e mban mend kohën e saktë, por kujton se ka ndodhur në periudhën 2006 – 2010 dhe se shpenzimet janë kryer gradualisht pasi ai nuk ka banuar aty në atë periudhë; nuk disponon fatura, pasi ka kaluar një kohë e gjatë, si dhe e ka informuar se këto punime janë kryer nga ustallarë të zonës. Gjithashtu, bashkëshorti e ka informuar se duke mos qenë subjekt deklarues në atë periudhë nuk i ka ruajtur ato, pasi nuk ka pasur detyrim për efekt deklarimi.

22.22 Komisioni i ka përfshirë shpenzimet e kryera përgjatë viteve 2006 - 2010 sipas deklarimit të subjektit, duke kryer një analizë për të gjitha pasuritë dhe investimet e bashkëshortit përpara martese, të cilat janë pasqyruar në tabelën nr. 5.

22.23 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës⁶² për të shpjeguar dhe për të depozituar dokumentacion mbështetës, pasi: (a) mbetej i dyshimtë fakti që pasuria me sip. 60 m², së bashku me shtesën prej 109.8 m², kishin kushtuar 1.000.000 lekë; (b) dukej se nuk provohej me dokumentacion shkresor justifikues shuma e shpenzuar për adaptimin e shtesës për banim në vlerën 1.000.000 lekë dhe as koha e kryerjes së tij, sipas deklarimit të subjektit se shtesa është realizuar përgjatë viteve 2006 – 2010; (c) u vërejt se nuk ishte deklaruar vlera e investimit prej 1.000.000 lekësh në deklaratën për vitin 2010, përdorur si shpenzime për adaptimin e shtesës me sip. 109.8 m², vlerë e cila deklarohet për herë të parë në deklaratën *Vetting*; (ç) dukej se kishte mospërputhje në vlerën e investimit në shtesën e pasurisë në deklaratën *Vetting* dhe vlerën e investimit tek dokumentet e legalizimit të shtesës në vitin 2011, si dhe iu kërkuan shpjegime për investime të mundshme të kryera në këtë pasuri pas vitit 2010. Bazuar në të gjitha këto rrethana mbeti i dyshimtë fakti që për një pasuri me sipërfaqe totale prej 169.8 m² të ishte investuar një shumë prej 2.000.000 lekësh brenda vitit 2010, sikurse është deklaruar nga subjekti.

⁵⁸ Referuar mandatarkëtimeve, renditur në faqen 12 në praktikën e ASHK-së me nr. *** prot., datë 6.2.2020.

⁵⁹ Provë e administruar në praktikën e përcjellë nga ASHK Drejtoria Vendore Korçë, me nr. *** prot., datë 6.2.2020.

⁶⁰ Administruar në praktikën e ASHK Drejtoria Vendore Korçë, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020.

⁶¹ Pyetësor nr. 3, datë 14.9.2022.

⁶² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

22.24 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me vlerën e investuar për blerjen e pasurisë në shumën 1.000.000, në të cilën përfshihet edhe shtesa 109.8 m², dhe kohën e ndërtimit të kësaj të fundit, ndër të tjera, në parashtrime ka deklaruar sikurse e ka informuar bashkëshorti.

22.24.i Referuar dokumentacionit, pasuria apartament, së bashku me shtesën, është blerë nga bashkëshorti në vitin 2006 para martese, me kontratë shitblerjeje kundrejt vlerës 1.000.000 lekë, në përputhje me vullnetin e shprehur ndërmjet shitësit B.D dhe bashkëshortit J.GJ sa i takon elementeve thelbësore të kontratës së shitjes, përkatësisht çmimit të shitjes dhe objektit ndërtimor që shitet.

22.24.ii Subjekti ka shpjeguar se apartamenti i banimit, së bashku me shtesën e tij, ndodhet në një pallat që sipas deklarimit të banorëve, fotografive aktuale, por edhe në referim të fakteve që lidhen me tjetërsimet në këtë pallat, ai përfaqëson ndërtim të realizuar me kontribut vullnetar të banorëve, që më pas ju është dhënë e drejta për strehim në apartamentet e tij nga pushteti vendor i kohës dhe është ndërtuar para vitit 1990, përkatësisht në vitin 1987, pasi apartamentet janë përfituar në pronësi nga banorët e tyre qiramarrës, në bazë të dispozitave të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, kundrejt vlerave tejet të ulëta (rreth 10.000 lekë dhe më pak). Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar si provë kartelën e pasurisë nr. *** për “apartament banimi me sip. 71 m²” në pronësi të shtetasve V dhe G. P dhe ka sqaruar se apartamenti ndodhet në pallatin ***, ku banon edhe subjekti me bashkëshortin.

22.24.iii Subjekti ka pretenduar se në momentin e blerjes duhet të shihet edhe vjetërsia e ndërtimit, e cila përcakton edhe shkallën e amortizimit, si kriter që ka shërbyer në përcaktimin e vlerës së shitjes për efekt privatizimi, vendndodhja në periferi të qytetit, në unazë, në rrugën Korçë-Bilisht, si dhe gjendja faktike, për të cilat subjekti ka depozituar fotografi të gjendjes aktuale jashtë dhe brenda pallatit, si dhe për vendndodhjen e tij.

22.24.iv Subjekti deklaroi se nga interesimi i bashkëshortit me banorë të pallatit ka siguruar edhe disa kontrata shitjeje (kopje)⁶³ për apartamente me të dhëna të ngjashme të ndodhura në zonën ku ndodhet apartamenti i tyre.

22.24.v Subjekti ka sqaruar se çmimin e shitjes së apartamentit së bashku me shtesën e tij prej 1.000.000 lekësh e rikonfirmon edhe shitësi B.D në “deklaratën” e tij të nënshkruar në datën 24.10.2022.

22.24.vi Për të provuar kohën e ndërtimit të pallatit në vitin 1987, subjekti ka depozituar deklaratën e shtetasit V.S, datë 24.10.2020, i cili sipas saj ka punuar personalisht në ndërtimin e tij me kontribut vullnetar dhe mandej ka marrë autorizim strehimi në këtë pallat, ku sot jeton në katin e dytë.

⁶³ Kontratë shitje nr. ***, datë 31.3.2007, e Noterisë Korçë, me të cilën është tjetërsuar apartamenti i ndodhur në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, kati i ***, ap. ***, me sip. 71 m², kundrejt vlerës 300.000 lekë (apartamenti ndodhet në pallatin ku banon me bashkëshortin); kartelë pasurie nr. ***, ku rezulton se me kontratë shitjeje datë 9.11.2000, është blerë pasuria apartament me sip. 60 m², në pallatin “***” kundrejt vlerës 700.000 lekë (apartamenti ndodhet në pallatin ku banon me bashkëshortin); kontratë shitje nr. ***, datë 4.10.2006, e Noterisë Korçë, me të cilën është tjetërsuar apartamenti i ndodhur në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, kati i ***, ap. ***, me sip. 71 m², kundrejt vlerës 200.000 lekë (apartamenti ndodhet në pallatin ku banon me bashkëshortin); kontratë shitje nr. ***, datë 6.4.2007, e Noterisë Korçë, me të cilën është tjetërsuar apartamenti i ndodhur në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, kati i ***, ap. ***, me sip. 71 m², kundrejt vlerës 300.000 lekë (apartamenti ndodhet në pallatin ku banon me bashkëshortin); kontratë shitje nr. ***, datë 16.4.2007, e Noterisë Korçë, me të cilën është tjetërsuar apartamenti i ndodhur në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, kati i ***, ap. ***, me sip. 71 m², kundrejt vlerës 300.000 lekë (apartamenti ndodhet në pallatin ku banon me bashkëshortin).

22.24.vii Subjekti ka deklaruar se ka marrë kontakt edhe me banorë të pallatit, të cilët në deklaratat⁶⁴ e tyre që i ka depozituar si provë, kanë deklaruar kohën e ndërtimit të shtesës së pallatit, faktin që shtesa në katin e tretë është bërë nga shitësi B.D dhe se ka qenë e përfunduar në vitin 2002.

22.25 Në lidhje me shpenzimet e deklaruara për adaptimin dhe përshtatjen e shtesës objekt hetimi në vlerën 1.000.000 në vitet 2006 – 2010, si dhe provueshmërinë e tyre me dokumentacion, subjekti ka deklaruar sikurse e ka informuar bashkëshorti i saj.

22.25.i Sikurse ka deklaruar në pyetësorin nr. 3, ka shpjeguar se nga momenti kur është blerë pasuria apartament me sip. 60 m², së bashku me shtesën, kanë filluar edhe shpenzimet për përshtatjen e saj në shtëpi banimi dhe kryerjen e punimeve të brendshme të cilat janë realizuar pas blerjes në periudhën 2006 – 2010 dhe janë kryer gradualisht, pasi ai nuk banonte aty në atë periudhë, ka deklaruar se nuk disponon fatura, pasi ka kaluar një kohë e gjatë dhe se këto punime janë kryer nga ustallarë të zonës. Gjithashtu subjekti ka deklaruar se bashkëshorti e ka informuar që duke mos qenë subjekt deklarues në atë periudhë, nuk i ka ruajtur ato, pasi nuk ka pasur detyrim për efekt deklarimi.

22.26 Në lidhje me mosdeklarimin e investimit të bërë në pasurinë shtesë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, në vlerën 1.000.000 lekë, subjekti ka shpjeguar në mënyrë kronologjike deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna, duke kundërshtuar konkluzionin e ILDKPKI-së për “fshehje të shpenzimeve në deklaratat e pasurisë”.

22.26.i Subjekti ka deklaruar se sa i takon investimeve të kryera nga bashkëshorti i saj në shtesën e apartamentit, ashtu siç ai e ka informuar, mosdeklarimi i vlerës së investimit të kryer në të përgjatë viteve 2006 – 2010 lidhet me mënyrën e konceptimit të tij për plotësimin e deklaratës në tërësi, pasi bashkëshorti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 ka pasqyruar të dhënat që kanë qenë të evidentuara në dokumentet që ka disponuar, ku për apartamentin e banimit, i cili është blerë së bashku me shtesën, ka deklaruar blerjen me kontratë dhe çmimin sipas kontratës.

22.26.ii Subjekti ka deklaruar se në shpjegimet e dhëna me kërkesë në ILDKPKI në vitin 2015, nuk është pyetur nëse nga ana e bashkëshortit janë kryer investime dhe për vlera investimesh në shtesën e apartamentit, por është pyetur se sa ka qenë vlera e blerjes së apartamentit dhe shtesës, si dhe për burimin, për të cilën ka paraqitur kontratën e blerjes nr. ***, datë 26.10.2006, vetëdeklarimin pranë ALUIZNI-t, duke u përgjigjur se vlera e blerjes së apartamentit ka qenë 1.000.000 lekë (çmim ku është përfshirë edhe vlera e shtesës), pasqyruar në kartelën e pasurisë nr. *** (bashkëngjitur) dhe blerja është bërë me të ardhurat nga puna dhe kontributi i prindërve. Për këtë ka dorëzuar edhe dokumentacionin që i është kërkuar.

22.26.iii Subjekti ka deklaruar se për faktet e mësipërme nuk i janë kërkuar shpjegime të tjera pas vitit 2015 dhe se nuk është njoftuar nga ILDKPKI-ja për ndonjë konstatim të saj.

22.26.iv Në vijim të deklaratimeve të saj, subjekti ka shpjeguar se sikurse e ka informuar bashkëshorti, punimet e brendshme në shtesën e apartamentit janë bërë gradualisht nga momenti i blerjes në vitin 2006 dhe kanë vijuar deri në përfundimin e tyre në vitin 2010 dhe se pas martese, së bashku me bashkëshortin, janë vendosur për të jetuar në apartamentin me shtesë, ku jetojnë edhe aktualisht.

22.26.v Subjekti ka sqaruar se bashkëshorti e ka informuar se edhe në muajt e parë të vitit 2010 ka kryer shpenzime për lyerjen e mureve, vendosjen e tendave (mbulesave) të diellit në dritare

⁶⁴ Deklaratë datë 24.10.2022, e shtetasit B.D, vërtetim nënshkrimi noteri; deklaratë datë 24.10.2022, e shtetasit V.S, vërtetim nënshkrimi noteri; deklaratë datë 24.10.2022, e shtetasit L.T, vërtetim nënshkrimi noteri; deklaratë datë 24.10.2022, e ing.K.K, vërtetim nënshkrimi noteri; deklaratë e shtetasit P.T, datë 26.10.2022, vërtetim nënshkrimi noteri.

dhe ballkon, por nuk i ka deklaruar si shpenzime në deklaratën e vitit 2010, pasi në dijeninë e saj këto shpenzime kanë kushtuar më pak se 300.000 lekë.

22.26.vi Subjekti ka deklaruar se në deklaratat periodike vjetore pas vitit 2010 e deri në depozitim të deklaratës *Vetting* ajo dhe bashkëshorti nuk kanë bërë shpenzime të tjera të deklarueshme në banesë dhe, për këtë arsye, nuk kanë pasqyruar të tilla (të vetmet shpenzime të bëra për disa sende të luajtshme deri në deklarinim *Vetting* por që nuk e tejkalojnë “vlerën e deklarueshme” kanë qenë ato të pasqyruara në përgjigje të pyetësorit nr. 1).

22.26.vii Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti e ka informuar që duke qenë tashmë subjekt deklarues i ka kushtuar vëmendje plotësisht të deklaratës *Vetting*, ku, ndër të tjera, kërkohej përveç çmimit të blerjes edhe shuma e shpenzimeve që janë kryer, dhe për këtë arsye, për herë të parë ai ka deklaruar shpenzimet për shtesën e apartamentit ndër vite.

22.26.viii Subjekti për këto shpenzime ka prapësuar se prej bashkëshortit të saj në deklaratën *Vetting* nuk është cilësuar periudha e kryerjes së tyre, për shkak se ato kanë qenë kryer vetëm prej tij dhe se i takojnë periudhës përpara martesës.

22.26.ix Subjekti ka deklaruar, sikurse bashkëshorti e ka informuar, se shuma e shpenzuar prej 1.000.000 lekësh është deklaruar në bazë të një “preventivi punimesh” të ing. arkit. K.K, banues në Korçë, i bërë sipas inspektimit në vend të ambienteve të brendshme të shtesës me kërkesë të bashkëshortit pas blerjes së apartamentit dhe shtesës, për llojin e materialeve që duhet të blinte për punimet e brendshme në shtesë për përshtatjen e saj për banim.

22.27 Në lidhje me mospërputhjen e konstatuar në/për vlerën e investimit në shtesën e pasurisë në deklaratën *Vetting* dhe vlerën e investimit në dokumentet e legalizimit të shtesës në vitin 2011, subjekti ka deklaruar se nuk mund të njehsohet/barazohet vlera e shpenzimeve për punime të brendshme të kryera në shtesën e apartamentit [e cila ka qenë ndërtim i ndërtuar dhe përfunduar nga shitësi, i përfaqësuar nga kolona betoni dhe një soletë-mbulesë (pasi soleta e bazës ka qenë e ndërtuar nga fqinji i katit të dytë V.S), si dhe muraturat (tullë), me përjashtim të një muri që ka qenë ekzistues i apartamentit prej 60 m²] me vlerën e investimit të llogaritur nga ALUIZNI për disa arsye të parashtruara prej saj.

22.27.i Së pari, subjekti ka shpjeguar se llogaritja e vlerës së investimit nga ALUIZNI është proces i pavarur nga pronari/pronarët i/e ndërtimit informal dhe është bërë vetëm për efekt të llogaritjes së “taksës së ndikimit në infrastrukturë”, e parashikuar në nenin 27 të ligjit nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, i cili në pikën 2/1 (sipas formulimit në kohën e legalizimit) parashikonte se: “2/1. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksë e ndikimit në infrastrukturën e ndërtimeve të reja është 0.5% e vlerës së investimit”.

22.27.ii Duke iu referuar elementeve të “formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, lëshuar në datën 7.10.2011 nga Bashkia Korçë për subjektin zotëruar të ndërtimit J.GJ, kjo taksë është llogaritur për sipërfaqen 49 m² me çmimin 28.081 l/m² = 1.375.969 lekë dhe 0.5% e kësaj vlere ka rezultuar 6.879,9 lekë, e cila është paguar nga bashkëshorti J.GJ. Subjekti ka sqaruar se vlera/m² prej 28.081 lekësh i referohet të dhënave të Udhëzimit Nr. 3, datë 3.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2010”, e cila rezulton nga tabela nr. 1, ku për qytetin e Korçës kostoja mesatare e ndërtimit është në shumën 28.081 lekë/m².

Subjekti shpjegon se del qartazi që kjo mënyrë vlerësimi lidhet drejtpërdrejt dhe vetëm me mënyrën e zbatimit të legjislacionit të legalizimit të banësive apo shtesave informale, për efekt të përmbylljes së procedurave të legalizimit deri në emetimin përfundimtar të lejes së legalizimit, siç në rastin konkret ka ndodhur.

22.27.iii Së dyti, subjekti ka deklaruar se nga strukturat e ALUIZNI-t nuk është bërë inspektim i elementeve të investimit të trupëzuar në shtesë nga ndërtuesit e saj, pasi nuk ka ndonjë preventiv të hartuar ku të llogaritet vlerë për secilin zë punimi të kryer, por është referuar në aktin nënligjor, cituar më lart, duke marrë si referencë në vitin 2011 kur janë kryer procedurat e legalizimit koston mesatare të ndërtimit për m² të vitit paraardhës 2010, pra duke e konsideruar për efekt të ligjit të legalizimit shtesën sikur të ishte ndërtuar në vitin 2010 vetëm për efekt të zbatimit të nenit 27 të ligjit cituar më lart, ndërkohë që ajo ka qenë e përfunduar në kohën e blerjes nga bashkëshorti dhe sipas deklarimit të banorëve të pallatit dhe të shitësit B.D është përfunduar plotësisht në vitin 2002.

22.27.iv Ajo ka theksuar se me kërkesë të ALUIZNI-t është bërë aktekspertimi nga eksperti E.D, jo për të përcaktuar vlerën e investimit nga ndërtuesit, por për elementet e qëndrueshmërisë së strukturës, si kusht i miratimit të “lejes së legalizimit”, ku edhe sipas aktit konfirmohet se shtesa ka qenë e përfunduar në tërësinë e saj edhe në punimet e brendshme.

Subjekti është shprehur se po të shihet dokumentacioni i ALUIZNI-t rezulton që llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë vetëm për një sipërfaqe ndërtimore prej 49 m², e cila është sipërfaqja ndërtimore që tejkalon atë të miratuar me leje ndërtimi, pasi, po sipas dosjes së legalizimit për sipërfaqen për të cilën ishte miratuar leja, ishte llogaritur dhe kryer pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 2% që në kohën e dhënies së lejes datë 26.8.1999, nga shtetasi N.T dhe, po kështu, ishte paguar prej tij edhe 50% e vlerës së truallit. Pra, ndërtimi nga ALUIZNI është trajtuar si “shtesë pa leje në një ndërtim me leje” dhe është llogaritur pagesa e taksës vetëm për sipërfaqen 49 m², që tejkalon atë të miratuar me leje ndërtimi, e cila nuk taksohet.

22.27.v Subjekti ka depozituar: preventiv punimesh, nëntor 2006 ing. ark. K.K; kopje kartelë e pasurisë nr. *** “apartament banimi me sip. 71 m²” në pronësi të shtetasve V dhe GJ. P; kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 31.3.2007, e Noterisë Korçë; kopje kartelë e pasurisë nr. ***; kopje kontratë shitje nr. ***, datë 4.10.2006, e Noterisë Korçë; kopje kontratë shitje nr. ***, datë 6.4.2007, e Noterisë Korçë; kopje kontratë shitje nr. ***, datë 16.4.2007, e Noterisë Korçë; fotografi të gjendjes aktuale dhe vendndodhjes së pallatit ku ndodhet apartamenti i banimit dhe shtesa (9 copë).

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

22.28 Trupi gjykues në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorë dhe prapësime, si dhe dokumentacionit të depozituar pas kalimit të barrës së provës, me qëllim provueshmërinë e deklarimeve, në raport dhe harmoni me ligjin e zbatueshëm, arsyeton si vijon:

22.28.i Dokumentacioni i administruar provoi se pasuria me sip. 60 m² është përfituar me një nga mënyrat ligjore të fitimit të saj, të parashikuara në legjislacionin civil, konkretisht nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes nr. ***, datë 26.10.2006.

22.28.ii Nga verifikimi i kryer rezultoi se po në këtë kontratë noteriale është parashikuar se brenda vlerës së shitjes 1.000.000 lekë është edhe shtesa e ndërtuar si pjesë bashkëshoqëruese e pandarë e pasurisë. Nga leximi literar i kontratës rezulton e shprehur dakordësia e ndërsjellë e palëve kontraktore për të pasqyruar pa rezervë në shitblerje një pasuri ekzistente. Në vlerësim të trupit gjykues, parashikimi kontraktor se pasuria shtesë ka ekzistuar, bëhet bindës edhe nën ndikimin e disa rrethanave të qenësishme, për sa rezulton:

a) Në kontratë parashikohet se shitësi B.D së bashku me apartamentin i ka shitur blerësit edhe të drejtën e legalizimit të një shtese të ndërtuar me leje ndërtimi, por që i ka përfunduar afati, duke deklaruar gjithashtu se nuk ka asnjë pretendim dhe të drejtë mbi këtë shtesë.

b) Sipas praktikës së legalizimit u konstatua se formulari i vetëdeklarimit të ndërtimit A-1 nr. ***, datë 28.8.2006 “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës anësore 3 kate” ishte plotësuar nga të tre banorët e pallatit në vitin 2006, ku pasqyrohet edhe shtetasi B.D, akt ky i kërkuar për t’u përmbushur nga ligji për legalizimin e ndërtimeve informale.

c) Rezultoi se formulari i vetëdeklarimit është plotësuar përpara kontratës së shitjes dhe po ashtu edhe kontrata e shitjes është realizuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit 4 vite përpara se ai të bëhej person i lidhur me subjektin, çka provon që veprimet mes palëve kontraktore janë kryer me shfaqje të vullnetshme mes tyre dhe pa përfshirje të subjektit.

ç) Referuar specifikave të formularit të vetëdeklarimit vihet re se kërkohet legalizimi i shtesës anësore të pallatit mbi lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin nr. ***, datë 29.7.1999, të KRRT-së. Konstatohet se ky akt konfirmon faktin, se ndërtimi i shtesës brenda lejes së ndërtimit kishte përfunduar dhe se me këtë akt kërkohet legalizimi i ndërtimit të kryer në tejkalim të lejes së ndërtimit.

d) Gjatë hetimit administrativ u provua se për shtesën e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit ishte paguar vlera e investimit dhe vlera e truallit.

dh) Gjithashtu u provua ndjekja e procedurës së legalizimit dhe pagesa e kryer nga secili banor, ku përfshihej edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit (të drejtë që ia njihete kontrata e shitjes së pasurisë), për taksën e ndikimit të pasurisë në infrastrukturë⁶⁵ për sipërfaqen e ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit, çka do të thotë se pagesa e kësaj takse në vlerën 1.300.000 lekë i referohet indeksit në kohën e legalizimit, pa marrë parasysh kohën e ndërtimit sipas vetëdeklarimit, pra jo domosdoshmërisht investimi real përfaqëson këtë shumë.

e) Edhe sipas ortofotove të vitit 2007 të administruara në praktikën e ALUIZNI-t⁶⁶ provohet ekzistenca e shtesës së pallatit që prej këtij viti.

ë) Provohet gjithashtu ekzistenca e ndërtimit të shtesës së objektit edhe në aktin e kualifikimit⁶⁷ nr. ***, datë 6.10.2011, të praktikës së legalizimit të objektit, të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI, Qarku Korçë, se objekti trekatësh është identifikuar i ndërtuar në ortofoton dixhitale të fotografuar në datën 14.4.2007.

f) Aktekspertimi teknik (pjesë e praktikës së legalizimit të pasurisë), i përgatitur për llogari të procesit të legalizimit, konfirmon sipërfaqet e shtesës anësore të ndërtuara jashtë projektit dhe lejes së miratuar. Ky konfirmim është në një linjë edhe me kontratën e shitjes së pasurisë ku pasqyrohet se brenda vlerës së shitjes së apartamentit përfshihet edhe e drejta e legalizimit e shtesës së ndërtuar.

g) Krahas arsytimit në drejtim të provueshmërisë së kohës së ndërtimit të shtesës së pasurisë dhe vlerës së shpenzuar për blerjen e pasurisë në tërësi, si dhe provave të administruara, në këtë rast merr vlerë edhe deklarata e shtetasis D, i cili rikonfirmon marrëdhënien e tij kontraktore të vitit 2006, për sa kohë ky deklarim nuk bie në kundërshtim me çdo fakt tjetër të konstatuar përgjatë procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

⁶⁵ Referuar vendimit nr. *** të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku në pikën 15/4 sqarohet *kostoja e përcaktuar nga ALUIZNI në momentin e legalizimit, në fakt, nuk është kostoja reale e shpenzimeve të objektit godinë 3-katëshe, por është e bazuar në koston mesatare të ndërtimit të banesave për metër katror, bazuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave, faqja 14 nga 52 nr. 4, datë 23.11.2011, miratuar në zbatim të shkronjës “dh”3 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, mbi të cilin ALUIZNI kryen përlllogaritjen duke verifikuar vetëm sipërfaqen e ndërtimit dhe duke e shumëzuar me 0,5% (përqindja e aplikueshme e taksës) dhe me vlerën standarde të koston mesatare të ndërtimit, rezulton çmimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, taksë të cilën e ka paguar subjekti posedues i ndërtimit. Pra është një çmim fiks që i referohet vitit të legalizimit të ndërtësës (në këtë rast, vitit 2011), pavarësisht nga kostoja reale e ndërtimit dhe që shërben për përcaktimin e taksës së infrastrukturës, të cilën e paguan subjekti i legalizimit.*

⁶⁶ Pjesë përbërëse e praktikës së ZVRPP-së Korçë, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020.

⁶⁷ Administruar në praktikën e ASHK Drejtorisë Vendore Korçë, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020.

gj) Edhe nga verifikimi i planimetrive të pasurive të shtuara dhe formalizuara me leje legalizimi konstatohet e pasqyruar sipërfaqja me leje ndërtimi dhe sipërfaqja e cila tejkalon lejen e ndërtimit.

h) Trupi gjykues, përveç rrethanave provuese të arsyetuara më sipër, konstaton se edhe zërat e pasqyruar (të tilla si instalime elektrike, instalime hidrosanitare, suvatime, shtresa me pllaka, dritare, dyer, etj.) në preventivin e realizuar nga një ekspert i licencuar në nëntor të vitit 2006, janë të tilla, që i përkasin adaptimit dhe përshtatjes së ndërtimit dhe jo rastit të një ndërtimi klasik, pra të një investimi të mirëfilltë, ku do duhej të kryheshin përllogaritje sipas metodologjisë së ndjekur në raste të tjera.

i) Gjithashtu, nga verifikimi i kontratave të depozituara nga subjekti për të provuar vlerat e ulëta të shitblerjes së apartamenteve të ndodhura në të njëjtin pallat ku ndodhet pasuria objekt i këtij hetimi administrativ në të cilën banon subjekti me bashkëshortin, më konkretisht pasuri e ndodhur në rrugën “****”, p. ***, konstatohet se vlerat e shitjes së apartamenteve janë relativisht të ulëta. Më konkretisht, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 31.3.2007, vërehet se është tjetërsuar apartamenti me sip. 71 m², kundrejt vlerës 300.000 lekë, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 4.10.2006; është tjetërsuar apartamenti me sip.71 m², kundrejt vlerës 200.000 lekë, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 6.4.2007; është tjetërsuar apartamenti me sip. 71 m², kundrejt vlerës 300.000 lekë, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 16.4.2007; është tjetërsuar apartamenti me sip. 71 m², kundrejt vlerës 300.000 lekë dhe sipas kartelës së pasurisë nr. *** rezultoi se me kontratë shitjeje datë 9.11.2000 është blerë pasuria apartament me sip. 60 m², po në të njëjtin pallat, kundrejt vlerës 700.000 lekë. Trupi gjykues, bazuar në dhënat e këtyre kontratave (sipërfaqe dhe çmim), për të njëjtin pallat, tipologjinë e tyre (të prejardhura nga privatizimi i banesave shtetërore), fotot e pallatit në zonë periferike, çmon se shpjegimet e subjektit për këtë pasuri të blerë nga bashkëshorti i saj para martesë janë bindëse.

22.28.iii Për sa arsyetohet më sipër, vlerësohet se investimi prej 1.000.000 lekësh i bërë për adaptimin dhe përshtatjen e shtesës në një periudhë kohore katërvjeçare (2006 – 2010) nuk mund të paralelizohet me vlerën 1.300.000 lekë e pasqyruar në formularin e taksës së ndikimit të pasurisë në infrastrukturë në vitin 2011, për shkak se vlerat jo vetëm që konfirmojnë zëra të ndryshëm, porse vlera 1.300.000 lekë i referohet indeksit në kohën e legalizimit, pa marrë parasysh kohën e ndërtimit sipas vetëdeklarimit dhe për këtë shkak nuk mund të konkludohet në mospërputhje midis këtyre vlerave.

22.28.iv Lidhur me mosdeklarimin e shpenzimit të shumës 1.000.000 lekë në DPV/2010 nga bashkëshorti i subjektit, trupi gjykues përgjatë hetimit konstatoi se : (i) bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar këtë shpenzim në deklaratën *Vetting*; (ii) investimi është kryer prej tij përpara lidhjes së martesës; (iii) nuk evidentohen lidhje të mundshme të subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin përpara lidhjes martesore; (iv) nuk rezultuan *indicie* që të provohej se nuk është deklaruar vlere reale; (v) nga analiza financiare e kryer për vitet 1995 – 2010, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte aftësi paguese për të investuar shumën e deklaruar.

22.28.v Në tërësi për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzion se bashkëshorti i subjektit: (a) ka deklaruar në përputhje me dokumentacionin e administruar vlerën e shpenzuar për blerjen e pasurisë dhe investimin e bërë për adaptimin dhe përshtatjen e saj për banim; (b) ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës 2.000.000 lekë, e shpenzuar në tërësi për këtë pasuri; (c) ka kryer deklaram të pasaktë në DPV/2010, pasi nuk ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë të përdorur për adaptimin dhe përshtatjen e shtesës së pasurisë, por për shkak se kjo pasaktësi nuk bashkëshoqërohet me balancë negative nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku që mund të cenojë procesin e rivlerësimit për këtë subjekt. Në kushte të tilla, për sa u

arsyetua dhe u konkludua nga trupi gjykues, konstatohet se nuk qëndron konkluzioni i ILDKPKI-së se subjekti ka kryer fshehje të investimit të kryer.

23. Pasuri truall me sipërfaqe 200 m² dhe 110 m² ndërtesë, ndodhur në Bilisht Devoll, blerë me kontratën nr. ***, datë 24.12.2012, në bashkëpronësi me shtetasin E.G, blerje e një pjesë pasurie që funksionon si karburant, blerë me kredi bankare të marrë me bashkëshorten. Vlera: 6.353.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁶⁸ disa dokumente.

23.1 Kontratë nr. ***, datë 23.1.2013, për blerjen e pjesës tjetër të pasurisë që funksionon si pikë karburanti në Bilisht Devoll, me sipërfaqe truall 520 m². Për pasurinë e bashkuar nr. *** disponohet certifikatë pronësie datë 28.1.2013, e ZVRPP-së Devoll, blerë me kredi bankare. Vlera: 988.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁶⁹ disa dokumente⁷⁰.

23.2 Nisur nga fakti që pasuritë kanë të njëjtën vendndodhje dhe janë bashkuar në një të vetme, kronologjia e hetimit të tyre parashtrohet në vijim si një e tërë. Nga hetimi rezultoi si vijon:

a) Në deklarinimin e interesave private periodike vjetore 2012, bashkëshorti i subjektit deklaroi blerjen e pasurisë së paluajtshme truall + ndërtesë (e cila funksionon si karburant) në Devoll, pasuria nr. *** dhe pasuria nr. ***, z. k. *** (110 m² + 200 m²) në vlerën 6.353.000 lekë. Gjithashtu, tek “të dhënat konfidenciale” bashkëshorti sqaron se kjo pasuri është në bashkëpronësi dhe bashkëpronar është shtetasi E.G. Kredia e marrë në “Societe Generale Albania Bank” nuk është përdorur për blerje shtëpie, por i është paguar shuma 9.800.000 lekë shtetasit N.K për blerjen e dy pasurive (transfer të “ProCedit Bank”, datë 11.10.2012). Diferenca e vlerës së parapaguar për blerjen e pjesës tjetër të pasurisë për të cilën nuk është formalizuar blerja deri në datë 31.12.2012, për shkak të gjendjes së regjistrimit.

b) Në deklarinimin e interesave private periodike vjetore 2013, bashkëshorti deklaroi blerjen e pasurisë së paluajtshme truall me sip. 520 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në Bilisht, Devoll, në shumën 988.000 lekë (bashkëpronësi). Tek “të dhënat konfidenciale” bashkëshorti ka deklaruar bashkëpronësi në pasurinë truall me sip. 520 m² (pjesë funksionale e objektit + truall,

⁶⁸ Certifikatë për vërtetimin pronësie nr. ***, datë 28.1.2013; kontratë shitje nr. ***, datë 24.12.2012, palë shitëse N.K dhe palë blerëse E.G dhe J.GJ, të dy pasurive me nr. ***, ndërtesë me sip. 110 m² dhe nr. *** truall, me sip. 200 m², në Bilisht, Devoll; certifikatë pronësie nr. ***, datë 22.7.2008, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “ndërtesë” me sip. 110 m², në emër të shtetasit N.K, në Bilisht, Devoll, harta treguese; kartelë pasuri e paluajtshme; certifikatë pronësie nr. ***, datë 8.10.2010, nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “truall” me sip. 200 m², harta treguese, kartela e pasurisë së paluajtshme; prokurë e posaçme nr. ***, datë 23.8.2012, kopje ID-së (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi nr. ***, datë 5.10.2012, “Societe Generale Albania Bank” (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.10.2012, z. E.G deklaroi se në marrëveshje me shtetasin J.GJ do të jenë bashkëblerës të pasurisë së llojit “karburant” (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); vërtetim datë 25.10.2016, nga ZVRPP-ja Devoll, në të cilën vërtetohen se pasuria me nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “truall”, me sipërfaqe totale 720 m² dhe 720 m² truall dhe 110 ndërtesë, me ref. *** figuron, në bashkëpronësi të shtetasve E.G dhe J.GJ, në z. k. *** Bilisht (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶⁹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁰ Kontratë shitje nr. ***, datë 23.1.2013, me palë shitëse N.K, M.K dhe palë blerëse E.G dhe J.GJ, të pasurisë nr. ***, në z. k. *** vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “truall” me sip. 520 m², në Bilisht, Devoll, në vlerën 988.000 lekë. Pjesa është kryer jashtë zyrës noteriale; certifikatë pronësie nr. ***, datë 17.12.2012, me nr. pasurie ***, në z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë “truall”, me sip. 520 m²; harta treguese regjistruar, kartela e pasurisë së paluajtshme; kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi nr. ***, datë 5.10.2012, “Societe Generale Albania Bank”, në emër të shtetasve J.GJ dhe Etleva Gjamo dhe dorëzanës J.GJ të kredisë në shumën 10.000.000 lekë (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.10.2012, E.G deklaroi se në marrëveshje me shtetasin J.GJ do të jenë bashkëblerës të pasurisë së llojit “karburant” me vendndodhje Bilisht, Devoll, me pronar N.K. Në pamundësi për të siguruar kredi bankare për shkak të mungesës së kolateralit me qëllim blerjen e karburantit kanë aplikuar shtetasit J.GJ dhe Etleva Gjamo, me kontratën e huas nr. ***, datë 5.10.2012, deklaruesi merr përsipër të paguajë 50% të kredisë bankare dhe çdo detyrimi ndaj bankës (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); vërtetim datë 25.10.2016, nga ZVRPP-ja Devoll, në të cilën vërtetohen se pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f.***, lloji i pasurisë “truall” me sipërfaqe totale 720 m², 720 m² truall dhe 110 ndërtesë me ref. ***, figuron në bashkëpronësi të shtetasve E.G dhe J.GJ në z. k. ***, Bilisht (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

që funksionon si karburant deklaruar në vitin 2012), në Bilisht, pasuria nr. ***, z. k. ***, në bashkëpronësi me shtetasin E.G. Kredia e marrë me bashkëshorten në “Societe Generale Albania Bank” parapaguar tërësisht shitësit N.K në vlerën 9.800.000 lekë për blerjen e dy pasurive të deklaruara në vitin 2012, kryer me transfertë bankare. Diferenca e vlerës e parapaguar për pjesën e truallit e cila është formalizuar me kontratë në vitin 2013, në shumën 988.000 lekë.

Në deklarinimin e interesave private periodike vjetore 2013, tek “të dhënat konfidenciale” bashkëshorti ka deklaruar kontratë huapërdorjeje datë 1.1.2013, për pasurinë pikë karburanti në favor të bashkëpronarit E.G, për një afat 3-vjeçar, pa shpërblim.

c) ZQRPP-ja Tiranë, me shkresat nr. *** prot., datë 7.8.2017 dhe nr. *** prot., datë 5.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Devoll⁷¹, ku konfirmon se në emër të shtetasit J.GJ figuron e regjistruar pasuria nr. *** në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 720 m² truall dhe 110 m² ndërtesë në bashkëpronësi me shtetasin E.G, me ½ pjesë (funksioni i ndërtesës është pikë shitje karburanti); kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.1.2013, me palë shitëse N.K, M.K dhe palë blerëse E.G dhe J.GJ të pasurisë me nr. ***, me sip. 520 m², në Bilisht, Devoll, në vlerën 988.000 lekë, ku konfirmohet se pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale; certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 17.12.2012, për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “truall”, me sip. 520 m², në emër të shtetasve N.K dhe M.K; hartën treguese të regjistrimit; kartelën e pasurisë së paluajtshme; prokurën e posaçme nr. ***, datë 23.8.2012, në të cilën shtetasja M.K autorizon shtetasin N.K të kryejë tjetërsimin e pasurisë ku përfshihet edhe pika e karburantit; planrivelimi; kërkesën datë 24.1.2013, drejtuar ZVRPP-së Devoll, për bashkim pasurie në një pasuri të vetme me sip. 720 m² truall dhe 110 m² ndërtesë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 28.1.2013, për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në Devoll, në bashkëpronësi të shtetasve E.G dhe J.GJ; hartën treguese të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme; si dhe kartelën e pasurisë.

ç) Nga aktet e administruara⁷² rezulton se kjo pasuri është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe shtetasi E.G shitësve N dhe M.K, përkatësisht nëpërmjet kontratave të shitjes nr. ***, datë 24.2.2012, për pasurinë ndërtesë nr. ***, me sip. 110 m² në shumën 5.973.000 lekë dhe për pasurinë truall nr. ***, me sip. 200 m² në vlerën 380.000 lekë, me vendndodhje Bilisht, Devoll. Më tej, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.1.2013, bashkëshorti i subjektit dhe shtetasi G kanë blerë nga shitësit K pasurinë me nr. ***, me sip. 520 m², në vlerën 988.000 lekë, në të njëjtën vendndodhje me dy pasuritë e mëparshme. Pas kërkesës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, datë 24.1.2013, drejtuar ZVRPP-së Devoll, është bërë bashkimi i pasurive në një të vetme me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 720 m² (truall) dhe një ndërtesë 110 m² (ND), konfirmuar sipas certifikatës për vërtetim të pronësisë⁷³ lëshuar në datën 28.1.2013. Burim i ligjshëm i saj është kredia.

Lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive

d) Bashkëshorti i subjektit, si në deklaratat periodike, ashtu edhe në atë *Vetting*, ka deklaruar se burim krijimi i këtyre pasurive, pra truall + ndërtesë, është kredia e marrë në “Societe Generale Albania Bank”. Komisioni e ka trajtuar kredinë në pikën 7 të këtyre rezultateve. Pas disbursimit të kredisë në datën 10.10.2012, ajo është tërhequr më 11.10.2012 prej bashkëshortit të subjektit dhe është depozituar po në të njëjtën datë në “ProCredit Bank” në llogarinë e

⁷¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresë nga ASHK, DR Korçë, nr.*** prot., datë 6.2.2020 dhe shkresë nga ASHK, ZV Devoll, nr. *** prot., datë 7.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷² Aneks nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷³ Referuar aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

shtetasit J.GJ dhe po në këtë datë është transferuar shuma 9.800.000 lekë në llogarinë e shtetasit N.K, me përshkrimin “G J. G., kalim për blerje objekti (karburant), K.N”.

dh) Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara, nuk konkludon në problematika apo dyshime lidhur me burimin e krijimit të dy pasurive, për sa kohë që u provua se si burim i të gjithë vlerës së blerjes së tyre është kredia.

23.3 Në lidhje me destinacionin e kredisë, nga hetimi i dokumentacionit të dosjes së kredisë rezultoi i administruar dokumenti aktpremtim shitje (kontratë kapari) nr. ***, datë 28.8.2012, lidhur mes shtetasve R.Ç dhe N.L si kaparmarrës dhe shtetasit J.GJ (bashkëshorti i subjektit) si kapardhënës për blerje apartamenti dhe dyqani në vlerën 14.000.000 lekë.

23.4 Nga verifikimi i kryer rezultoi se një ditë pas disbursimit të kredisë në vlerën 10.000.000 lekë (në datën 10.10.2012), në datën 11.10.2012 shuma 9.844.400 lekë i është kaluar shtetasit R.Ç, me përshkrimin “pagesë në favor të R.Ç, J.GJ për blerje apartamenti”.

23.5 Më tej, në datën 11.10.2012 rezultoi se bashkëshorti i subjektit J.GJ ka depozituar në llogarinë e tij bankare në “ProCredit Bank” shumën 9.800.000 lekë, më përshkrimin “depozitim të ardhura nga marrje kredie në Banka Popullore J.GJ, të ardhura nga marrje kredi nga banka popullore”.

23.6 Pas këtij depozitimi rezultoi se shuma 9.800.000 lekë transferohet në po të njëjtën datë 11.10.2012 te shtetasi N.K, me përshkrimin “GJ J. G., kalim për blerje objekti (karburant), K.N”.

23.7 Komisioni e ka pyetur⁷⁴ subjektin lidhur me veprimet e kryera me kredinë nga momenti i disbursimit te përfituesi final, e cila, në përgjigje ka sqaruar se: *“Aktpremtim shitja nr. ***, datë 28.8.2012, është revokuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.10.2012⁷⁵, pasi R. Ç (vëllai i subjektit) i ka informuar se ambienti “njësi” në katin përdhe i ishte premtuar një tjetër shtetasi, S.K. Ndodhur në kushtet kur nuk kishim bërë ndonjë pagesë, ndërsa personi tjetër S.K kishte paguar shumën e pasqyruar në kontratën e kaparit (nr. ***, datë 8.8.2011), për të mos i krijuar vëllait probleme me ortakun, si dhe me blerësit e tjerë, u tërhoqëm nga aktpremtim shitja pasi interesi ynë ishte që ambienti i banimit dhe ambienti ‘njësi’ të ishin në të njëjtin objekt. Aktpremtim shitja nuk solli asnjë efekt financiar pasi u revokua dhe palët në deklaratën noteriale të revokimit kanë deklaruar se nuk kanë asnjë lloj pretendimi ndaj njëri-tjetrit që burojnë prej aktit dhe deklarojnë se janë dakord që të anulohet. Lidhur me kredinë e akorduar dhe disbursuar në emër të z. R.Ç në vlerën 9.845.000 lekë, ajo është tërhequr dhe i është dorëzuar po sot z. J.GJ”.* Subjekti ka shpjeguar se shuma e pasqyruar në aktpremtim shitjen nuk është paguar fizikisht për shkak të lidhjeve familjare, shoqërore dhe marrëdhënieve të ndërsjella të besimit midis bashkëshortit të saj dhe investitorëve N (N) L dhe vëllait të saj R.Ç, pasi ishte rënë dakord që mund të paguhej në të ardhmen kur të lidhej kontrata përfundimtare e shitjes. Subjekti ka shpjeguar se kanë shfaqur interes për të blerë dyqanin tjetër në këtë pallat (duke vijuar përpjekjet), por edhe në këtë rast i është konfirmuar nga investitorët se ishte nënshkruar një kontratë kapari nr. ***, datë 25.6.2012, sipas së cilës ishte rënë dakord për blerje të një dyqani i cili i ishte shitur dhe kishte kaluar në pronësi sipas kartelës përkatëse të pasurisë shtetasit K.C.

23.8 Nga verifikimi i deklaratës noteriale për revokimin e kontratës premtim shitje rezulton se palët janë shprehur mbi mospasjen e ndonjë pretendimi të mundshëm ndaj njëra-tjetrës, duke u dakordësuar për anulimin e aktit. Po në këtë revokim deklarohet edhe dorëzimi i kredisë bashkëshortit të subjektit nga shtetasi R.Ç.

⁷⁴ Pyetësor nr. 2, datë 13.7.2022.

⁷⁵ Vërtetuar nga noteri pas nxjerrjes së dokumentit nga arkiva noteriale me aktin nr. *** rep., datë 20.7.2022.

23.9 Sikurse rezulton, aktet janë hartuar brenda vitit kalendarik, palët janë kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme dhe duket se veprimet e kryera nuk kanë sjellë apo krijuar efekte financiare mes tyre.

23.10 Nga të dhënat e pasqyruara në kontratën e kredisë, në pikën 3, thuhet se *kredia do të përdoret nga kredimarrësi për blerje banese dhe dyqan (zyrë avokatie)*, pra destinacioni i saj është parashikuar edhe për njësi biznesi.

Gjithashtu, në kontratën e kredisë⁷⁶ janë pasqyruar edhe mjetet e sigurimit lënë për garancinë e shlyerjes së saj, për të cilat gjithashtu janë nënshkruar nga palët edhe kontratat e hipotekimit. Më konkretisht, me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 5.10.2012, është vendosur kolateral pasuria e bashkëshortit të subjektit me nr. ***, me sip. 109.8 m² dhe me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 5.10.2012, është vendosur kolateral pasuria tjetër e bashkëshortit të subjektit me nr. ***, me sip. 60 m². Po për këtë kredi janë vendosur si kolateral, përkatësisht me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 5.10.2012, është vendosur kolateral pasuria e vëllait të bashkëshortit të subjektit J.GJ, me nr. ***, me sip. 86.95 m² dhe me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 5.10.2012, është vendosur kolateral pasuria tjetër po e tij me nr. ***, me sip. 69.63 m².

23.11 Nga verifikimi i akteve rezultoi se të gjithë pasuritë janë të regjistruara në hipotekë dhe për to është depozituar në praktikën e kredisë edhe certifikata dhe kartela e pasurisë për secilën.

23.12 Edhe pse subjekti deklaroi se kapari prej 3.000.000 lekësh nuk është paguar realisht, edhe pse sipas deklaratës noteriale për revokimin e kontratës së premtim shitjes palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme, duke cituar kthimin e kredisë dhe vlerën e saj reciprokisht, por pa përshkruar ndonjë të dhënë apo veprim të kryer për këtë shumë, Komisioni e konsideroi të mirëqenë dhënien e saj dhe, për pasojë, vlerësoi të konkludojë mbi mundësinë financiare për krijimin e saj. Meqenëse gjatë hetimit rezultoi që bashkëshortët në fund të vitit 2011 dispononin 30.000 euro *cash* dhe 2.500.000 lekë, Komisioni arriti në konkluzion se ata kanë pasur mundësi ta kryenin këtë pagesë. Lidhur me gjendjen *cash*, Komisioni ka hetuar dhe këtë çështje e ka trajtuar në vijim në këtë vendimmarrje.

23.13 Komisioni hetoi edhe lidhur mbi një *indicie* të diktuar gjatë verifikimit të *statement-eve*⁷⁷ lidhur me shlyerjen e kësteve të kredisë, ku në të shumtën e rasteve ato depozitoheshin në bankë nga shtetasi K.P. Komisioni e ka pyetur⁷⁸ subjektin për marrëdhënien që ka me këtë shtetas dhe arsyen e kryerjes së pagesave të kësteve të kredisë prej tij. Subjekti, në përgjigje, ka shpjeguar se: *“Këstet e kredisë janë depozituar dhe depozitohen nga K.P për shkak të lidhjeve të ngushta familjare dhe dakordësisë së tij që për shkak të këtyre lidhjeve, por edhe për faktin se ka pasur dhe vijon të ketë kontakte të shpeshta me OTP Bank, të ofrojë edhe ndihmën e tij për bashkëshortin tim. Sa i takon lidhjeve familjare, bashkëshorti im J.GJ dhe shtetasi K.P kanë lidhje familjare, pasi nëna e tij T.P është vajza e motrës (mbesa) e nënës së bashkëshortit tim, T.GJ, fakt i rezultuar nga certifikatat e gjendjes civile. Meqenëse shtetasi K.P është edhe administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k. prej vitit 2013 dhe ka kontakte të përditshme me bankat në qytetin e Bilishtit, ka vijuar të marrë dhe të dorëzojë këstin e kredisë në emër dhe për llogari të bashkëshortit tim J.GJ”*.

23.14 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës me shtetasin K.P dhe në vijim, nën konfirmimet institucionale⁷⁹, por edhe

⁷⁶ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. ***.

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2020, nga OTP Bank.

⁷⁸ Pyetësor nr. 2, datë 13.7.2022.

⁷⁹ Dokumentacion i depozituar nga subjekti në pyetësin nr. 3, datë 14.9.2022; vërtetim nr. *** prot., datë 16.9.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe vërtetim nr.*** prot., datë 16.9.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nuk rezultoi që prej saj të ishte shqyrtuar ndonjë çështje ku palë ndërgjyqëse apo kërkues me çfarëdolloj statusi të ketë qenë ky shtetas.

23.15 Njësia e Shërbimit Ligjor ka përlllogaritur në analizën financiare pagesat e kësteve të kredisë si shpenzime për subjektin dhe bashkëshortin e saj, pra fonde të tyre, pavarësisht depozitimit të kryer nga shtetasi K.P.

23.16 Komisioni⁸⁰ për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, me gjithë faktet dhe rrethanat e konkluduara për destinacionin e kredisë, i kërkoi subjektit të vijojë të japë shpjegime bindëse, pasi kontrata e kredimarrjes përcakton blerje apartamenti dhe zyrë, ndërkohë rezultoi se ajo është përdorur për blerje trualli dhe ndërtesë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

23.17 Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se i qëndron përgjigjeve që ka dhënë në pyetëtorin nr. 2, duke sqaruar gjithashtu se kredia e marrë me bashkëshortin J. Gj është me kushte të njëjta si për të gjithë qytetarët e tjerë që aplikojnë për kredi në banka private në Republikën e Shqipërisë. Subjekti ka theksuar se nga momenti i deklaratimit për herë të parë të “kontratës së kredisë” në DPV/2012 e në vijim ajo dhe bashkëshorti e kanë deklaruar destinacionin faktik të përdorimit të saj, duke pasqyruar hollësisht në të dhënat konfidenciale se *kredia e marrë nuk është përdorur për blerje shtëpie, por i është paguar shuma shtetasit N.K për blerjen e dy pasurive... deklaratë e bashkëpronarit E.G për shlyerjen e ½ së kredisë...* Nga të dhënat e kontratës së kredisë nr. ***, datë 5.10.2012, një ndër kushtet e saj është se ajo do të përdoret nga kredimarrësi për blerje banese dhe dyqan (zyrë) dhe se për arsyet që ajo i ka shpjeguar në pyetëtorin nr. 2 kredia i është paguar shitësit N.K për blerje trualli dhe ndërtesë në Bilisht.

23.18 Subjekti sqaron se destinacioni i pasqyruar në kontratë përfshinte blerje zyre, pasi bashkëshorti i saj ka pasur synim të ushtronte profesionin nëse do të mundësohej transferimi i tij në qytetin e Korçës dhe për këtë ka deklaruar se *destinacioni i saj ka qenë edhe për qëllime biznesi (zyrë për aktivitet privat).*

23.19 Subjekti ka deklaruar se referuar kushteve të kontratës, në momentin e blerjes së pasurisë truall dhe ndërtesë nga bashkëshorti dhe bashkëpronari E.G, kanë gjukuar se nuk ndodheshin para ndonjërit prej rasteve të mospërmbljes thelbësore të detyrimeve për të cilin banka mund t'i penalizonte, duke deklaruar zgjidhjen e kontratës dhe se përdorimi i kredisë për blerjen e pasurisë truall dhe ndërtesë është diktuar nga rrethanat e paparashikuara që i ishin krijuar në kohën e disbursimit të kredisë.

23.20 Subjekti ka deklaruar se kontrata e kredisë është nënshkruar në datën 5.10.2012 dhe në datën 10.10.2012 banka i ka njoftuar për disbursimin e saj në emër të bashkëshortit J. Gj, i cili të nesërmen në datën 11.10.2012 e ka kaluar shumën nëpërmjet bankës në llogarinë e vëllait të saj R.Ç, sipas kushteve të kontratës, megjithëse interesi i tyre kishte qenë blerja e banesës dhe dyqanit (zyrës) në të njëjtin pallat, porse duke qenë se të dy dyqanet i ishin premtuar personave të tjerë të cilët kishin bërë edhe parapagime në formë kapari, për të mos i krijuar vëllait të saj probleme me ortakun e tij dhe blerësit (kapardhënësit), si dhe duke parë edhe interesin e tyre, kanë anuluar aktpremtim shitjen, pa asnjë pasojë financiare për palët.

23.21 Subjekti ka shpjeguar edhe mbi ardhjen në dijeni të shtetasit E.G për shitjen e pasurisë truall dhe ndërtesë nga pronari N.K, si dhe për vlerën e shitjes.

23.22 Subjekti ka sqaruar në detaje njohjen me shtetasin G, dakordësinë e palëve që nëse edhe shtetasi N.K do të binte dakord shuma e kredisë t'i kalonte atij dhe më pas të lidhnin kontratë

⁸⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

për blerjen e pikës së karburantit, si dhe të përcaktonin modalitetet e shlyerjes së saj dhe raportet ndërmjet tyre, sikurse ka ndodhur, duke finalizuar me bashkëshortin blerjen tërësore të pronës sipas kontratave të shitjes.

23.23 Subjekti ka sqaruar pamundësinë e shtetasit G për të hyrë në marrëdhënie me bankën dhe për t'u bërë bashkëkredimarrës, për shkak se kredia ishte disbursuar dhe se kushtet e shlyerjes së saj dhe të gjitha modalitetet e tjera ishin formalizuar në "kontratën e kredisë". Ka sqaruar se për faktin se edhe "zëvendësimi i debitorit" sipas konceptit të nenit 496 të Kodit Civil nuk është proces që ndodh vetëm me vullnetin e njëanshëm të debitorit dhe të personit që zëvendëson debitorin, por mund të bëhet vetëm me pëlqimin e kreditorit.

23.24 Subjekti ka sqaruar se *për këto arsye bashkëpronari E.G deri në ditën e sotme ka paguar rregullisht në llogari të bashkëshortit, nëpërmjet sistemit bankar 1/2 e shumës së kredisë së shlyer paraprakisht nga ana e tyre.*

23.25 Subjekti ka shpjeguar edhe lidhur me deklaratën noteriale datë 28.10.2022 të bashkëpronarit E.G të cilën e ka depozituar si provë dhe që konfirmon veprimet e tij sa i takon blerjes së pasurisë truall dhe ndërtesë me kredinë e çelur në emër të bashkëshortit J.GJ.

23.26 Subjekti ka sqaruar se deklaratimet e shtetasit G kryesisht konsistojnë në lidhjet e krushqisë dhe shoqërore me familjen e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe me vetë bashkëshortin e saj, marrëdhënien e tij me qytetin e Bilishtit, për shkak të menaxhimit të biznesit/pikës së tregtimit të karburantit të shoqërisë "****", mënyrën se si ai kishte rënë në dijeni se shtetasi N.K kishte nxjerrë në shitje një pikë karburanti me truallin përreth të ndodhur në unazën e qytetit Bilisht, interesimin e tij për këtë rast, fokusin e punës së tij për të pasur një aktivitet të tijin në tregtimin e karburanteve për shkak të përvojës së grumbulluar, pamundësinë e tij financiare për ta blerë i vetëm sepse shuma që kërkohej ishte e lartë dhe e konsiderueshme, komunikimin e tij me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë që shitej nga shtetasit K, rënien e tij në dijeni të aplikimit të subjektit dhe bashkëshortit të saj për të marrë kredi për blerje apartamenti dhe zyre dhe arsyet që çuan në kthimin e destinacionit fillestar pas disbursimit të saj, komunikimin për të dakordësuar përdorimin e kredisë në blerjen e pasurisë ku përfshihej edhe një ndërtesë bar-kafe, e cila sipas shitësit ishte ndërtim pa leje, si dhe disa çisterna, konfirmimin e kalimit të shumës së kredisë në llogarinë e shitësit, etj.

23.27 Subjekti ka konfirmuar se sipas deklaratimit të shtetasit G, ai është interesuar në bankë për t'u bërë pjesë e kredisë, por nuk kishte pasur mundësi, pasi kredia ishte miratuar dhe ishte nënshkruar kontrata prej saj dhe bashkëshortit.

23.28 Subjekti ka theksuar se *pas marrjes së kredisë ajo dhe bashkëshorti kanë përmbushur detyrimet e marra përsipër, duke paguar këstet e kredisë sipas kushteve të kontratës dhe nga viti 2012 i disbursimit të kredisë dhe deri në ditën e sotme banka nuk ka konstatuar ndonjë "rast mospërmbushje" apo ndonjë fakt që sipas gjykimit të saj do të vinte në rrezik shlyerjen e kredisë dhe nuk u ka kundërtuar asnjë pretendim, edhe pse bashkëpronari i pasurisë së blerë me kontratë E.G ka kryer për llogari të bashkëshortit pagesa pranë kësaj banke me përshkrimin "pagesë sipas marrëveshjes me kredimarrësit për marrje përsipër të shlyerjes së saj në masën 50%", konfirmuar me "vërtetimin nr. *** prot., datë 20.1.2020, të OTP Bank, dega Bilisht, depozituar si provë në përgjigje të pyetësorit nr. 1. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, date 28.10.2022, të deklaruesit E.G.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

23.29 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, të gjithë fakteve dhe rrethanave të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, si dhe dokumentacionit të administruar, konstaton se të gjitha veprimet juridike të kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në funksion të ndryshimit të destinacionit të kredisë, janë deklaruar ndër vite, dhe se ato nuk

duket se janë marrë në kundërshtim me ligjin apo të kenë sjellë pasoja për palët (bankën apo të tretë).

23.29.i Trupi gjykues arrin në këtë përfundim, pasi nga hetimi u provua se: (a) destinacioni i kredisë është deklaruar në deklaratimet periodike nga subjekti i rivlerësimit dhe kryesisht nga bashkëshorti i saj; (b) çdo lëvizje e shumës së kredisë së disbursuar është kryer nëpërmjet transaksioneve bankare; (c) ndryshimi i destinacionit jo vetëm është deklaruar në kohë reale, porse shpjegimet e subjektit mbështeten në prova të besueshme⁸¹, ku të dhënat hipotekore provuan faktin e blerjes së pasurisë që do të shërbente si zyrë për bashkëshortin e subjektit nga një tjetër person i cili kishte porositur më parë se subjekti i rivlerësimit; (ç) transferimi i shumës me burim po kredinë, në favor të shitësve të pasurive të bashkuara së bashku me pasurinë bar-kafe, rezultoi të jetë bërë po me transaksion bankar; (d) destinacioni fundor i kredisë ka shkuar për pasuri të deklaruara në mënyrë të qartë dhe të plotë.

23.29.ii Në kushtet e konstatuara kur të gjithë veprimet e kryera rezultuan të gjurmueshme, duke mosafektuar gjithashtu paligjshmëri në burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, nuk konkludohet në problematika për këtë çështje.

23.30 Në vijim të hetimit, për të konkluduar mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit lidhur me pozitën e shtetasit E.G si bashkëpronar në pasurinë e blerë shtetasve K, si dhe të gjithë veprimet e kryera prej tij në favor të kësaj bashkëpronësie, Komisioni ka konstatuar se:

23.30.i Shtetasi E.G ka nënshkruar në datën 15.10.2012 deklaratën noteriale nr. ***⁸², sipas së cilës ka njohur dhe marrë përsipër çdo lloj detyrimi ndaj bankës ku është marrë kredia në masën 50%, aq sa edhe për karburantin që do të blihet.

Gjatë hetimit rezultoi se ky shtetas ka filluar likuidimin e pjesës së tij takuese prej vitit 2015 e në vijim. Ai ka paguar nëpërmjet sistemit bankar pjesën e tij takuese prej 50% nga llogaria e tij bankare në atë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit J.GJ, sipas transaksioneve të cituara si më poshtë vijon:

Data	Shuma	Banka	Përshkrimi
13.1.2015	1,387,193	RFZ	E.G, pagesë për shlyerje detyrimi që buron nga akti noterial nr. ***, datë 15.10.2012
18.11.2016	1,251,200	RFZ	E.G, pagesë për shlyerje kredie bankare për periudhën janar 2015 – dhjetor 2016

23.30.ii Komisioni hetoi lidhur me mundësitë financiare të shtetasit E.G për të shlyer pjesën e tij takuese prej 50% dhe në përfundim nuk i kanë rezultuar problematika. Nga ana tjetër, Komisioni konstatoi se edhe nëse nuk përfshin në analizë pagesën e kryer prej shtetasit G, kjo nuk ndikon në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

23.30.iii Në lidhje me kontratën e huapërdorjes⁸³ për këtë pasuri, nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe shtetasi G në datën 1.01.2013, me afat trevjeçar, pa shpërblim, me destinacion sipas funksionit, pikë karburanti, Komisionit i rezultoi si vijon:

a) Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2013, si dhe deklaratës *Vetting*, rezultoi se bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar kontratën e huapërdorjes datë 1.1.2013⁸⁴.

⁸¹ Referohuni kontratës së kaparit nr. ***, datë 8.8.2011, lidhur midis blerësit S.K dhe shitësve R.Ç dhe N.L, Kontratës së kaparit nr. ***, datë 25.6.2012 lidhur midis blerësit K.C dhe shitësve R.Ç dhe N.L, etj., akte të përcjella me pyetësorin nr. 2, datë 13.7.2022.

⁸² Administruar në dosjen e ILDKPKI-së/aneks nr. ***.

⁸³ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, ku administrohet dhe vërtetim nënshkrimi nr.*** rep., datë 8.2.2014.

⁸⁴ Shihni kontratën datë 1.1.2013 me afat 3-vjeçar, në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. ***.

Lidhur me ekstremitetin e kësaj kontrate si e lidhur pa shpërblim, Komisioni ka pyetur⁸⁵ subjektin për marrëdhënien e huapërdorjes, duke qenë se ishte nënshkruar pa shpërblim, por edhe për të konfirmuar se çfarë ka ndodhur me investimin në vite në këtë pasuri. Subjekti ka shpjeguar: “... në momentin e blerjes ‘pika e karburantit’ dhe objektin e përshtatur si ‘bar-kafe’ si ambient funksional i saj, ka pasur nevojë për punime dhe sisteme për ta përshtatur me kërkesat e tregut me qëllim realizimin e fitimit dhe përbalimin e konkurrencës, pasi ishte në gjendje jo shumë të mirë dhe për këtë arsye nga bashkëshorti im J.GJ u ra dakord me bashkëpronarin E.G që të gjitha të ardhurat që mund të realizoheshin nga aktiviteti të investoheshin përsëri në objekt. Gjendjen fizike të pasurisë së blerë në momentin e blerjes e vërtetojnë edhe fotografitë e bëra gjatë ndërhyrjes për kryerjen e punimeve nga E. G. Për këtë arsye u nënshkrua ‘kontratë huapërdorje datë 1.1.2013’, vërtetuar nënshkrimi nr. *** rep., datë 8.2.2014, për pasurinë pikë karburanti (për 50%) në favor të bashkëpronarit E. G, për një afat 3-vjeçar, pa shpërblim, ku afati 3-vjeçar (sipas shpjegimeve të kontraktuesve) u pa si një parashikim relativisht afatgjatë jo vetëm për përshtatjen e ‘pikës së karburantit’ plotësisht me nevojat e tregut, por edhe për të mundësuar shlyerjen tërësore të shpenzimeve (investimeve) nga të ardhurat që do të realizoheshin nga ushtrimi i aktivitetit, fillimisht vetëm nga bashkëpronari E.G”.

b) Subjekti ka deklaruar gjithashtu se bashkëpronari E.G kishte përvojë në fushën e karburanteve, pasi ka punuar në kompanitë “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. deri në muajin korrik të vitit 2013. Në bazë të dakordësisë me bashkëshortin J.GJ për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit në “pikën e karburantit” në Bilisht, bashkëpronari E.G kishte krijuar shoqërinë “****” sh.p.k., me ortak të vetëm në datën 25.9.2013 dhe kishte filluar të ushtronte aktivitet duke realizuar të ardhura për vitet 2013 dhe 2014, të cilat ishin investuar në mënyrë graduale. Meqenëse të ardhurat e realizuara kishin justifikuar investimet e kryera dhe pika e karburantit ishte vendosur në eficiencë të plotë për ushtrimin e aktivitetit, afati 3-vjeçar i lënies në përdorim pa pagesë ishte reduktuar, ku prej datës 1.1.2015 shoqëria kishte marrë me qira pasurinë nga të dy bashkëpronarët E.G dhe J.GJ, me të cilat ishin lidhur “kontrata qiraje” në vlerën 150.000 lekë/muaj secili.

c) Po ashtu, subjekti ka deklaruar se për sa i takon investimeve, nga dokumentet e vëna në dispozicion nga shoqëria “****” sh.p.k., ato janë pasqyruar si aktive afatgjata materiale në “pasqyrën financiare të vitit 2014 (e cila pasqyron edhe gjendjen e periudhës paraardhëse viti 2013)” në shumën 3.404.878 lekë dhe libri i blerjeve 2014, ku përfshihen të gjitha investimet në objektin e blerë me kontratë, si dhe në ambientin e përshtatur si “bar-kafe”, i deklaruar në proces legalizimi, i cili ka qenë ndërtuar pa leje nga pronari i mëparshëm N.K, por që për shkak të shitjes së “pikës së karburantit” ishte shitur si investim (shpenzim i kryer) brenda çmimit të shitjes, me kushtet e konfirmuara në “deklaratën noteriale” nr. ***, datë 13.1.2015, të nënshkruar nga shitësi dhe blerësit.

ç) Subjekti ka sqaruar se pas lidhjes së kontratës së qirasë, sipas deklaramëve të administratorit të shoqërisë, por edhe referuar “pasqyrave financiare” të shoqërisë “****” sh.p.k., evidentohen edhe deklaramëve për investime të tjera, makineri dhe pajisje, të cilat i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit, ndërsa të ardhurat dhe fitimi i shoqërisë për vitet 2013 dhe 2014 (dhe më tej) pasqyrohen në informacionin e marrë nga DRT-ja Korçë.

23.30.iv Nga analizimi i dokumentacionit, Komisioni vërejti se në bilancin e vitit 2014 të shoqërisë “****” sh.p.k., në zërin “aktive afatgjata materiale, ndërtesa”, vlera është në shumën 3.404.878 lekë. Gjithashtu u konstatua se kjo vlerë përputhet me ekstraktin e librit të blerjeve gjatë vitit 2014, i cili pasqyron të gjitha blerjet në lidhje me këtë investim. Kjo shumë totale

⁸⁵ Pyetësor nr. 2, datë 13.7.2022.

prej 3.404.878 lekësh rezultoi e njëjtë me atë të pasqyruar në bilancin e vitit 2014, vit ky që rezulton me fitim në vlerën 4.698.676 lekë.

23.30.v Gjithashtu rezultoi se bashkëshorti i subjektit kishte nënshkruar kontratë qiraje në datën 3.1.2015⁸⁶ me shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori K.P, për ½ pjesë takuese të tij në pikën e karburantit. Vlera e qirasë konfirmohet në shumën 150.000 lekë/muaj.

23.30.vi Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2015, si dhe deklaratës *Vetting*, rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontratën e qirasë⁸⁷ datë 3.1.2015, si dhe të ardhurat e përfituara prej saj prej vitit 2015 e në vijim. Po ashtu, edhe subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e vitit 2015 e në vijim, si dhe në atë *Vetting*, të ardhurat nga qiraja e pasurisë nr. ***, z. k. ***, Bilisht, Devoll, e llojit “pikë karburanti dhe truall” me sip. 720 m².

23.30.vii Gjithashtu, po nga analizimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni konstatoi se vlera mujore *neto* e qirasë ka kaluar në favor të bashkëshortit të subjektit nëpërmjet sistemit bankar. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se për të ardhurat e përfituara nga qiraja është paguar tatimi në burim⁸⁸ dhe për pasojë ato legjitimohen në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ky fakt konfirmohet edhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë⁸⁹, e cila informon se shoqëria “****” sh.p.k. ushtron aktivitetin tregtar në ambient me qira, sipas kontratave të qirasë (bashkëlidhur shkresës), për të cilën rezulton se janë kryer pagesat e tatimit në burim brenda afateve ligjore sipas formularit të pagesave.

23.30.viii Rezultoi se shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, ka kryer pagesat me bazë tremujore, sipas përshkrimit në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3

Data	Shuma e paguar (në lekë)	Banka ku është kryer pagesa
29.4.2015	382,500	RFZ Bank
14.7.2015	382,500	RFZ Bank
7.10.2015	382,500	RFZ Bank
6.1.2016	382,500	BKT
16.6.2016	382,500	BKT
21.10.2016	382,500	RFZ Bank
4.1.2017	382,500	RFZ Bank
26.1.2017	382,500	BKT

23.30.ix Nga të dhënat e akteve në dosjen e hetimit administrativ, më konkretisht sipas të dhënave⁹⁰ të QKB-së (certifikatë regjistrimi), DP Tatimeve⁹¹, aktit të themelimit, statusit të shoqërisë, etj., rezulton se shtetasi E.G ushtron aktivitetin e tij në disa fusha, ku ndër të tjera edhe tregtimin me shumicë të karburantit në pikat e ngritura nën logon “****” sh.p.k. Gjithashtu rezulton se ai ka qenë i punësuar në subjektet “****” sh.p.k. prej datës 1.12.2011 deri më 26.7.2013 dhe “****” sh.p.k. prej datës 31.10.2013 deri aktualisht, në cilësinë e administratorit.

23.30.x Komisioni hetoi lidhur me njohjen dhe marrëdhënien e shtetasit E.G me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj, e cila ka konkluduar në marrëdhënie bashkëpronësie. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit⁹², ka konfirmuar se bashkëshorti i saj ka lidhje familjare dhe

⁸⁶Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁷ Shihni kontratën datë 3.1.2015 me afat 3-vjeçar, në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. ***.

⁸⁸ Referohuni shkresës nr. *** prot., datë 25.1.2017, të DRT Korçë, aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁰ Administruar në aneksin nr*** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2022, nga Drejtoria Rajonale Korçë.

⁹² Nr. **, datë 13.7.2022.

shoqërore me shtetasin G (bashkëshortja e këtij të fundit E.P është kushëriri e bashkëshortit të subjektit dhe njëkohësisht është vajza e motrës V.P (P) të shtetasit K.P, administrator i “****” sh.p.k.), ka punuar si drejtor i shitjeve (sipas deklaramit të tij në pozicionin e punës) në kompaninë e tregtimit të karburanteve “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.

23.30.xi Në lidhje me rënien në dijeni të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për shitjen e kësaj pasurie nga shtetasi K, subjekti ka deklaruar⁹³ se: *“Shtetasi G, duke qenë i fokusuar në fushën e tregtimit të karburanteve, ka pasur kontakte edhe me pikën e tregtimit të karburanteve të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. në qytetin e Bilishtit dhe për shkak të punës së tij është vënë në dijeni se shtetasi N.K e kishte nxjerrë në shitje ‘pikën e karburantit’ në këtë qytet dhe nga ana e tij ka pasur interes për ta blerë pasurinë e nxjerrë në shitje nga N.K me qëllim ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve, por nuk ka pasur mundësi të mjaftueshme financiare për ta blerë këtë pikë tregtimi karburanti i vetëm, për shkak të vlerës që kërkohej nga shitësi. Pas komunikimit me bashkëshortin është bërë me dije për aktin se bashkëshorti im në marrëveshje me investitorët e pallatit N.L dhe vëllain tim R.Ç kishin rënë dakord për anulimin e aktpremtim shitjes për blerje ambiente banimi dhe shërbimi dhe ka shfaqur dakordësinë që nëse edhe shtetasi K binte dakord kjo shumë e kredisë t’i kalonte atij dhe mandej të lidhnin kontratë për blerjen e pikës së karburantit, si dhe të përcaktonin modalitetet e shlyerjes së saj dhe raportet ndërmjet tyre...”*

23.30.xii Subjekti ka deklaruar se pas komunikimit ishte rënë dakord për shitjen dhe transferimin e shumës së kredisë në llogarinë e shtetasit K dhe më tej për kryerjen e veprimeve për lidhjen e kontratës së shitjes, si dhe që ky shtetas të aplikonte për dokumentet e pronësisë në zyrën e regjistrimit të pasurive.

23.30.xiii Subjekti ka deklaruar gjithashtu se shtetasi G nuk mund të dilte bashkëkredimarrës, pasi nuk plotësonte kushtet për të marrë përsipër shlyerjen e saj në masën 50% dhe për të hyrë në marrëdhënie direkt me OTP Bank, pasi kredia ishte çelur dhe disbursuar dhe në këto kushte ka nënshkruar pas 4 ditëve të disbursimit dhe kalimit të saj shtetasit K deklaratën noteriale, sipas së cilës ka deklaruar se njeh dhe merr përsipër çdolloj detyrimi ndaj bankës nga e cila është siguruar kredia në masën 50%, aq sa do të jetë bashkëpronësia në karburantin që do të blihet. Në funksion të përgjigjes së dhënë, subjekti ka depozituar 12 dokumente provuese, ku përshihen edhe certifikatat e pronësisë objekti i këtij hetimi administrativ.

23.30.xiv Në lidhje me ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas, nga korrespondenca e mbajtur me gjykatat ku subjekti ka ushtruar dhe ushtron detyrën e saj funksionale nuk është konfirmuar ndonjë rast i gjykimit të ndonjë çështjeje, të çdo natyre, nga subjekti i rivlerësimit ndaj shtetasit G⁹⁴ apo kompanisë që ai zotëron.

23.30.xv Nga korrespondenca e mbajtur me organet ligjzbatuese nuk është konfirmuar⁹⁵ ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetasit G.

23.30.xvi Në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial, nga aktet e administruara, konkretisht sipas kartelës së pasurisë⁹⁶, rezulton se pasuria ndërtesë me sip. 110 m², e cila funksionon si pikë karburanti, është rivlerësuar nga shitësit e saj në datën 31.8.2012 në shumën 5.973.000 lekë, shumë e barabartë me vlerën në të cilën iu shit kjo pasuri blerësve/bashkëpronarëve GJ dhe G.

⁹³ Referuar pyetësorit nr. 2, datë 13.7.2022.

⁹⁴ Dokumentacion i depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 3, datë 14.9.2022, vërtetim nr. *** prot., datë 16.9.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe vërtetim nr. *** prot., datë 16.9.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁹⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2022, të SPAK, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁶ Provë e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. *** si dhe në aktet shoqëruese në praktikën e ASHK-së, përcjellë për Komision me nr. *** prot., datë 7.2.2020.

23.30.xvii Komisioni hetoi edhe lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit midis subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit të saj, lidhur me zhvillimin e ndonjë procesi gjyqësor të çdo lloji natyre, me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k., për shkak se nga hetimi rezultoi se shtetasi E.G ishte administrator i saj. Për këtë çështje subjekti ka deklaruar⁹⁷ se gjatë ushtrimit të detyrës së saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë nuk ka kryer ndonjë proces gjyqësor me këtë palë ndërgjyqëse dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar vërtetimet⁹⁸ përkatëse të dy gjykata ku ka ushtruar dhe ushtron funksionin e saj. Nga verifikimi i akteve të depozituara trupi gjykues konkludoi se konfirmohet ky fakt.

23.30.xviii Nën këto rrethana faktiko-ligjore, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar me vërtetësi e saktësi bashkëpronësinë në pasurinë objekt hetimi me shtetasin E.G dhe se veprimet e njëpasnjëshme të kryera prej tij lidhur me këtë pasuri, me investimet e kryera në të, me marrëdhëniet kontraktore të realizuara, si veprime bankare për shlyerje të kredisë, veprime noteriale të vullnetshme për lidhje kontraktore, të dhëna mbi ushtrim biznesi, të dhëna për pagesa tatimore, janë konfirmuar në nivel institucional, duke mos mbetur shpjegimet vetëm në nivel deklarativ dhe njëkohësisht në asnjë rast nuk u konfirmua që veprimet mes palëve kontraktore të kenë qenë të prirura apo ndikuara nga funksioni i subjektit të rivlerësimit.

24. Shtesë objekti me sipërfaqe rreth 60 m², në pasurinë e bashkuar nr. * në Bilisht, e ndërtuar nga shitësi i pasurisë N.K, aplikuar për legalizim pranë ALUIZNI-t Korçë, datë 23.7.2014 (aplikimi nga blerësit J.GJ dhe E.G sipas aktmarrëveshjes me shitësin), pa u përcaktuar ndonjë vlerë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁹⁹ disa dokumente¹⁰⁰.**

Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi si vijon:

24.1 Në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2014, në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit aplikimi për legalizim në muajin qershor 2014 për një objekt me sip. 60 m² (përshtatur si bar-kafe e karburantit) ngjitur me pasurinë e mësipërme, për të cilin deri në fund të vitit 2014 nuk është disponuar nga ALUIZNI.

24.2 Nga verifikimi i deklaratës së interesave private periodike vjetore 2015 rezultoi se në rubrikën “të dhënat konfidenciale”, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2015. Komisioni konstatoi se në deklaratë noteriale pasqyrohen detaje lidhur me dakordësinë e palëve për investimin e kryer nga shitësit e pasurisë në ndërtimin pa leje, si dhe lidhur me transferimin e të drejtës së aplikimit për legalizim blerësve të saj, shtetasve G dhe Gj.

Nga dokumentacioni i administruar, ALUIZNI, Drejtoria Korçë¹⁰¹, konfirmon se shtetasi J. GJ rezulton aplikues me vetëdeklarim nr. *** prot., kod unik ***, dhe po ashtu konfirmon dhe bashkëngjit edhe: deklaratën për përfshirjen në procedurat e legalizimit datë 23.7.2014, për

⁹⁷ Në prapësimet e depozituara në Komision.

⁹⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰⁰ Deklaratë për përfshirjen në procedurat e legalizimit, ALUIZNI Korçë, në emër të shtetasve E.G dhe J.GJ, datë 23.7.2014, të ndërtimit në vitin 1998 në Bilisht; shkresë nr. ***prot., datë 24.1.2017, nga ALUIZNI, drejtuar shtetasve E.G dhe J. Gj; deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.12.2015, me deklaruesit N.K, M.K, E.G dhe J.GJ. Mandatpagesa në “ProCredit Bank” nga blerësit është derdhur në llogarinë e shtetasit N.K shuma 9.800.000 lekë, me destinacion kalim për blerje objekti (karburant); urdhër transfertë e brendshme në “ProCredit Bank”, datë 11.10.2012, derdhur shuma 9.800.000 lekë nga J.GJ, me përfitues N.K, me përshkrimin “kalim për blerje objekti (karburant)”; mandatarkëtimi datë 11.10.2012, i shumës 9.800.000 lekë, nga shtetasi J.GJ; deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.10.2012, aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰¹ Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2017.

ndërtim pa leje në vitin 1998¹⁰²; certifikatën nr. ***, datë 28.1.2013, të truallit me sip. 720 m² dhe të ndërtesës me sip. 110 m², në emër të bashkëpronarëve E.G dhe J.GJ; fotografi; kopje e ID-së; kartelën e pasurisë; hartën treguese të regjistrimit; procesverbalin e verifikimit në terren nga ALUIZNI Korçë, në emër të shtetasve E.G dhe J.GJ.

24.3 Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.1.2015, deklaruesit N.K, M.K, E.G dhe J. GJ deklarojnë reciprokisht se kanë realizuar shitblerjen e pasurisë me sip. 720 m² dhe ndërtimit me sip. 110 m² mbi të, sipas dy kontratave të shitjes (cituar më sipër në këtë vendimmarrje) në shumën 7.341.000 lekë dhe se diferenca e vlerës së shitjes e transferuar nga shuma 9.800.000 lekë (kredia e disbursuar), që është 2.459 000 lekë, përfaqëson në marrëveshje mes tyre shumën 500.000 lekë për katër çisternat të cilat blerësit janë dakordësuar për t'i mbajtur dhe për vlerën tjetër të mbetur në shumën 1.959.000 lekë deklarojnë se e njohin si shlyerje të investimit në objektin pa leje të ndërtuar prej tyre. Më konkretisht, për këtë të fundit në këtë akt noterial, blerësit K kanë deklaruar se në pronën e shitur më parë është ndërtuar pa leje përpara vitit 1999 një objekt për afërsisht me sip. 60 m². Po ashtu shitësit kanë deklaruar dakordësinë që legalizimi i objektit të finalizohet nga blerësit e pasurisë.

24.4 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se subjekti ka konfirmuar¹⁰³ të njëjtat të dhëna lidhur me këtë ndërtim dhe pagesën e kryer për të edhe në ILDKPKI kur është pyetur.

24.5 Po ashtu subjekti, në përgjigjen e dhënë¹⁰⁴ gjatë hetimit të Komisionit lidhur me shpenzimin e kryer në këtë investim, pjesët takuese dhe burimin e krijimit të tij, ka deklaruar: *“...ndërtesa e përshtatur si ‘bar-kafe’ e karburantit ka qenë objekt ekzistues i ndërtuar nga shitësi dhe se ishte rënë dakord që me hapjen e procesit për legalizim në vitin 2014 të vijonin procedurat e aplikimit, pasi shitësi N.K ishte likuiduar edhe për vlerën e këtij objekti brenda shumës së kredisë. Subjekti ka referuar deklaratën noteriale të palëve nr. ***, datë 13.1.2015, me këto modalitete. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të vitit 2014 të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. rezulton investim në ndërtesë në shumën 3.404.878 lekë”*.

24.6 Subjekti ka depozituar pamje fotografike të ndërtimit përpara dhe pas investimit, për të cilët bën diferencën, duke cituar se është investuar në zgjerimin e dritareve me qëllim vendosjen e fasadave prej xhami. Subjekti ka qartësuar se nga bashkëshorti i saj nuk është bërë asnjë investim në këtë objekt, pasi ato janë kryer nga bashkëpronari dhe shoqëria “***” sh.p.k. sipas marrëveshjes dhe kontratës së huapërdorjes me të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i aktivitetit prej vitit 2013 deri në datën e fillimit të pagesës së qirasë dhe janë evidentuar në “pasqyrat financiare” të vitit 2014. Subjekti ka deklaruar se objekti është legalizuar me vendimin nr. ***, datë 20.1.2022, për ndërtim pa leje një kat me sipërfaqe ndërtimi 70.9 m² në emër të bashkëshortëve J dhe Etleva Gjamo, si dhe E dhe E.G dhe se objekti është në proces regjistrimi.

24.7 Subjekti ka depozituar dokumentacion, ku përfshihet praktika e legalizimit të objektit, kopje e librit të blerjeve të shoqërisë “***” sh.p.k., vendimin e legalizimit, planimetrinë, etj.

24.8 Komisioni i kërkoi ASIG të konfirmojë kohën e ndërtimit të këtij objekti, nga informacioni¹⁰⁵ i të cilit konfirmohet se informacioni gjeohapësinor më i hershëm që zotërohet për territorin e z. k. *** Bilisht është ortofoto e vitit 2007, realizuar nga fotografimi ajror 2007 - 2008, kohë në të cilën konfirmojnë ndërtesën dhe lartësinë e ndërtimit një kat (diferenca midis kuotës së tokës me kuotën e ndërtesës).

¹⁰² Administruar si aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰³ Referuar përgjigjes së pyetjes nr. 6 në procesverbalin datë 10.2.2015, administruar në dosjen e hetimit administrativ, dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020.

¹⁰⁴ Me pyetësorin nr. 2, datë 13.7.2022.

¹⁰⁵ Konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2022.

24.9 Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se si burim krijimi për këtë investim është kredia e marrë në ish-bankën “Societe Generale Albania”, e cila sipas konfirmimit bankar ishte parapaguar plotësisht në vitin 2012, pavarësisht se kontratat e shitjes rezultuan të hartuara më pas.

24.10 Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar me vërtetësi dhe saktësi origjinën e fitimit të pasurisë “bar - kafe”, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj “kreditë”, i cili rezulton në përputhje me kërkesat e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

25. Tokë bujqësore e përfituar në fshatin V, Devoll, me sipërfaqe 3.300 m² (ndarë normë për frymë), në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, sipas AMTP-së plotësuar në emër të babait GJ.GJ. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës¹⁰⁶ disa dokumente¹⁰⁷.

Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi si vijon:

25.1 Në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2010, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar tokë bujqësore me sip. 4.000 m² (normë për frymë) në V, Devoll, nga ligji nr. 7501, regjistruar në emër të shtetasit GJ.GJ në bashkëpronësi, e pandarë.

25.2 ZVRPP-ja Devoll, me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2018¹⁰⁸, konfirmon se shtetasi GJ.J.GJ është trajtuar me tokë në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën”, në z. k. ***, V, me aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. ***, datë 10.10.1993 (bashkëngjitur informacionit të dhënë) dhe në kartelat e pasurive të paluajtshme figurojnë të regjistruara pasuritë e poshtëshënuara:

- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 900 m², me AMTP-në nr.*** dhe sipas LN janar ***, 830 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ

- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 1.000 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 1.401 m², në z. k. ***, V, Devoll në emër të z. GJ.J.GJ.

- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 900 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 290 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.

- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 900 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 221 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.

- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 900 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 260 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.

¹⁰⁶ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 9.1.2015, nga Komuna Qendër Bilisht, në emër të z. GJ.GJ është trajtuar me tokë nga ligji nr. 7501 me 3.300 m² për frymë; Akti i Marrjes së Tokës në dorëzim nr. *** regj., datë 10.10.1993, në emër të z. GJ.GJ, në fshatin V, Devoll, i cili përfiton 10.220 m² gjithsej; certifikatë familjare; vërtetim datë 25.10.2016, nga ZVRPP-ja Devoll, në të cilën vërtetohet se në emër të z. GJ.GJ ka të regjistruar pasuritë në fshatin V si vijon: pasurinë nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, e llojit “arë”; pasurinë nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, e llojit “arë” me sipërfaqe totale 1.000 m²; pasurinë nr. ***, regjistruar në vol.***, f. ***, e llojit “arë” me sipërfaqe totale 900 m²; pasurinë nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, e llojit “arë” me sipërfaqe totale 900 m², etj.

¹⁰⁸Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 900 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 671 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 660 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 937 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 1.200 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 727 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 870 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 808 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 600 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 1.819 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 600 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 1.288 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 400 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 391 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 300 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 270 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. *** regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 1.100 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 1.318 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 7.900 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 6.563m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ, në bashkëpronësi me shtetasit V.K.XH, T.I.P, A.V.G dhe A.D.M.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë”, me sipërfaqe totale 900 m², me AMTP-në nr. *** dhe sipas LN janar ***, 258 m², në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.
- Pasuria nr. ***, regjistruar vol. ***, f. ***, zëri kadastral “arë + truall”, me sipërfaqe totale 744 m², nga këto 300 m² truall dhe 204 m² ndërtesë, me ref. ***, në z. k. ***, V, Devoll, në emër të z. GJ.J.GJ.

25.3 Sipas certifikatës së përbërjes familjare¹⁰⁹ lëshuar nga Njësia Bashkiake, Komuna Bilisht, në datë 6.1.2015, rezulton se në vitin 1991 shtetasi J.GJ ka qenë pjesë përbërë e saj dhe, për pasojë, ka përfitur në bashkëpronësi të barabartë në pasuritë e lartpërmendura.

25.4 Subjekti është pyetur lidhur me mospërputhjen e konstatuar në deklarin e bashkëshortit të saj të kryer në vitin 2010, ku deklaroi tokë bujqësore me sip. 4.000 m² (normë për frymë)

¹⁰⁹ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

në V, Devoll, nga ligji nr. 7501, regjistruar në emër të shtetasit GJ.GJ në bashkëpronësi e pandarë deklarimin e bërë në *Vetting*, sipërfaqe 3.300 m² (ndarë normë për frymë).

25.5 Në përgjigjen e dhënë subjekti ka sqaruar se bashkëshorti e ka informuar që në deklarimin e tij për herë të parë për vitin 2010 ka deklaruar tokë bujqësore me sip. 4.000 m², pasi sipas informacionit që i ka dhënë babai i tij GJ.GJ, në pronësi të familjes me përfaqësues GJ.GJ janë dhënë në pronësi 14 dynym (14.000) m² tokë, pavarësisht se në “aktin e marrjes së tokës në pronësi” nr. ***, datë 10.10.1993, plotësuar në emër të babait të bashkëshortit GJ.GJ, janë shënuar 9.820 m² (nga të cilat 9.520 m² tokë arë dhe 300 m² pemëtore) dhe po sipas deklarimit të babait të tij, nga ish-Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshat ishin bërë me dije se sipas ligjit personat familjes që kanë qenë në marrëdhënie pune me shtetin do të marrin jo më tepër se 1 dynym (1.000 m²). Ka parashtruar se ...”sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën” dhe VKM-së Nr. 255/1991 në zbatim të tij, toka ndahet si “normë për frymë” në bazë të numrit të frymëve që figurojnë në gjendjen familjare në datën 1.8.1991 e mbi këtë bazë plotësohet Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi në emër të kryefamiljarit. Po kështu, parashikohet se... në numrin e frymëve të familjes anëtare të kooperativës bujqësore do të llogariten fëmijët, nxënësit, studentët, ushtarët, pensionistët, duke përfshirë anëtarët e familjes që në momentin e ndarjes së tokës janë në marrëdhënie pune të përhershme me shtetin, për të cilët në pikën 2, paragrafi 3, parashikohet se do t’u jepet në pronësi gjysma e tokës për frymë që i takon çdo anëtar të kooperativës bujqësore, por jo më shumë se 1 dynym....”.

25.6 Subjekti ka sqaruar se bashkëshorti e ka informuar që babai i tij GJ.GJ dhe vëllai TH.GJ kanë qenë në marrëdhënie pune me shtetin dhe, për këtë arsye bashkëshorti ka deklaruar 4.000 m² tokë bujqësore në pronësi si normë për frymë për subjektet e tjera përfituese të ligjit (nëna e bashkëshortit, bashkëshorti dhe vëllai J.GJ) dhe nga 1.000 m² tokë në pronësi dhënë babait dhe vëllait si persona që kanë qenë në marrëdhënie pune me shtetin.

25.7 Lidhur me deklarimin nga bashkëshorti të sipërfaqes së tokës bujqësore në DPV/2010, subjekti qartëson se është pyetur edhe në ILDKPKI në vitin 2015 dhe meqenëse i është kërkuar dokumentacion, bashkëshorti i saj është pajisur me vërtetim nr. *** prot., datë 9.1.2015, nga ish-Komuna Qendër Bilisht, sipas të cilit pasqyrohet norma për fryme prej 3.300 m².

25.8 Subjekti qartëson se: “Duke qenë një akt zyrtar, që dokumentonte normën për frymë, e kam depozituar si provë fillimisht në ILDKPKI dhe mandej bashkëshorti im i është referuar këtij dokumenti edhe në deklaratën *Vetting*”. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës: vërtetim nr. *** prot., datë 9.1.2015, i ish-Komunës Qendër Bilisht; vërtetim datë 25.10.2016, i ish-ZVRPP-së Devoll (2 flete); Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 10.10.1993, në emër të shtetasit GJ.GJ.

25.9 Gjithashtu, subjekti është pyetur¹¹⁰ lidhur me mosdeklarimin e bashkëshortit të saj të ndërtesës me sip. 204 m² sipas konfirmimit nga ZVRPP-ja Devoll, koston përkatëse të ndërtimit, si dhe burimin e krijimit.

25.9.i Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar se nga shqyrtimi i dokumentacionit që disponojnë, përkatësisht vërtetimi datë 25.10.2016, i ish-ZVRPP-së Devoll, me nr. rendor ***, konstatojnë se pasuria nr. *** është e regjistruar në vol. ***, faqe ***, lloji i pasurisë “truall + arë”, me sipërfaqe totale 744 dhe 300 m² truall dhe 204 ndërtesë me 0001. Subjekti ka deklaruar se vërtetimi si më sipër është depozituar si provë së bashku me deklaratën *Vetting*.

25.9.ii Në vijim të përgjigjes, subjekti ka sqaruar se bashkëshorti e ka informuar se referuar dokumentacionit që disponohet në emër të atit të tij GJ.GJ, por edhe origjinës së regjistrimit (cituar në vërtetimin si më sipër), kjo pasuri pasqyron shtëpinë e banimit të ndodhur në fshatin

¹¹⁰ Me pyetësonin nr. 4, datë 21.9.2022.

V të rrethit Devoll, e cila është ndërtuar rreth vitit 1955 nga babai i bashkëshortit. Në vijim, subjekti është shprehur: “... në këtë pasuri bashkëshorti më informon se duke qenë ekzistuese nuk ka dhënë asnjë lloj kontributi dhe nuk tërheq të drejta pronësie/bashkëpronësie në asnjë nga mënyrat e fitimit të pronësisë/bashkëpronësisë të parashikuara në legjislacionin shqiptar. Sipas bashkëshortit, fakti që kjo pasuri është regjistruar në emër të babait të tij jo si pasuri personale e tij, por si përfaqësues i familjes, nuk e bën automatikisht bashkëpronar dhe, për këtë arsye, nuk ka deklaruar pjesë takuese të pandarë në emrin e tij, por ka depozituar vërtetimin datë 25.10.2016, të ZVRPP-së Devoll, ku krahas tokave bujqësore që janë dhënë për anëtarët e familjes bujqësore sipas gjendjes familjare datë 1.8.1991, figuron edhe shtëpia e banimit dhe trualli përreth saj”.

25.9.iii Sa i takon mënyrës së regjistrimit të banesës në fshatin V, ajo është e njëjtë me mënyrën e regjistrimit të banesave sipas VKM-së Nr. 432, datë 14.8.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonat urbane të fshatit”.

25.9.iv Subjekti sa dhënë sqarime bazuar edhe në referenca ligjore. Më konkretisht, ka shpjeguar se: “Sipas AMTP-së nr. ***, datë 15.4.1993, plotësuar në emër të babait të bashkëshortit GJ.GJ rezulton e pasqyruar toka arë, pemëtore dhe truall, nga të cilat tokë arë 9.520 m² dhe 300 m² pemëtore, gjithsej 9.820 m² dhe në këtë sipërfaqe nuk është përfshirë trualli i banesës pasqyruar me sip. 400 m², pasi ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’ (neni 3 i tij) parashikonte dhënie në pronësi vetëm të tokës bujqësore, në konceptin e së cilës (neni 1 i ligjit) nuk përfshihen tokat e zëna me ndërtimet e banimit dhe oborret (avllitë) e tyre, të cilat konsiderohen ‘toka jobujqësore’, ndërsa sipas konceptit të nenit 1 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, ‘Për shitblerjen e trojeve’, konsiderohen ‘troje’. Bashkëshorti më informon se banesa e ndërtuar nga babai i tij ndodhet brenda vijave kufizuese të fshatit V dhe trualli për ndërtim i është dhënë babait të tij GJ.GJ me akt nga pushteti vendor i kohës së ndërtimit, por që në mungesë të këtij dokumentacioni, regjistrimi është bërë me ‘listën emërore *** të trojeve dhe shtëpive’, e cila e pasqyron truall të gjithë sipërfaqen 744 m², ndërsa vërtetimi i ish-ZVRPP-së Devoll e pasqyron arë + truall”.

25.9.v Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës listën e trojeve dhe shtëpive në fshatin V, rrethi Devoll, fotografi të gjendjes aktuale të banesës në këtë fshat, vërtetimin nr. *** prot., datë 28.9.2022, të Bashkisë Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, bashkëngjitur tij edhe procesverbali datë 27.9.2022, i kryetarit të fshatit V, i konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e pushtetit vendor, si dhe fotografi të objektit.

25.10 Në gjendjen që ndodheshin aktet, Komisioni konstatoi se: (a) origjina e kësaj pasurie është ligji nr. 7501/1991, sipas AMTP-së dhe sipas listës së trojeve 0***, plotësuese e këtij ligji, për ndërtimet përpara vitit 1991; (b) regjistrimi i pasurisë me sip. 204 m² është bërë në emër të z. GJ.GJ, por si kryefamiljar i familjes bujqësore (me status F); (c) ligji nr. 7501/1991 kushtëzohet me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.8.1991, kohë në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë pjesë përbërëse e trungut familjar.

25.11 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit¹¹¹ të jepte shpjegime, pasi rezultoi se bashkëshorti i saj nuk kishte deklaruar në deklaratën Vetting bashkëpronësinë në pasurinë me nr. ***, e llojit “truall + arë”, me sipërfaqe totale 744 dhe 300 m² truall dhe 204 m² ndërtesë me ***.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

25.12 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ka parashtruar thujtë të njëjtat shpjegime dhe ka dhënë të njëjtat referenca ligjore si në konstatimin e bërë për pasurinë nr. ***, trajtuar

¹¹¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

më sipër në këtë vendimmarrje, konkretisht në deklarinimin e pasurive të saj të prejardhura nga ligji nr. 7501/1991. Subjekti ka cituar edhe në këtë rast përgjigjen e ASHK-së Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes, e cila ka pasqyruar se: *“...pasuria ‘truall’ nuk ka qenë objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’. Trojet dhe objektet mbi to në zonën urbane të fshatit janë regjistruar pranë ish-ZVRPP-ve, sot Drejtoritë Vendore të ASHK-së, sipas listave të trojeve me referencë ***, referuar VKM-së Nr.432, datë 14.8.1995, ‘Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit’. Pronarë legjitimë të këtyre pasurive janë individët të cilët janë përcaktuar në listat e trojeve dhe shtëpive si dhe individët sipas regjimit pasuror martesor, referuar dispozitave të Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë...”*.

25.13 Subjekti, në referencë të qëndrimit të ASHK-së, ka sqaruar se del e qartë që regjistrimi fillestar i pasurisë nr. *** (shtëpia në fshat) në emër të babait të bashkëshortit GJ.J.GJ si përfaqësues i familjes bujqësore me gjendjen familjare në datën 1.8.1991, nuk ka asnjë bazë ligjore dhe, për këtë arsye, ajo i ka qëndruar shpjegimit të saj se edhe bashkëshorti J.GJ nuk tërheq të drejta pronësie/bashkëpronësi në këtë banesë, për sa kohë nuk ka fituar ndonjë nga këto të drejta me një nga mënyrat e fitimit të pronësisë të parashikuara në Kodin Civil apo në ligje të veçanta.

25.14 Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri rezulton e regjistruar nga ish-ZVRPP-në Devoll në emër të babait të bashkëshortit si përfaqësues i familjes bujqësore jo në përputhje me ligjin dhe rregullat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme nr. 7843/1994, “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si ligj në fuqi në kohën e regjistrimit, i cili në nenin 38 të tij, ndër të tjera, parashikonte se: *“Në rastet kur shteti, personi fizik ose juridik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë. Regjistrimi i fitimit të pronësisë, sipas këtij neni, bëhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën ‘h’ dhe në paragrafin e fundit të nenit 193 të Kodit Civil”*.

25.15 Gjithashtu subjekti ka shprehur qëndrimin e saj në lidhje me efektet e regjistrimit referuar edhe vendimit unifikues civil nr. 1, datë 6.1.2009, të Gjykatës së Lartë, ku, ndër të tjera, shprehet se: *“Sipas legjislacionit shqiptar sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk ka efekt krijues, por thjesht publikues, njohës, pasi janë aktet bazë mbi të drejtat reale të pronësisë që krijojnë, ndryshojnë apo mbarojnë të drejtat përkatëse dhe jo regjistrimi i akteve”*.

25.16 Njëkohësisht, subjekti ka sqaruar se kjo pasuri vijon ekzistuese e regjistruar në emër të babait të bashkëshortit pa asnjë shënim hipotekor, gjë që tregon se nga bashkëshorti nuk është kryer asnjë veprim që të tregojë se është sjellë si bashkëpronar apo të ketë ushtruar të drejta bashkëpronësie, përveç përdorimit të saj gjatë jetesës në fshat në familjen e origjinës.

25.17 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve, ka depozituar: shkresën nr. *** ap., datë 20.10.2022, e ASHK Drejtoria Vendore Korçë; shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2022, të ASHK Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes; shkresën nr. *** ap., datë 10.10.2022, e ASHK-së Korçë, Zyra Vendore Devoll; vendimin unifikues civil nr. 1, datë 6.1.2009; vendimin nr. ***, datë 25.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të formës së prerë; si dhe vendimin nr. ***, datë 13.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të formës së prerë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

25.18 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorë dhe prapësimet, si dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson dhe arsyeton si vijon:

25.18.i Në tërësi, nga hetimi i kryer në lidhje me origjinën e pasurisë objekt i këtij hetimi administrativ, bazuar në certifikatën e përbërjes familjare datë 1.8.1991¹¹², rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është anëtar i familjes bujqësore në përputhje me kriteret përcaktuese për të qenë përfitues i pasurisë së përshkruar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (më tej AMTP) nr. ***, datë 15.4.1993, sipas ligjit nr. 7501/1991. Në këtë kontekst, konkludohet se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar me saktësi pjesën e tij takuese në pasurinë e përfituar sipas kësaj AMTP-je¹¹³.

25.18.ii Në lidhje me ekzistencën e objektit të ndërtuar në pasurinë e lartpërmendur, origjinën e fitimit të saj, kontributin e dhënë në këtë investim, marrëdhënien e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me të, si dhe konstatimin e mosdeklarimit të saj në deklaratën *Vetting*, provat e administruara dhe shpjegimet e subjektit, parë në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm, pasqyruan faktin se për sa kohë: (a) pasuria rezultoi e regjistruar në listën emërore të trojeve dhe shtëpive; (b) regjistrimi i objekteve përpara vitit 1991 është mundësuar me VKM-në Nr. 432/1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”; (c) regjistrimi i pasurive nën statusin “F” kur ligji nr. 7501/1991 nuk përfshin në objektin e zbatimit të tij tokën “truall” dhe ndërtimin e bërë mbi të, atëherë mosdeklarimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për bashkëpronësinë e objektit edhe në eventualitetin e një pasaktësie, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk mund të afektojë procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

26. Automjet tip “Lancia” me targa *** (jashtë qarkullimit prej vitit 2011, por e pa çregjistruar) në bashkëpronësi me shtetasin DH.J, blerë me kontratë shitjeje datë 2.2.2009, kundrejt vlerës 250.000 lekë. Vlera: 250.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹¹⁴. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi si vijon:

26.1 Bashkëshorti i subjektit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, deklaroi automjet tip “Lancia”, me targa ***, në bashkëpronësi me shtetasin DH.J, blerë me kontratë shitblerjeje në vitin 2009, vlera 250.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

26.2 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2020, informon se shtetasi J.GJ.GJ ka pasur të regjistruar në DPSHTRR automjetin me targa *** (me status çregjistrim i përhershëm).

26.3 Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion kontratë shitblerjeje automjeti me nr. ***, datë 2.2.2009¹¹⁵, me palë shitëse E.N dhe palë blerëse DH.J dhe J.GJ, të automjetit tip “Lancia”, me targa ***, në vlerën 250.000 lekë. Ky automjet është çregjistruar në vitin 2017.

26.4 Meqenëse ky automjet rezultoi në bashkëpronësi me shtetasin DH.J, Komisioni e ka pyetur¹¹⁶ subjektin lidhur me shpenzimet e secilit prej tyre për këtë investim, si dhe për marrëdhënien e tyre me këtë shtetas.

¹¹² Lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bilisht, në datën 6.1.2015, administruar në Dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹³ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹⁴ Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së, kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 2.2.2009, me palë shitëse E.N dhe palë blerëse DH.J dhe J.GJ, të automjetit tip “Lancia” me targa ***, në vlerën 250.000 lekë. Leje qarkullimi në emër të DH.J dhe J.GJ.

¹¹⁵ Pasuria është blerë nga bashkëshorti i subjektit përpara martesës.

¹¹⁶ Pyetësor nr. 2, datë 13.7.2022.

26.5 Në përgjigje¹¹⁷ subjekti ka sqaruar se bashkëshorti i saj ka lidhje krushqie familjare me shtetasin DH.J, pasi bashkëshortja e tij, shtetësja D.A.SH (J), është kushërirë e dytë. Përveç lidhjes familjare ata ndër vite kanë krijuar edhe lidhje shoqërore. Për shkak të kësaj marrëdhënieje kanë rënë dakord që mjetin ta blinin në bashkëpronësi dhe e kanë përdorur sipas nevojave të tyre. Subjekti ka sqaruar se ky mjet për shkak të dëmtimit gjatë përdorimit nga bashkëpronari DH.J ka dalë fizikisht nga përdorimi që në vitin 2011 dhe është hequr nga qarkullimi në datën 4.7.2017 në bazë të ligjit nr. 33, viti 2017. Ndërsa heqja e përhershme nga qarkullimi është bërë pas aplikimit të bashkëshortit J.GJ sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 21.3.2018, të DSHTRR-së Korçë.

26.6 Lidhur me kontributin, subjekti ka sqaruar se ai ka qenë i barabartë për secilin blerës bashkëpronar në shumën 125.000 lekë secili. Subjekti ka depozituar nëntë dokumente shkresore ku, ndër të tjera, edhe certifikata të gjendjes familjare për të provuar marrëdhënien familjare të deklaruar me shtetasin J, i cili sipas certifikatës datë 13.7.2022, të Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Korçë, rezulton se nuk jeton më prej datës 19.8.2020.

26.7 Lidhur me mundësinë financiare të bashkëshortit të subjektit për të investuar në këtë pasuri përpara lidhjes së martesës, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika, pasi të ardhurat e tij nga ushtrimi i aktivitetit privat (***), në raport me shpenzimet, kanë qenë të mjaftueshme.

26.8 Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime lidhur me konstatimin se nuk ishte deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26.9 Subjekti i rivlerësimit është shprehur se qëndron konstatimi i Komisionit lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie dhe se sipas informacionit të dhënë nga bashkëshorti i saj për këtë problematikë ai ka sqaruar se duke mos qenë subjekt deklarues dhe në kushtet kur deklaronte për herë të parë, deklarimi është shoqëruar edhe me gabime njerëzore, pasi ka deklaruar këtë pasuri të luajtshme (automjet) duke e përshkruar sipas llojit, vitit të krijimit dhe çmimit të blerjes, por nuk ka shënuar burimin e krijimit. Subjekti është se *kjo mënyrë konceptimi e plotësimit të deklaratës (për shkak edhe të faktit se bashkëshorti nuk ka qenë subjekt deklarues më parë, vijon edhe për elemente të tjerë të deklaramit që cilëson rubrika “Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme” përveç elementit “burimi i krijimit”, duke u pasqyruar vetëm ato të dhëna që janë përshkruar për këtë mjet.*

26.10 Subjekti ka deklaruar se *bashkëshorti i saj deri në lidhjen e martesës ligjore (datë 24.5.2010) ka jetuar në familjen e origjinës dhe shpenzimet e jetesës së tyre, si dhe çdo lloj shpenzimi tjetër të kryer nga anëtarët e familjes janë përballuar në tërësi nga të ardhurat e bashkëshortit nga puna, nga të ardhurat e prindërve nga pensionet që merrnin në Shqipëri dhe mandej në shtetin grek, si dhe prodhimet bujqësore dhe blegtorale, për shkak të jetesës në fshat të cilat ishin për konsum të drejtpërdrejtë, duke qenë në një ekonomi të përbashkët... dhe se shpenzimet janë përballuar nga tërësia e të ardhurave.*

26.11 Lidhur me burimin e krijimit të automjetit tip “Lancia”, subjekti ka sqaruar sikurse e ka informuar bashkëshorti i saj se prindërit e tij trajtoheshin me pension në shtetin grek prej vitit 2003 dhe deri në vitin 2009 të blerjes së automjetit të tij kishin tërhequr rregullisht pagesat të cilat janë ishin pjesë e tërësisë së të ardhurave familjare. Meqenëse këto të ardhura nuk kanë qenë të ndara, burim krijimi kanë qenë të ardhurat nga puna e bashkëshortit të saj, të ardhurat e prindërve të tij nga pensionet, pra të ardhurat e gjithë familjes.

¹¹⁷ Shihni pyetësorin nr. 2, datë 13.7.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

26.12 Subjekti ka parashtruar se për këtë mjet është pyetur edhe në ILDKPKI në vitin 2015, jo për burimin e krijimit, por i është kërkuar vetëm “kontrata e shitblerjes”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

26.13 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në raport me faktet e konstatuara se pasuria: (a) është krijuar përpara martesës me subjektin e rivlerësimit; (b) është deklaruar në DPV/2010 me të gjithë të dhënat dhe karakteristikat e saj dhe e konfirmuar jashtë qarkullimit që prej vitit 2011; (c) është krijuar me burime të ligjshme pasi nga përllogaritjet financiare të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor për periudhën 1995 – 2010 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka rezultuar në balancë pozitive – çmon se mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë/automjet, i pashoqëruar me mungesë të burimit financiar për një pasuri para martesë, nuk afekton procesin e rivlerësimit të subjektit. Kjo çmuarje e trupit gjykues veç analizës së fakteve provuese, i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit, si dhe aplikimit të parimit të proporcionalitetit në funksion të përmbushjes së qëllimit të ligjit nr.84/2016.

27. Ambient zyrë me sip. 30 m², marrë me qira për ushtrimin e aktivitetit të * në Bilisht, Devoll,** nga qiradhënësi A.K, në vlerën 10.000 lekë/muaj. Kontratë e lidhur në datën 1.1.2013 me afat 1-vjeçar (e ripërtërirë çdo vit në heshtje). Vlera: 10.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë qiraje datë 1.1.2013, me palë qiradhënëse A.K dhe palë qiramarrëse J.GJ, e një njësie shërbimi me sip. 30 m², e regjistruar në emër të qiradhënësit me nr. pasurie ***, në z. k. ***, vol. ***, f. ***, në Bilisht, Devoll, në shumën 10.000 lekë/muaj me afat 1-vjeçar; si dhe certifikatë për vërtetim pronësie datë 8.5.2006¹¹⁸.

27.1 Nga hetimi i Komisionit për këtë çështje u konstatua se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar rregullisht në DVP-të përkatëse këtë qiramarrje, si dhe në organet tatimore, pasi është adresa e deklaruar e aktivitetit të tij privat si noter.

27.2 Gjithashtu, për vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramit u konstatua se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e qirasë në datën 1.1.2013 me shtetasin A.K. Kontrata është nënshkruar me afat zbatimi 1 vit, me të drejtë ripërtëritje. Kontrata rezulton e hartuar në formën e kërkuar nga ligji. Ajo ka parashikuar objektin, vlerën mujore të qirasë në shumën 10.000 lekë, si dhe afatin për depozitimin e saj, përkatësisht deri në datën 5 të muajit pasardhës. Pasuria e dhënë me qira konfirmohet se është në emër të qiradhënësit, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 8.5.2006, në të cilën pasqyrohet pasuria e llojit “njësi”, me sip. 30 m².

27.3 Në lidhje me ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin A.K, nga korrespondenca e mbajtur me gjykatat ku subjekti ka ushtruar dhe ushtron detyrën e saj funksionale nuk është konfirmuar¹¹⁹ ndonjë rast i gjykimit të ndonjë çështje ku palë ndërgjyqëse apo kërkuar me çfarëdolloj statusi të kenë qenë ky shtetas.

27.4 Nga hetimi i kryer për këtë pasuri, trupi gjykues nuk konstatoi probleme, nuk krijoi dyshime lidhur me origjinën e kësaj pasurie apo edhe mbi marrëdhënien e bashkëshortit të subjektit me këtë pasuri.

28. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, në pronësi, e paregjistruar në shtetin shqiptar, regjistruar në Bullgari (si shtetas me shtetësi bullgare), blerë në Bullgari në shumën 4.500 euro, me kontratë shitblerjeje të vitit 2009¹²⁰, blerë me të ardhurat nga puna si *** prej**

¹¹⁸ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹⁹ Dokumentacion i depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 3, datë 14.9.2022: vërtetim nr. *** prot., datë 16.9.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe vërtetim nr. *** prot., datë 16.9.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

¹²⁰ Pasuri e krijuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit përpara martesës.

vitit 2005. Vlera: 4.500 euro. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin e blerjes së kësaj pasurie në shtetin bullgar¹²¹.

Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezultoi si vijon:

28.1 Bashkëshorti i subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, deklaroi automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë në vitin 2009. Vlera: 4.500 euro. Pjesa takuese: 100%. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

28.2 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2020, nuk e konfirmon mjetin e deklaruar.

28.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në ILDKPKI¹²² se ky automjet është blerë në Bullgari dhe është regjistruar vetëm atje, pasi bashkëshorti është me shtetësi bullgare prej vitit 2006. Gjithashtu, me këtë deklaram, subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes, kopjen e pasaportës së bashkëshortit, lejen e qarkullimit të automjetit dhe kopjen e kartës së identitetit po të bashkëshortit, në gjuhën bullgare. Komisioni i kërkoi¹²³ subjektit që ky dokumentacion të depozitohet i përkthyer në formën e kërkuar nga ligji. Nga dokumentacioni i administruar në gjuhën shqipe konfirmohet shtetësia e dytë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i kontratës për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, datë 16.11.2009, u vërejt se vlera e shitjes ishte përcaktuar 1.000 leva, shumë kjo që korrespondon me vlerën rreth 510 euro. Rezultoi se kjo vlerë është më e ulët nga ajo që deklaroi subjekti prej 4.500 euro.

28.4 Komisioni në përlogaritje mori në konsideratë vlerën prej 4.500 euro të deklaruar nga subjekti.

28.5 Komisioni nuk vlerësoi të kryejë analizë financiare lidhur me mundësinë e krijimit të kësaj pasurie në datën e krijimit, pasi mundësia për kursim e rezultuar deri më 2006 është në një vlerë të konsiderueshme, si dhe të ardhurat nga noteria për vitet në vijim janë mëse të mjaftueshme për të kryer këtë investim.

28.6 Për sa më sipër¹²⁴, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion lidhur me mospërputhjen e konstatuar midis vlerës 510 euro të blerjes së pasurisë në shtetin bullgar dhe vlerës së deklaruar në deklaratat përkatëse të pasurisë në shumën 4.500 euro.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28.7 Subjekti, në shpjegimet e saj, ka pranuar që ky konstatim i Komisionit qëndron dhe, ndër të tjera, ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka shtetësi bullgare prej vitit 2006 dhe automjeti tip “Mercedes-Benz” me targa *** është blerë prej tij në Bullgari në bazë të aktit “Marrëveshje për shitblerje automjetesh”, datë 16.11.2009, e përkthyer, e noterizuar dhe se në përgjigje të pyetësorit nr. 4, përveç këtij dokumenti ka depozituar edhe: leje qarkullimi datë 17.11.2019, e përkthyer, e noterizuar; certifikatë regjistrimi, me datë lëshimi 7.11.2009, e përkthyer, e noterizuar; kartë identiteti në emër të shtetasit J.GJ, me datë lëshimi 15.5.2000, e përkthyer, e noterizuar; pasaportë në emër të shtetasit J.GJ, me datë lëshimi 27.1.2006, e përkthyer, e noterizuar.

28.8 Lidhur me çmimin e blerjes së pasqyruar në kontratë në shumën 1.000 leva bullgare (510 euro), subjekti ka sqaruar se sipas informacionit të dhënë nga bashkëshorti i saj, automjeti është blerë në vlerën e deklaruar prej tij 4.500 euro, por për shkak të kohës së gjatë nga momenti i

¹²¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²² Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 10.2.2015, akt i përcjellë me dokumentacionin e këtij institucioni, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020.

¹²³ Me pyetësorin nr. 4, datë 21.9.2022.

¹²⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

blerjes mban mend vetëm faktin që pagesa është bërë *cash* jashtë zyrës noteriale, por me shitësin nuk mban mend të ketë hartuar ndonjë dokument për këtë shumë pagese dhe nuk disponon ndonjë të tillë.

28.9 Subjekti ka sqaruar gjithashtu, sipas informacionit të dhënë nga bashkëshorti i saj, se pas nënshkrimit të kontratës, meqenëse ajo është hartuar në gjuhën bullgare, nuk i ka kushtuar rëndësi verifikimit të vlerës së pasqyruar nga noteri si çmim i shitjes prej 1.000 leva, pasi shitësit ia kishte paguar më parë çmimin prej 4.500 euro dhe mandej ka depozituar kontratën në “zyrën e automjeteve”, ku ishte i regjistruar mjeti i shitësit, është pajisur me lejen e qarkullimit dhe dokumentet e tjera dhe ka marrë mjetin të cilin e ka sjellë në Shqipëri.

28.10 Subjekti ka shpjeguar, sikurse i ka sqaruar bashkëshorti i saj, se në kohën e bisedimeve me shitësin për blerjen e mjetit ishte interesuar edhe për çmimin mbi bazën e të cilit bëhej zhdoganimi i mjeteve të këtij lloji dhe viti i prodhimit, pasi mund ta zhdoganonte për ta mbajtur me targë shqiptare, si dhe për të krijuar një ide me të qartë për vlerën e tregut. Pas këtyre informacioneve ka pranuar ta blejë kundrejt vlerës 4.500 euro sipas dakordësisë me shitësin.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Edhe po t’i referohemi të dhënave të mjetit për modelin ‘C 220 CDI Classic’ dhe vitin e prodhimit 2002 (të cilat rezultojnë në lejen e qarkullimit), bashkëshorti më referon në të dhënat zyrtare me të cilat operojnë doganat shqiptare për efekt të llogaritjes së vlerës së mallrave për qëllime doganore”*.

28.11 Subjekti gjithashtu shprehet se nga një informacion i siguruar nga bashkëshorti rezulton se me shkresën datë 19.1.2010 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i ka dërguar të gjitha degëve doganore “të dhëna të disponueshme” për çmimet e shitjes së autoveturave të miratuara nga Ministria e Financave me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2020, të siguruara nga buletini “Quattroroute” nr. ***, janar 2010. Nga të dhënat e buletinit për modelin “C 220 CDI Classic” dhe vitin e prodhimit 2002, referenca është 3-4 mijë euro.

28.12 Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka deklaruar çmimin realisht të paguar prej tij për blerjen e automjetit prej 4.500 euro, pavarësisht pasqyrimin të çmimit në kontratën e shitjes.

28.13 Subjekti ka depozituar kopje të shkresës datë 19.1.2010, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe printim nga buletini “Quattroroute”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

28.14 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar, në këtë çështje konstaton se nga verifikimi i të dhënave të administruara lidhur me referencat e zhdoganimit (buletini “Quattroroute”) të mjetit objekt i këtij hetimi, nisur nga parametrat që ai ka, vërehet se automjeti ka një vlerë më të lartë në shitje sesa në fakt është konkretizuar në aktin e shitjes për 1.000 leva. Mbi këto të dhëna në çdo rast të mundshëm mjeti do të zhdoganohej nën referencën e shitjes 3.000 - 4.000 euro, sikurse pasqyron dokumentacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe, në këto kushte, minimalisht ajo që mbetet e provuar është fakti se pagesa për zhdoganim do të ishte më e lartë sesa vlera 1.000 leva që është përcaktuar në kontratën e shitjes.

28.15 Trupi gjykues, duke konsideruar shpjegimet e subjektit, faktin që shuma e investuar për blerjen e automjetit është deklaruar nga subjekti në mënyrë konsistente, por dhe për sa kohë shuma mbështetet edhe në referenca zyrtare, çmon bindës deklarin e këtij investimi. Nga ana tjetër, në kushtet kur rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi financiare për blerjen e pasurisë së krijuar përpara martesës me subjektin, atëherë mospërputhja e konstatuar për vlerën e investuar duket të mbetet një problematikë që nuk mund të mbartet apo të rëndojë pozitën e subjektit në këtë proces.

29. Ambient zyrë, me sipërfaqe 14 m², kati i dytë, pallati përballë lulishtes “*”, Korçë,** në përdorim, bazuar në aktmarrëveshjen (pa të drejtë pronësie) datë 20.12.2008, me shitës “***” sh.p.k., shlyer një vlerë prej 400.000 lekësh në datën 30.12.2008 (pasuri e rënë në marrëveshje përpara martesës me subjektin e rivlerësimit), me të ardhurat nga puna si noter. Nuk është lidhur kontrata e shitjes, pasi nuk është paguar diferenca e çmimit. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës¹²⁵ disa dokumente.

- Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri, duke mbajtur në konsideratë edhe konstatimin e ILDKPKI-së, rezultoi si vijon:

29.1 Në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2010, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar ambient zyrë me sip. 14 m², e paregjistruar, e bazuar në aktpremtim shitjen me shitës “***” sh.p.k., në vlerën 1.400.000 lekë.

29.2 Shoqëria “***” sh.p.k., me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2017¹²⁶, deklaroi se me klientin J.GJ është lidhur aktmarrëveshje (pa të drejtë pronësie) për shitjen e një ambienti dyqan (zyrë) në banesën kolektive me emërimin “*** Korçë”. Në aktmarrëveshje çmimi i shitjes është 1.400.000 lekë, sipas së cilës thuhet se është paguar vlera 400.000 lekë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ndërsa diferenca do të paguhej në janar të vitit 2009. Deri në datën 18.7.2017 nuk është kryer asnjë likuidim tjetër nga ana e klientit J.GJ. Si pasojë, firma ndërtuese e ka nxjerrë në shitje objektin, duke i kthyer detyrimin përkatës klientit të mësipërm.

29.3 Sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 30.12.2008¹²⁷, z. J.GJ ka arkëtuar në favor të kësaj shoqërie shumë 400.000 lekë, me përshkrim “likuidim pjesor zyrë”.

29.4 Sipas vërtetimit të kësaj shoqërie, datë 12.1.2015, thuhet se deri në këtë kohë nuk është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë, pasi ajo është regjistruar në vitin 2014. Po ashtu, në këtë vërtetim pasqyrohet edhe dakordësia e rënë më parë mes shoqërisë me porositësin Gj për shumë totale të objektit të porositur prej 1.400.000 lekësh, parapagimin në shumë 400.000 lekë, por edhe duke konfirmuar mosshlyerjen e shumë prej 1.000.000 lekësh.

29.5 Sipas të dhënave të grumbulluara dhe analizuara duket se shuma 1.000.000 lekë nuk është shlyer për shkak të regjistrimit të pasurisë në vitin 2014, ndërsa ishte parashikuar shlyerja e saj në vitin 2009.

29.6 Subjekti, në përgjigjen e dhënë¹²⁸ lidhur me qartësimin e situatës së kësaj çështjeje në tërësi, shlyerjen e shumë 400.000 lekë, ka deklaruar: *“...dua të theksoj se bashkëshorti e ka lidhur këtë ‘aktmarrëveshje’ përpara martesës tonë. Në atë kohë ai ishte i interesuar për blerjen e një zyre në qytetin e Korçës, pasi po kryente tratativa për ta zhvendosur zyrën e tij noteriale në këtë qytet. Më pas, meqenëse shoqëria nuk po regjistronte objektin e saj, bashkëshorti nuk kishte më interes për të. Ky vendim i është komunikuar edhe shoqërisë. Për këtë arsye ne nënshkruam në vitin 2012 aktpremtim shitje për blerje apartament banimi dhe zyrë, e cila nuk u finalizua, shpjegime që i kam dhënë në pyetësin nr. 2, datë 13.7.2022. Meqenëse ‘aktmarrëveshja pa të drejtë pronësie’ nuk u finalizua sepse objekti nuk po regjistrohej, si dhe për faktin se bashkëshorti nuk arriti që të zhvendosej në Korçë, nuk kishte më interes për blerjen e zyrës në qytetin e Korçës. Në marrëveshje verbale me shoqërinë kemi*

¹²⁵ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, vërtetim nr. *** rep., datë 20.12.2008; aktmarrëveshje datë 20.12.2008, me shoqërinë e ndërtimit “***” sh.p.k.; mandatpagesë nr. ***, datë 30.12.2008, paguar shuma 400.000 lekë nga z. J.GJ, me përshkrimin “Likuidim pjesor ***” shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k.; vërtetim nr. ***, datë 12.1.2015; vërtetim datë 12.1.2015, shoqëria “***” sh.p.k. me klientin J.GJ në datën 20.12.2008.

¹²⁶ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²⁷ Shihni dokumentin në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. ***.

¹²⁸ Në pyetësin nr. 3, datë 14.9.2022.

rënë dakord që në momentin e shitjes së zyrës nga ana e shoqërisë palët do të ktheheshin në gjendjen e mëparshme”.

29.7 Subjekti ka deklaruar se shuma e parapaguar prej 400.000 lekësh i është kthyer bashkëshortit të saj me “transfertë bankare” në llogarinë e tij në BKT, në datën 18.12.2019, me përshkrimin “kthim për prishje kontrate blerje zyrë Banesa ****” dhe se pas kthimit të shumës prej 400.000 lekësh palët kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.12.2019, ku kanë deklaruar edhe arsyet e prishjes së “aktmarrëveshjes pa të drejtë pronësie”, si dhe faktin e kthimit të shumës.

29.8 Subjekti ka deklaruar se meqenëse në këtë deklaratë është konstatuar një gabim material i noterit (shënuar janar 2019, duhej janar 2009), palët nënshkruan “shtojcë deklarate” nr. ***, datë 28.1.2020, duke bërë korigjimin nga janar 2019 në janar 2009.

29.9 Komisioni verifikoi informacionin e RNSH-së përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, si dhe aksesoi në sistemin multifunksional, nga ku nuk u konfirmua tjetërsim i kësaj pasurie në emër të shtetasit Gj, ndërsa deri aktualisht nga dokumentacioni i administruar¹²⁹ pasuria vijon të rezultojë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

29.10 Për sa rezultoi më sipër, Komisioni¹³⁰ i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion, pasi në deklaratën e vitit 2010 bashkëshorti i saj nuk kishte deklaruar detyrimin e mbetur prej 1.000.000 lekësh për t’u shlyer në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

29.11 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se bashkëshorti e ka lidhur këtë aktmarrëveshje përpara martesës, pasi në atë kohë ai ishte i interesuar për blerjen e një zyre në qytetin e Korçës, pasi po bënte përpjekje për ta zhvendosur zyrën e tij *** në këtë qytet. Pas lidhjes së martesës, në DPV/2010 bashkëshorti ka deklaruar “ambient zyrë, e paregjistruar, bazuar në aktpremtim shitjen datë 20.12.2008, në vlerën 1.400.000 lekë”. Nga kjo mënyrë deklarimi dhe sikurse e ka informuar bashkëshorti, pasi ai deklaronte për herë të parë, ka shënuar vlerën tërësore për të cilën palët kishin rënë dakord për shitblerjen e objektit dhe nuk ka pasqyruar as faktin se nga kjo vlerë ishte parapaguar me mandat nr. ***, datë 30.12.2008, vlera prej 400.000 lekësh dhe as faktin se mbetej edhe një vlerë prej 1.000.000 lekësh për t’u shlyer, por duke referuar në përmbajtjen e rubrikës për deklarim ku kërkohet ndër të tjera “deklarimi i vlerës në lekë që pasqyrohet në dokumentet që dispononi”, ka deklaruar vlerën 1.400.000 lekë.

29.12 Subjekti, në qëndrimin e saj, ka deklaruar, po sikurse e ka informuar bashkëshorti, se në “marrëveshjen pa të drejtë pronësie” ishin parashikuar kushtet e blerjes së pronës, përkatësisht: *blerësi do të fitojë të drejtën e pronës pasi shitësi të arkëtojë të gjitha lekët sipas preventivit të dyqanit. Pas kësaj shitësi detyrohet të lidhë kontratën dhe pas kësaj blerësit i lind e drejta ta regjistrojë pronën në hipotekë dhe të gëzojë të drejtat mbi të dhe se sipas tij shoqëria nuk kishte plotësuar kushtin për t’i krijuar mundësi blerësit të lidhte kontratën në janar 2009, si pasqyrohej në akt, pasi sendi nuk ishte i regjistruar në hipotekë në këtë kohë dhe as në vitin 2010, pasi nuk ka pasur ndonjë njoftim nga shitësi për regjistrimin e objektit dhe lidhjen e kontratës së shitjes dhe për këtë arsye, në mungesë të finalizimit të një kontrate shitjeje, nuk është deklaruar si detyrim i mbetur shuma prej 1.000.000 lekësh në deklaratën e vitit 2010.*

¹²⁹ Referohuni informacionit të dhënë nga ASHK Drejtoria Vendore Korçë, me nr. *** ap., datë 19.9.2022, përcjellë nga subjekti me pyetësin nr. 3, datë 14.9.2022.

¹³⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

29.13 Subjekti ka deklaruar se pas kërkesës për sqarime në ILDKPKI në vitin 2015, ka depozituar dokumentacionin e pagesës së shumës 400.000 lekë.

29.14 Subjekti ka sqaruar se kjo pasaktësi në deklarimin e vitit 2010, ku më pas palët ishin kthyer në gjendjen e mëparshme, nuk ka pasjellë asnjë pasojë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

29.15 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, duke marrë në konsideratë: (a) ekzistencën e aktmarrëveshjes së nënshkruar prej vitit 2008 për këtë pasuri, e cila ka parashikuar pagesën e vlerës 400.000 lekë në momentin e nënshkrimit të saj; (b) shlyerjen e këtij detyrimi të parashikuar, provuar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 30.12.2008, pra në kohë reale; (c) mosshlyerjen e shumës së mbetur 1.000.000 lekë sipas aktmarrëveshjes, për të cilën në asnjë rast nuk u provua e kundërta me ndonjë akt shkresor; (ç) faktin që aktmarrëveshja kishte parashikuar se shlyerja e plotë në vitin 2009 do të bëhej në kushtet e regjistrimit të pasurisë, por kjo nuk rezultoi e provuar, ndërsa u konstatua se pasuria ishte regjistruar në vitin 2014; (d) faktin që aktmarrëveshja e nënshkruar përpara lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit është deklaruar nga bashkëshorti që në vitin 2010; dhe (dh) faktin që shoqëria ndërtimore ka konfirmuar kthimin e shumës së parapaguar në vitin 2008, me “transfertë bankare” në llogarinë e tij në BKT në datën 18.12.2019, me përshkrimin “kthim për prishje kontrate blerje zyrë Banesa ***” – çmon se nuk evidentohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin tërësor për subjektin e rivlerësimit.

30. Llogari bankare në “Raiffeisen Bank”, dega Bilisht, gjendje datë 24.1.2017 (derdhje të qirasë dhe shlyerjes së kredisë nga bashkëpronari E.G i pasurisë nr. ***, ndodhur në Bilisht dhe qiramarrësi “****” sh.p.k). Vlera: 2.016.222 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare datë 24.1.2017¹³¹, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasit J.GJ, në vlerën 2.016.222 lekë.

30.1 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2022, informon se shtetasi J.GJ ka llogari pranë kësaj banke me gjendje në datën 30.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në shumën 2.013.019,43 lekë.

30.2 Nga dokumentacioni i administruar Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

31. Llogari bankare në “Bankës Kombëtare Tregtare, dega Bilisht, gjendje datë 27.1.2017 (nga derdhje të pagesave për akte noteriale nga bashkëpunimi me *** (projekti i gazsjellësit TAP). Vlera: 3.013.270 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare datë 26.1.2017¹³², nga BKT, në emër të “J.GJ” si person fizik, në vlerën 3.013.270 lekë.

31.1 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, informon se J.GJ ka llogari si person fizik pranë kësaj banke me gjendje në datën 30.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në shumën 2.865.345,56 lekë.

31.2 Nga dokumentacioni i administruar Komisioni konstatoi se gjendja e deklaruar prej bashkëshortit të subjektit përputhet me gjendjen e datës 31.12.2016.

32. Llogari bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, dega Bilisht, gjendje datë 26.1.2017 (derdhje, qira nga “****” sh.p.k.). Vlera: 450.352 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka

¹³¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³² Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare datë 26.1.2017¹³³, nga BKT, në emër të shtetasit J.GJ, në vlerën 450.352 lekë.

32.1 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2020 informon se shtetasi J.GJ ka llogari pranë kësaj banke me gjendje në datën 30.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, në shumën 50.352,96 lekë.

32.2 Nga dokumentacioni i administruar Komisioni konstatoi se gjendja e deklaruar prej bashkëshortit të subjektit përputhet me gjendjen e datës 26.7.2017.

33. Të ardhura të kursyera nga paga si gjyqtare e bashkëshortes dhe të ardhurat nga puna si noter, gjendje cash të paregjistruara. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

33.1 Nga verifikimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë kursime *cash* në DPV/2006 e në vijim. Prej vitit 2010 kursimet në *cash* janë deklaruar së bashku me ato të bashkëshortit.

33.2 Deklarimi sipas çdo viti është kryer më përshkrimin si më poshtë vijon. Komisioni, në tabelën e mëposhtme, ka pasqyruar edhe shumën e akumuluar, e cila është përfshirë në analizën financiare të detajuar të çdo viti.

Tabela nr. 4

Viti	Përshkrimi sipas deklarimit periodik	Shuma e deklaruar në DPV	Shuma e akumuluar sipas përlllogaritjeve të Komisionit
2006	Kursime nga paga gjatë vitit që i disponoj, të padepozituara në bankë, gjendje cash në banesë 500.000 lekë	500,000	500,000
2007	Kursime nga paga e marrë gjatë vitit 2007 nga puna si gjyqtare, të padepozituara apo regjistruara, gjendje cash, gjithsej 450.000 lekë	450,000	450,000
2008	Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2008, të paregjistruara, gjendje cash, gjithsej 450.000 lekë	450,000	450,000
2009	Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2009, nga puna, të paregjistruara, gjendje cash, gjithsej 200.000 lekë	200,000	200,000
2010	Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2010, si dhe të holla të kursyera nga të ardhurat e bashkëshortit, cash të paregjistruara	800,000	1,000,000
2010 Bashkëshorti	Të ardhura nga puna si ndihmësgjyqtar 1993 – 2000, të ardhura nga puna si avokat 2000 – 2005 dhe të ardhura nga puna si noter 2005 – 2009, kesh të paregjistruara	30,000 euro	30,000 euro
2011	Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2011, si dhe të holla të kursyera nga të	1,500,000	2,500,000 lekë dhe 30,000 euro

¹³³ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

	<i>ardhurat e bashkëshortit nga puna si ***, cash të paregjistruara</i>		
2012	<i>Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare, si dhe të holla të kursyera nga të ardhurat e bashkëshortit, gjendje cash të paregjistruara</i>	1,000,000	1,000,000
2013	<i>Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare, si dhe të holla të kursyera nga të ardhurat e bashkëshortit, gjendje cash të paregjistruara</i>	300,000	300,000
2014	<i>Të holla të kursyera nga paga si gjyqtare, si dhe nga të ardhurat e bashkëshortit nga puna si noter, cash të paregjistruara</i>	100,000	400,000
2015	<i>Nuk ka deklarin</i>		400,000
2016	<i>Nuk ka deklarin</i>		400,000
<i>Vetting</i>		1,000,000	1,000,000

33.3 Duke iu referuar deklarinimit të subjektit dhe bashkëshortit të saj, Komisioni, për të përlogaritur gjendjen e akumuluar të kursimeve *cash*, ka konsideruar shtesa ato vite kur subjekti ka deklaruar kursime të vitit, pra, duke specifikuar se janë kursime të vitit dhe gjendje kur ka specifikuar kursime gjendje *cash*. Në vitet që nuk ka deklarim, vlera e kursimeve të vitit paraardhës është mbartur si e pa ndryshuar në vitin pasardhës.

33.4 Lidhur me deklarinimin e bashkëshortit në vitin 2010, i cili deklaroi se ka 30.000 euro *cash*, Komisioni e ka pyetur¹³⁴ subjektin për këtë shumë dhe se si ka evoluar ajo në vite. Subjekti, në përgjigje, ka deklaruar se: “Në deklaratën periodike të vitit 2010 unë kam deklaruar kursimet tona të krijuara si bashkëshortë në *cash* në vlerën 800.000 lekë. Përkatësisht kam deklaruar të holla të kursyera nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2010 dhe të holla të kursyera nga të ardhurat e bashkëshortit, *cash*, të paregjistruara në vlerën 800.000 lekë. Deklarimi i bashkëshortit tim i përket të ardhurave të krijuara prej tij në vite, si dhe nga dhurimi i prindërve.

*Këto të ardhura në vite përfaqësohen nga puna si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë në periudhën 6.12.1993 – 15.5.2000, të ardhurat nga puna si *** për periudhën 2000 – 2005 (të cilat sipas deklarinimeve të bashkëshortit, për periudhën 2000 – 2005 kanë qenë në kuadrin e konsulencave dhe përfaqësime me prokurë, vërtetuar edhe me vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi ka qenë i pajisur me certifikatën e ***, por nuk ka qenë i regjistruar në organin tatimor) si dhe të ardhurat nga ushtrimi i detyrës së ‘noterit’ (për të cilat kam dhënë shpjegime dhe kam paraqitur dokumentacion financiar në ‘pyetësorin nr. 2’). Vlera prej 30.000 euro nuk është një shumë që e kemi disponuar *cash* në vitin 2010. Dukshëm duket edhe nga deklarimi i kryer nga ana ime, ku për vitin 2010 kemi kursyer vetëm 800.000 lekë. Deklarimi për herë të parë prej tij, duke mos qenë subjekt deklarues, është shoqëruar edhe me gabime njerëzore, por që ne si bashkëshortë nuk e kemi pasur atë shumë, qartësisht duket edhe nga deklarinimet e mëtejshme të kryera nga ana jonë”.*

33.5 Lidhur me shumën 30.000 euro, subjekti ka dhënë shpjegime për burimin e saj edhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI¹³⁵, datë 10.2.2015, ku është shprehur se në deklarinimin e bashkëshortit për këtë shumë në të, ka qenë e përfshirë edhe shuma 25.000 euro e dhuruar nga prindërit e bashkëshortit për martesë. Në mbështetje të këtij deklarimi ka depozituar në

¹³⁴ Pyetësor nr. 3 datë 14.9.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³⁵ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020.

ILDKPKI edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2015, të prindërve GJ.GJ dhe T.GJ për dhënien e shumës 25.000 euro me rastin e martesës nga pensionet e përfituara në shtetin grek si homogjenistë (për vitet 2003 – 2012 me një shumë mujore 200 - 350 euro secili ndër vite).

33.6 Nga hetimi i kryer rezulton se kjo shumë prej 25.000 euro, e dhuruar nga prindërit e bashkëshortit, nuk është deklaruar në DPV2010. Kjo shumë deklarohet në vitin 2015 në procesverbalin e ILDKPKI-së dhe në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu, nuk rezulton që kjo shumë të jetë përdorur si burim krijimi për asnjë nga investimet e bashkëshortit të subjektit, pra as shuma e dhuruar dhe as gjendja *cash* e supozuar prej 30.000 euro.

33.7 Pavarësisht deklaratimit të subjektit se shuma 30.000 euro nuk ka qenë gjendje *cash* në vitin 2010, Komisioni i ka qëndruar strikt deklaratimit periodik të kryer nga dy bashkëshortët dhe shumën 30.000 euro e ka përfshirë në analizë si gjendje *cash* për vitet 2010 dhe 2011. Ndërsa në vitin 2012 nuk e ka përfshirë pasi dy bashkëshortët kanë deklaruar gjendjen e kursimeve *cash*, e cila është 1.000.000 lekë.

33.8 Komisioni kreu analizën financiare të bashkëshortit të subjektit për periudhën 1995 – 2010 për të parë mundësitë financiare të tij për të kursyer shumën 30.000 euro, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara për 3 persona.

Tabela nr. 5

Nr.	Përshkrimi	1995 – 2010
1	TË ARDHURA	14,970,046
	Të ardhura nga paga 1995 – 2000	1,008,077
	Të ardhura 2005 – 2008	5,000,000
	Të ardhura nga aktiviteti 2009 – 2010	949,402
	Të ardhura nga pensioni shqiptar (prindërit) 1995 – 1999	299,770
	Të ardhura nga pensioni shqiptar (prindërit) 2000 – 2010	1,610,130
	Të ardhura nga pensioni grek (prindërit) për periudhën 2005 – maj 2010)	6,102,668
2	SHPENZIME	5,738,366
	Shpenzime jetese 1995 – 2000 (66%)	797,633
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së 2000 – 2009	3,294,882
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së 2010 (deri në maj me prindërit)	250,470
	Shpenzime TIMS	1,395,380
3	PASURI	7,344,622
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament me sip. 60 m ² (26.10.2006)	1,000,000
	Shtesa me sip. 109.8 m ² e përshtatur për banim e shtesës	1,000,000
	Ambient zyre me sip. 14 m ² (sipas aktpremtim shitjes datë 20.12.2008, paguar 400.000 lekë)	400,000
	Automjet *** (2009) (4.500 euro)	617,265
	Automjet “Lancia” ***, në bashkëpronësi me shtetasin DH.J (2.2.2009)	125,000
	<i>Banka + cash</i>	4,202,357
	DIFERENCA (1-2-3)	1,887,059

33.9 Nga analiza financiare Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi të kryejë investimet, të përballojë shpenzimet, si dhe të kursejë shumën 30.000 euro.

33.10 Komisioni¹³⁶ i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, pasi dukej se: (a) shuma 25.000 euro, e dhuruar nga prindërit e bashkëshortit, nuk është deklaruar në DPV/2010; (b) kishte mospërputhje lidhur me burimin e krijimit të shumës 30.000 euro, pasi në DPV/2010 bashkëshorti i subjektit deklaroi të ardhura nga punësimet, ndërsa në ILDKPKI është deklaruar edhe dhurimi prej 25.000 euro, me burim pensionet e prindërve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33.11 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrimet e saj, ka deklaruar sikurse e ka informuar bashkëshorti i saj, se duke mos qenë subjekt deklarues dhe në kushtet kur deklaronte për herë të parë, deklarimi është shoqëruar edhe me gabime njerëzore. Po kështu, edhe në rubrikën që i referohet gjendjes së likuiditeteve (nr. rendor 6, faqe 11 e deklaratës), subjekti ka deklaruar se bashkëshorti ka listuar të ardhura nga punësimi si ndihmës gjyqtar, si avokat dhe si noter për periudhën 1993 – 2009, duke përshkruar ngushtësisht vetëm punësimet e tij dhe periudhat e tyre (ndërsa të ardhurat e vitit të deklarimit 2010 nga puna si noter janë deklaruar në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private/publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, duke deklaruar *cash* shumën 30.000 euro).

33.12 Ajo ka deklaruar se *deri në lidhjen e martesës ligjore (24.5.2010) ai ka jetuar në familjen e origjinës dhe shpenzimet e jetesës së tyre, si dhe çdo lloj shpenzimi tjetër të kryer nga anëtarët e familjes janë përballuar në tërësi nga të ardhurat e bashkëshortit nga puna, nga të ardhurat e prindërve, nga pensionet që merrnin në Shqipëri dhe mandej në shtetin grek prej vitit 2003, si dhe prodhimet bujqësore dhe blegtorale, për shkak të jetesës në fshat të cilat ishin për konsum të drejtpërdrejtë.*

33.13 Subjekti ka sqaruar se familja e bashkëshortit, duke qenë në një ekonomi të përbashkët, të ardhurat që hynin në familje nga të gjitha burimet kanë qenë të përbashkëta, përfshi këtu edhe pensionet në monedhën euro që merrnin prindërit nga shteti grek si homogjenistë dhe, për këtë arsye, edhe shpenzimet janë përballuar nga tërësia e të ardhurave.

33.14 Lidhur me përcaktimin e burimit të krijimit të pasurive të deklaruara nga bashkëshorti në DPV/2010, subjekti ka sqaruar se ka dhënë shpjegime për herë të parë në ILDKPKI në vitin 2015, kur dhe i janë kërkuar, dhe se pas komunikimit me bashkëshortin ai e ka informuar se prindërit e tij trajtoheshin me pension në shtetin grek si homogjenistë prej vitit 2003 dhe këto pagesa kishin përfunduar në vitet 2011 dhe 2012 (për të cilat subjekti citon se ka dhënë shpjegime në pyetësin nr. 2).

33.15 Subjekti ka cilësuar se meqenëse këto të ardhura nuk kanë qenë të ndara, sikurse dhe e ka informuar bashkëshorti, ajo ka deklaruar në ILDKPKI në vitin 2015 si burim krijimi për ato që është pyetur, për të ardhurat nga puna dhe kontributin e prindërve nga pensionet e marra në shtetin grek, pra për të ardhurat e gjithë familjes, pasi edhe prindërit e tij në deklaratën e tyre noteriale janë shprehur se kanë kontribuar nga pensionet.

33.16 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti e ka informuar se shuma prej 30.000 euro e deklaruar prej tij në deklarin për herë të parë në vitin 2010 nuk ka qenë një shumë që e ka pasur *cash* në kohën e lidhjes së martesës së tyre ligjore, por kjo shumë ka përfaqësuar kontributin tërësor në monedhën euro që prindërit e tij i kanë dhënë nga të ardhurat e pensioneve prej vitit 2005 kur kanë filluar pagesat e vitit 2003 e në vijim, deri në lidhjen e martesës, ku përfshihet edhe shuma 25.000 euro si dhurim me rastin e martesës.

33.17 Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti, duke qenë se deklaronte për herë të parë, ka vlerësuar se shuma e të hollave të administruara prej tij deri në datën e lidhjes së martesës përfaqësohej nga të ardhurat, nga puna në pozicionet ku ka punuar dhe shuma në monedhën

¹³⁶ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

euro që i kanë dhënë prindërit nga pensionet që kanë marrë rregullisht në shtetin grek dhe se duke qenë në marrëdhënie familjare prindër - fëmijë dhe duke mos qenë as subjekt deklarimi, këto veprime të bashkëshortit të saj brenda familjes, që lidhen me mënyrën e administrimit të të ardhurave të familjes, nuk janë dokumentuar me akte formale në kohën kur janë kryer, ndaj dhe është nënshkruar deklarata noteriale që konfirmon kontributin nga të ardhurat duke i dhuruar shumën 25.000 euro, të cilën subjekti e ka depozituar kur i janë kërkuar sqarime në ILDKPKI.

33.18 Subjekti ka theksuar se bashkëshorti e ka informuar se shumën prej 25.000 euro, që ia kanë dhënë prindërit, e ka shpenzuar dhe nuk e ka pasur gjendje në datën e lidhjes së martesës dhe as me vonë, prandaj dhe nuk është deklaruar në DPV/2010 dhe as më vonë.

33.19 Subjekti ka deklaruar se, sikurse i ka rezultuar edhe Komisionit, pas martese nuk është kryer ndonjë shpenzim i deklarueshëm me burim krijimi shumën 25.000 euro.

33.20 Ajo ka theksuar se mosdisponimi i kësaj shume provohet edhe nga deklarimi i saj ku për vitin 2010 ka deklaruar se ka kursyer vetëm 800.000 lekë si kursime të tyre bashkëshorte nga të ardhurat nga punësimi.

33.21 Subjekti ka kërkuar që të mos llogaritet kjo shumë në emër të bashkëshortit në vitin 2010, për sa kohë ai, apo edhe si bashkëshorte, nuk e kanë disponuar në momentin e lidhjes së martesës ligjore dhe as më vonë. Kjo shumë nuk duhet të llogaritet as si gjendje e akumuluar e bashkëshortëve për vitin 2011, pasi ashtu si për vitin 2010, edhe për vitin 2011 kanë pasur vetëm kursimet nga punësimi.

33.22 Subjekti ka kundërshtuar mospërfshirjen në përlllogaritjet e kryera për vitet 1995 – 2010 e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti nga puna si avokat për periudhën 2000 – 2005, për të cilat ka cituar: *“...këto të ardhura kanë qenë në kuadrin e konsulencave dhe përfaqësime me prokurë, sikurse vërtetohen edhe me 46 vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi ai ka qenë i pajisur me certifikatën e ***, e cila është depozituar si provë dhe për arsye se ka kryer një numër të konsiderueshëm përfaqësimesh të dokumentuara me vendime gjyqësore, ka kërkuar që të zbriten shpenzimet e jetesës të llogaritura për bashkëshortin, të cilat janë llogaritur edhe për gjithë periudhën 2000 – 2005”*.

33.23 Subjekti ka pretenduar për ulje të shpenzimeve të jetesës deri në 30-35% po për këtë periudhë (1995 – 2005), duke pasur parasysh se në këtë kohë bashkëshorti i saj dhe familjarët e tij kanë jetuar në fshatin V të rrethit Devoll, në banesë në pronësi, ku për shkak të punimit të tokës të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, kanë siguruar edhe prodhime bujqësore për konsum.

33.24 Subjekti për këtë pretendim ka referuar vendimin e Kolegjit nr. ***, datë 18.6.2021, për subjektin e rivlerësimit K.S dhe vendimin nr. ***, datë 8.6.2022, për subjektin e rivlerësimit D.B.

33.25 Subjekti ka parashtruar pretendime edhe lidhur me të ardhurat e përlllogaritura nga aktiviteti i bashkëshortit të saj si *** për vitin 2010 dhe nën disa argumente të mbështetura në dokumentacionin zyrtar të DRT-së Korçë, të cilin e ka depozituar, ka kërkuar rishikimin e të dhënave sa i takon situatës financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkëshortit me qëllim që ato të rillogariten në bazë të dokumentacionit të depozituar, si dhe nën dritën e qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, vendimet e së cilës janë të formës së prerë.

33.26 Po ashtu, subjekti ka kërkuar edhe për reduktim të shpenzimeve të udhëtimeve të kryera, të pasqyruara nëpërmjet sistemit TIMS, nën pretendimin se pjesa dërrmuese e tyre janë udhëtime disa orë brenda dite në shtete fqinje si Greqi dhe Maqedoni.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

33.27 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të administruar në raport edhe me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për çështjen objekt hetimi administrativ, vlerëson se pretendimi i subjektit se gjendja *cash* e deklaruar prej bashkëshortit nuk ka ekzistuar në atë kohë, nuk merret në konsideratë, për faktin se Komisioni i ka qëndruar strikt deklaratimit periodik të kryer në atë kohë.

33.28 Me gjithë shpjegimet e subjektit se kemi të bëjmë me një gabim njerëzor në deklaratim, duke deklaruar se këtë shumë nuk e kanë disponuar gjendje *cash*, trupi gjykues vlerëson se konstatimi i mospërputhjes qëndron, porse në raport me faktin se konfirmohet mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, pasi u provuan: (a) të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortit nga pensioni i përfituar në shtetin grek; (b) të ardhurat e përfituara prej tyre edhe nga pensioni i pleqërisë në Shqipëri; (c) të ardhurat e bashkëshortit nga punësimet e tij në pozicione të ndryshme – konkludon se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi financiare të kursejë shumën 30.000 euro, të deklaruar prej tij në DPV/2010.

33.29 Nga ana tjetër, kjo situatë faktike vlerësohet si e tillë edhe për sa kohë përgjatë hetimit nuk u identifikua ndonjë pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit me burim krijimi gjendjen *cash* të deklaruar në vitin 2010 në shumën 30.000 euro, apo specifikisht me burim krijimi dhurimin e bërë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk u provua ndonjë investim tjetër nën këto zëra financiarë, atëherë analiza financiare, edhe duke përfshirë si gjendje *cash* shumën 30.000 euro, rezulton pozitive.

33.30 Në kushte të tilla, konstatimin e mosdeklarimit të saktë të gjendjes *cash* në deklaratën e vitit 2010, të pashoqëruar me mungesë të burimit të ligjshëm të krijimit të shumës 30.000 euro, si dhe me mospërdorimin e saj si burim i ndonjë pasurie tjetër, në çdo formë, trupi gjykues e çmon si pasaktësi, e cila nuk merr peshë në rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

33.31 Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2006 - 2016, për të parë mundësinë e dy bashkëshortëve për të krijuar kursimet e tyre në *cash*, nga ku rezultoi se dukej se bashkëshortët nuk kanë pasur mundësi financiare në vlerën 192.077 lekë për vitin 2010 dhe vlerën 286.291 lekë në vitin 2011, që të krijojnë kursimet e tyre, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës¹³⁷ për të dhënë argumente në lidhje me konstatimet e bëra.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33.32 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e saj, ka pasqyruar të ardhurat e siguruar në vitet 2010 dhe 2011, në të cilat ka rezultuar në balancë negative, duke i shoqëruar së bashku me dokumentacionin mbështetës. Subjekti në këto parashtrime ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse është shprehur më sipër për të analizuar të ardhurat e përfituara për vitin 2010.

33.33 Gjithashtu subjekti ka pretenduar për rishikim të analizës financiare nën pretendimet për ulje të shpenzimeve të udhëtimeve, për shkak se përgjithësisht ato kanë qenë brenda dite dhe disa orë, duke iu referuar edhe vendimit nr. ***, date 22.5.2019, për subjektin e rivlerësimit E.I, ulje të shpenzimeve të jetesës për shkak të jetesës së familjes në fshat dhe nën të njëjtën ekonomi. Më tej, subjekti ka vijuar të kërkojë mospërfshirjen e shumës 30.000 euro në analizën financiare për vitin 2010, shumë kjo e deklaruar si gjendje *cash* po në këtë vit nga bashkëshorti i saj.

¹³⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

33.34 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, konkludon se pretendimi i subjektit për korrigjim të të ardhurave vjetore të përfituara nga bashkëshorti për vitet 2010 - 2012 nga aktiviteti i noterisë, duhet të merret në konsideratë. Në këtë drejtim, u konstatua se Zyra Rajonale Tatimore Korçë ka kryer kontroll tatimor në aktivitetin e noterisë së bashkëshortit të subjektit dhe ka korrigjuar xhiron për vitet 2010 - 2012. Ky korrigjim ka konsistuar në rritjen e xhiros për këto vite, konkretisht: 231.000 për vitin 2010; 469.000 lekë për vitin 2011; dhe 528.500 lekë për vitin 2012. Ky ndryshim dhe korrigjim i xhiros së aktivitetit të noterisë, për sa kohë provohet sipas akt kontrollit, vlerësohet se duhet përfshirë e gjithë shuma si fitim/e ardhur, pasi shpenzimet e aktivitetit nuk ndryshojnë.

33.35 Lidhur me pretendimin e subjektit për ulje të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi Komisioni bazohet në standardin e konsoliduar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

33.36 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të mospërfshirë shpenzimin vjetor prej 400 euro për kartonin jeshil, pasi automjeti i bashkëshortit është i regjistruar në shtetin bullgar për shkak të shtetësisë së tij bullgare, Komisioni vlerësoi marrjen në konsideratë të këtij pretendimi për faktin se edhe nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga AMF nuk rezultoi blerja e kartonit jeshil për udhëtimet jashtë vendit për periudhën objekt hetimi 2010 – 2011.

33.37 Pas ripërlllogaritjeve të kryera në analizën financiare, duke pasqyruar pretendimet e marra në konsideratë, balanca negative mbetet vetëm për vitin 2011 në vlerën 99.363 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se kjo balancë negative është e pamjaftueshme për t'u kualifikuar si shkak autonom, për të konsideruar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

33.38 Lidhur me analizën financiare për shumën e kursyer prej 1.000.000 lekësh, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*

33.38.i Nga verifikimi i kryer, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur gjendje *cash* me kursime në fund të vitit 2016, vlerën 400.000 lekë. Ndërsa, në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting*, 30.1.2017, bashkëshortët kanë deklaruar shumën 1.000.000 lekë. Pra, shuma e shtuar është 600.000 lekë. Meqenëse bashkëshorti i subjektit ushtron aktivitet privat *** është e pamundur të identifikohet saktësisht gjendja e arkës së aktivitetit në datën 30.1.2017. Por, nga hetimi rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 400.000 lekë në datën 27.1.2017 nga llogaria e tij në BKT. Të ardhurat e përfituara nga pagat, fitimi i mundshëm nga aktiviteti i noterisë, si dhe të ardhurat e qirasë së karburantit (brenda muajit janar 2017 janë likuiduar 765.000 lekë) krijojnë bindjen se bashkëshortët kanë pasur mundësi të kursejnë shumën e deklaruar.

34. Lidhur me deklaratimet e tjera të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në rubrikën "të dhënat konfidenciale"¹³⁸, trupi gjykues ka arsyetuar dhe konkluduar më sipër në këtë vendimmarrje dhe për këtë shkak çmon të mos bjerë në përsëritje.

¹³⁸ Kontratë nr. ***, datë 5.10.2012, për kredi bankare afatgjatë; bashkëpronësi me shtetasin E.G në pasurinë e bashkuar nr. ***, truall me sip. 720 m² dhe objekt mbi të prej 110 m². Pjesë e bashkëpronësisë prej ½ dhënë në përdorim pa kundërshtim bashkëpronarit E.G, për një afat 3-vjeçar; kontratë datë 1.1.2013, nr. *** rep., datë 8.2.2014. Pjesë e bashkëpronësisë prej ½ dhënë më pas me qira shoqërisë "****" sh.p.k., me ortak të vetëm E.G; kontratë datë 3.1.2015, nr. *** rep., datë 29.3.2016; deklaratë midis shitëseve të pasurisë nr. *** (N.K dhe bashkëshortja e tij M.K), si dhe blerëseve J.GJ dhe E.G; deklaratë noteriale e prindërve GJ.GJ dhe T.GJ për dhënien e një shumës 25.000 euro me rastin e martesës nga pensionet e përfituara në shtetin grek si homogjenistë; kontratë hipotekimi për garantimin e shlyerjes së kredisë bankare prej 10.000.000 lekësh marrë me bashkëshortin, me hipotekues vëllai J.GJ. Pasuria e venë në hipotekë nr. ***, apartament me sip. 86.95 m² dhe pasurinë

Gjetje të tjera të rivlerësimit për kriterin e pasurisë

35. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike¹³⁹ si AMF, Policia e Shtetit për hyrje-daljet, Ministria e Drejtësisë për regjistrin noterial, nuk kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje në TIMS me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkuara pranë noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit, përveçse atyre të identifikuara gjatë hetimit. Për pronësinë e mjeteve me të cilat bashkëshorti i subjektit rezulton të ketë dalë jashtë territorit të vendit, Komisioni ka pyetur¹⁴⁰ subjektin lidhur me pronarët e automjeteve dhe njëkohësisht ka mbajtur korrespondencë me SPAK lidhur me shtetasit e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit.

36. SPAK¹⁴¹, në përgjigjen e përcjellë, informon se nga verifikimet nuk rezulton ndonjë procedim penal në emër të shtetasve të kërkuar.

37. Meqenëse rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtin trung familjar me familjarët e saj deri në datën e martesës, Komisioni vlerësoi të kryejë një analizë financiare për periudhën 1995 – 24.5.2010, për familjen e origjinës së subjektit, edhe sepse familjarët¹⁴² e saj kanë pasur investime të tipit blerje, ndërtime dhe shitje pasurish të paluajtshme. Analiza financiare është kryer për të gjithë periudhën e marrë së bashku.

37.1 Komisioni ka kryer hetim të thelluar për familjarët e subjektit, si dhe i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion justifikues¹⁴³.

37.2 Nga hetimi rezulton se vëllai i subjektit, shtetasi R.Ç, ka ushtruar aktivitet privat që prej vitit 2003. Subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues, por kjo konfirmohet edhe nga hetimi i Komisionit, ku DRT-ja Korçë, me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2022, informon se R.S.Ç është administrator i subjektit “R.Ç”, person fizik, me NIPT ***, me aktivitet mobileri, për periudhën 2.6.2003 e në vazhdim. Kjo drejtori ka përcjellë informacion për fitim/humbje të realizuar nga viti 2009 e në vazhdim, si dhe informon se subjekti ka deklaruar dhe ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore brenda afateve ligjore.

37.3 Subjekti ka depozituar dokumentacion për të ardhurat e familjarëve të përfituara nga puna, si dhe investimet që kanë ata kryer. Rezulton se vëllai dhe babai i subjektit kanë blerë disa pasuri të paluajtshme. Gjithashtu, babai i subjektit ka ndërtuar një objekt 2+2 kate sipas lejeve përkatëse të ndërtimit dhe më pas i ka shitur ato.

37.4 Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur të gjitha të ardhurat, investimet dhe shpenzimet e familjes së origjinës së subjektit. Pavarësisht se DRT-ja Korçë informon se vëllai i subjektit ka ushtruar aktivitet që prej vitit 2003, Komisioni ka përfshirë në analizë të ardhura nga aktiviteti prej vitit 2009, pasi në këtë vit ka informacion për fitimin e realizuar. Edhe pse nga hetimi rezulton se në llogaritë bankare të vëllait të subjektit likuidohen fatura shërbimesh nga institucione shtetërore, me përshkrimin përkatës të numrit të faturës dhe

nr. *** me sip. 69.63 m², apartament i ndodhur në Bilisht, Devoll; kontratë noteriale nr. ***, datë 5.10.2012. Kontratë hipotekimi për garantimin e shlyerjes së kredisë bankare prej 10.000.000 lekësh marrë me bashkëshorten, me hipotekues J.GJ. Kredi e marrë me bashkëshorten deklaruar se nuk është përdorur për blerje shtëpie, por është parapaguar tërësisht shitësit N K në shumën 9.800.000 lekë për blerjen e dy pasurive në Bilisht, pasuri e bashkuar nr. *** truall, me sip. 720 m², ndërtesa me sip. 110 m² dhe ndërtesë (përshtatur si bar-kafe e karburant) në proces legalizimi. Transfertë nga “Procredit Bank”, dega Korçë, datë 11.10.2012.

¹³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.1.2020, nga AMF; shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

¹⁴⁰ Pyetësor nr. 4, datë 21.9.2022.

¹⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2022;

¹⁴² Pavarësisht se bazuar në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar, familja e origjinës së subjektit (prindërit, vëllai dhe familja e tij) nuk ka pasur detyrimin ligjor për të kryer deklaram periodik.

¹⁴³ Referohuni pyetësorit nr. 2, datë 13.7.2022, dhe dokumentacionit mbështetës për të ardhurat dhe investimet e familjarëve.

datën e lëshimit të tyre, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë ato të ardhura, për sa kohë që nuk mund të identifikojë shpenzimet e aktivitetit dhe fitimin *neto* të realizuar.

37.5 Analiza financiare e pasqyruar në tabelën e mëposhtme ka rezultuar pozitive dhe, në kushte të tilla, Komisioni nuk konstatoi ndonjë të dhënë apo *indicie* që ndikon në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit apo që të mund të impaktojë të dhëna financiare apo pasuri të hetuara ndaj subjektit dhe bashkëshortit të saj.

Tabela nr. 7

Nr.	Përshkrimi	1995 – 24 maj 2010
1	Të ardhura	39,249,390
	Të ardhura nga pensioni, babai	1,101,491
	Të ardhura nga pensioni, nëna	550,079
	Të ardhura nga paga dhe aktiviteti, vëllai	1,624,344
	Të ardhura nga paga, kunata	1,809,976
	Të ardhura nga shitja e pasurive	12,113,500
	Kredi “ProCredit” ¹⁴⁴ 8.7.2004	2,500,000
	Kredi “ProCredit”, 13.2.2006	3,000,000
	Kredi “ProCredit”, 26.2.2007	5,000,000
	Kredi RFZ ¹⁴⁵ , 9.5.2007	820,000
	Kredi BKT ¹⁴⁶ , 9.10.2007	5,000,000
	Kredi BKT, 17.10.2008	5,730,000
2	Shpenzime	22,373,362
	Shpenzime jetese (1995 - 1999) 40% e të ardhurave ¹⁴⁷	49,487
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së (2000 - maj 2010)	6,986,317
	Shpenzime kredie “ProCredit” 2004 (principal + interes)	3,053,800
	Shpenzime kredie “ProCredit” 2006 (principal + interes)	3,929,900
	Shpenzime kredie “ProCredit” 2007 (principal + interes)	4,861,900
	Shpenzime kredie RFZ 2007 (principal + interes)	630,018
	Shpenzime kredie BKT 2007 (principal + interes)	1,730,205
	Shpenzime kredie BKT 2008 (principal + interes)	1,131,735
3	Pasuri	15,447,287
	Blerje automjeti *** ¹⁴⁸	472,162
	Blerje automjeti ***	398,207
	Blerje apartamenti	1,400,000
	Blerje truall + shtëpi	6,952,239
	Ndërtimi objektit 2+2 kate	4,800,000
	Blerje trojesh	1,000,000
	Blerje depo drithi	345,610
	Banka (maj 2010) ¹⁴⁹	79,069
	Mundësia për kursim (1-2-3)	1,428,741

¹⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 1.7.2022.

¹⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2022.

¹⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2022.

¹⁴⁷ Sipas vendimit nr. ***, datë 18.6.2021, të Kolegjit.

¹⁴⁸ DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2022.

¹⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2022, nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr.*** prot., datë 27.6.2022, nga “Tirana Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2022, nga “Alpha Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 1.7.2022, nga “ProCredit Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2022, nga BKT.

37.6 Në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konstaton se pasaktësitë në rivlerësimin e subjektit, janë të lidhura kryesisht me deklaratimet e bashkëshortit të saj për pasuri të krijuara para martesë të cilat nuk shoqërohen me mungesë burimesh të ligjshme, dhe se rrethanat e konstatuara në tërësi nuk vlerësohen nga trupi gjykues që pamundësojnë hetimin e tyre, apo se ato nuk janë të tilla që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të paligjshme, deklaratime të rreme apo fshehje të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, këto pasaktësi e rrethana konstatuese, çmohen nga trupi gjykues se nuk mund të ngrihen në nivelin e shkaqeve për cenimin e kriterit të pasurisë, apo të kenë pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit nr.84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

38. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, me nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar pjesërisht me vendimet nr.***, datë 27.10.2020, dhe nr. ***, datë 22.9.2022, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Etleva Gjamo.*

Hetimi i Komisionit

38.1 Komisioni i ka kërkuar DSIK-së¹⁵⁰ përditësimin e raportit të dërguar.

38.1.i Në vijim, DSIK-ja, në raportin e përditësuar dhe deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 22.9.2022, të KDZH-së, *konfirmon konstatimin fillestar për përshtatshmëri në vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Etleva Gjamo, si dhe shprehet se për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.*

38.1.ii Komisioni, pasi u njoh me raportin e DSIK-së, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, lexoi informacionin e plotë, kërkoi dhe administroi kopje të dosjeve gjyqësore civile-administrative të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit. Çështjet e gjykuara, pas verifikimit dhe analizimit të tyre, u vlerësuan të lidhura me kriterin profesional dhe pasqyrohen në vijim në këto rezultate hetimi, në seksionin e këtij kriteri nën titullin “Gjetje të tjera”.

38.2 Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk evidentoi rrethana të cilat mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit, sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) pas analizimit të çështjeve të trajtuara në drejtim të aspektit profesional për të cilat nuk rezultuan elemente të tilla të qenësishme, që mund të cenonin këtë kriter, si më poshtë arsyetohet në konkluzion për kontrollin e këtij kriteri – arrin në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së mbeten të paprovuara dhe se konstatimet e vlerësuara në kriterin profesional

¹⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2022.

nuk evidentuan elemente të tilla që mund të meritojnë një vlerësim që cenon këtë kriter apo vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt. Nën këto konstatime, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

38.3 Komisioni hetoi edhe mbi informacionin e autoriteteve verifikuese dhe mbi informacionin e lexuar nga kërkimi *online* në median e shkruar¹⁵¹ për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

38.3.i Komisioni administroi dosjet e përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nga aktet e administruara rezultoi se vendimi nr. ***, datë 20.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është ankimuar nga prokuroria pranë kësaj gjykate në datën 29.7.2016.

38.3.ii Mbi të dhënat e administruara, Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të japë shpjegime; (b) të saktësojë statusin e vendimit nr. ***, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; si dhe (c) të shpjegojë lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje në të njëjtin juridiksion ku ushtron edhe subjekti funksionin e saj. Njëkohësisht, subjektit iu kërkua edhe depozitimi i dokumentacionit mbështetës.

38.3.iii Në parashtrime subjekti ka sqaruar lidhur me çështjen penale ndaj bashkëshortit të saj si i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe lidhur me statusin ligjor të vendimit nr. ***, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke qartësuar se mbi ankim çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 23.2.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për pjesën që ajo gjykatë ka deklaruar të pafajshëm shtetasin J.GJ për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe ka vendosur “Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes ndaj shtetasit J.GJ për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në lidhje me kontratën afatmesme nr. ***, datë 21.11.2011”.

38.3.iv Lidhur me konstatimin e gjykimit të kësaj çështjeje në të njëjtin juridiksion ku subjekti ushtron funksionin, ajo ka sqaruar se në kohën e gjykimit të saj ka ushtruar detyrën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe për sa i takon mënyrës së administrimit të gjykimit të një çështjeje penale lidhur me kompetencën apo shkaqe të tjera që diktojnë ndryshimin e saj, ka prapësuar se ajo është e pavarur nga personi ndaj të cilit zhvillohet çështja (në rastin konkret bashkëshorti) dhe e pavarur edhe nga qenia e saj gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Kjo, për faktin se rregullat për përcaktimin e kompetencës së gjykimit parashikohen në Kodin e Procedurës Penale dhe kompetenca çmohet nga gjykata që gjykon çështjen. Po kështu, edhe në rast të prezencës së shkaqeve të tjera që diktojnë transferimin e një çështjeje penale, kërkesa bëhet nga prokurori sipas rregullave të nenit 94 e vijues të këtij Kodi.

38.3.v Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 23.2.2017, të Gjykatës së Apelit Korçë.

38.4 Trupi gjykues, pas verifikimit të dy vendimeve gjyqësore nr. ***, datë 20.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nr. ***, datë 23.2.2017, të Gjykatës së Apelit Korçë, konstaton se është vendosur pafajësi dhe pushim i çështjes ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal lidhur me të dyja rastet objekt hetimi.

38.5 Për sa më sipër, faktet dhe rrethanat e pasqyruara për çështjen objekt gjykimi, e cila është gjykuar edhe në shkallët më të larta të gjyqësorit, nuk pasqyrojnë *indicie* që mund të ndikojë në rivlerësimin e subjektit.

38.6 Për sa i përket analizimit të bërë nga subjekti lidhur me çështjen e juridiksionit të gjykimit të çështjes nga Gjykata e Rrethit Korçë, kur nën të njëjtin juridiksion gjykon edhe subjekti i

¹⁵¹https://www.faxweb.al/***

rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë: i) juridiksioni i çështjes është i parashikuar qartazi në Kodin e Procedurës Penale; ii) mosmarrëveshjen e juridiksionit e ngre gjykata, sipas nenit 73 të po këtij Kodi; iii) subjekti nuk ka qenë gjyqtare e të njëjtës gjykatë ku po gjykohej çështja ndaj bashkëshortit të saj; iv) apo nga gjykata nuk po gjykohej një çështje ndaj saj, e cila ligjërisht duhej transferuar në një tjetër gjykatë të rrethit më të afërt; v) vetë organi i akuzës nuk ka parashtruar kërkesë për transferimin e çështjes, sikurse e parasheh neni 94¹⁵² i Kodit të Procedurës Penale; vi) zhvillimi i gjykimit në këtë rast i kryer edhe nga gjykata më të larta, nuk ka shfaqur problematika për çështjen e kompetencës, në mbështetje të parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale nën titullin “*Juridiksioni dhe Kompetencat*”, nuk identifikon problematika në drejtim të rivlerësimit profesional të subjektit.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

39. Raporti¹⁵³ për analizimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

39.1 Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit; të dhënat e dokumentet që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së. Gjithashtu raporti i vlerësimit profesional është mbështetur edhe në:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

39.2 Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

39.2.i Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Rastet e vëzhguara tregojnë se subjekti ka shqyrtuar çështje gjyqësore që lidhen me anulimin e aktit administrativ me procedurat e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës kur i padituri është organ publik, si dhe me procedurat për të paguar vlerën e dëmit. Ajo është e qartë se vendimi gjyqësor në gjykatat administrative, krahas elementeve të përcaktuara në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të përmbajë

¹⁵² Shkaqet e transferimit (ndryshuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002): 1. Në çdo gjendje dhe shkallë të gjykimit, kur siguria publike ose liria e vullnetit të personave që marrin pjesë në proces cenohen nga situata të rënda lokale, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e gjykimit dhe që nuk mund të mënjahen në mënyra të tjera, Gjykata e Lartë, mbi kërkesën e motivuar të prokurorit pranë gjykatës që procedon ose të të pandehurit, ia transferon çështjen një gjykate tjetër.

¹⁵³ Nr. *** prot., datë 5.3.2019.

edhe elementet shtesë të kërkuara nga neni 41 i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjyqtarja Etleva Gjamo ka njohuri për parimet themelore të procesit gjyqësor administrativ dhe jo vetëm që i përdor gjatë gjykimit ato, por në arsyetimin e vendimit gjenden raste ku ajo ju referohet parimeve në zbatimin e ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Ajo i kushton rëndësi ligjit për “Emërimin dhe lirim të punonjësve të Drejtorisë së Policisë së Burgjeve”, kur objekti i padisë lidhet me shfuqizim i urdhrit për largimin nga policia dhe kundërshtim të aktit administrativ. Identifikon rastin kur duhet përdorur ligji specifik, për çështje qoftë materiale apo procedurale. Në ndonjë rast ajo ka përdorur edhe referenca në marrëveshje ndërkombëtare dhe në legjislacionin e posaçëm. Ajo ka përdorur referenca të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, si dhe i referohet qëndrimit të mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 1.7.2014, ku konkludohet se kryerja e punimeve në kundërshtim me specifikën kontraktore apo moskryerjen e punimeve nuk konsiderohen “të meta” dhe “vese” të punimeve të konstatuara nga KLSH-ja, pasi janë marrë në dorëzim. Ajo njeh dhe zbaton mirë parimin për procedurën tatimore, si dhe parimin e zgjidhjes së kontratës së punës, kur konflikti lidhet me të drejtat e punëmarrësit, si dhe parimin e detyrimit të gjykatës për të cilësuar saktë mosmarrëveshjen, kur kërkohet pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, aktit administrativ, ku një vend të veçantë në arsyetimin e vendimit zë ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”. Në një rast ajo ka përdorur në analizën e provave të paraqitura në seancën gjyqësore nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative, kur organi administrativ është kompetent në fushën që mbulon dhe nuk mund të ushtrojë të drejtat e një organi tjetër administrativ, pasi në thelb përbën cenim të parimit të ligjshmërisë dhe passjell pavlefshmërinë e aktit.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën administrative, ku bien në sy ligji “Për kundërvajtjet administrative”, instituti i së drejtës për t’u ankuar ndaj aktit, veprimet apo mosveprimet të një organi administrativ, e cila përbën një nga elementet e procesit të rregullt ligjor e sanksionuar dhe garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për kërkim dëmshpërblimi.

Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar 4 vendime, dokumenti ligjor nr. 1, për pavlefshmëri absolute anulim të akteve administrative është lënë në fuqi dhe 3 dosje, vendime të cilat janë lënë në fuqi

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fateve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Në disa raste, në përmbajtje të vendimit analizohen edhe çështje mbi juridiksionin dhe kompetencën, ndonëse këto çështje nuk janë kundërshtuar nga palët në proces dhe janë të konsoliduara në praktikën gjyqësore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Struktura e vendimeve të saj është e standardizuar. Ajo përmban në mënyrë të përgjithshme elementet e kërkuara nga legjislacioni procedural civil. Kështu, në pjesën hyrëse të dokumentit

janë shënuar gjeneralitetet e plota të palëve ndërgjyqëse, objekti i plotë dhe baza ligjore përkatëse. Pjesa arsyetuese hartohet me gjuhë të thjeshtë dhe me strukturë solide. Përmbajtja e vendimit përfundimtar i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Gjatë arsyetimit të vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Analiza ligjore është e thjeshtë, mjaftohet me tregimin e dispozitave ligjore të zbatueshme dhe me konkluzionin e zbatimit të tyre, duke përdorur fjali përgjithësuese.

Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, tregohet e drejta e ankimit për palët. Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin përfundimtar.

Subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat në asnjë rast nuk mungon shkaku ligjor.

39.2.ii Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit Etleva Gjamo, në periudhën e rivlerësimit 4.11.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Ajo ka deklaruar se për tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 2407 çështje dhe ka përfunduar si relatores 2125 prej tyre, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 201 çështje.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është subjekt ndaj së cilës zbatohet vendimi nr. ***, datë 14.4.2010, i ish-KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve, Aneksi 1, ‘Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore’”. Rrjedhimisht, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të këtij vendimi dhe të ligjit procedural për çështje të veçanta. Për aspektin sasior, sipas pikës 3, germa “c” e vendimit të ish-KLD-së, gjyqtari i gjykatës i seksionit administrativ ka jo më pak se 150 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative në vit. Rrjedhimisht, bazuar në të dhënat e mësipërme, mesatarja e gjykimit për subjektin Etleva Gjamo është 600 çështje administrative në tri vite. Rezultoi se gjyqtarja Etleva Gjamo e ka tejkaluar këtë standard, duke përballuar një volum mjaft të lartë pune.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 5 ditë, afati më i shkurtër, dhe në 9, ditë afati më i gjatë. Ndër 5 dosjet e vëzhguara nuk rezulton asnjë nga vendimet të jenë arsyetuar jashtë afatit ligjor.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo përgjithësisht është efektive në punë. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Etleva Gjamo i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në 4 raste afatet ligjore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Ajo ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e veprimeve përgatitore dhe ato gjyqësore, ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve pa vonesë nga sekretaria gjyqësore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht është konstatuar se gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Evidentohet vetëm dy raste që seancat nuk janë çelur: në njërin seancë gjyqtarja ka qenë në konferencë gjyqësore; dhe seanca tjetër ka përkuar me festë zyrtare. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor

të zhvilluar, si kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil. Në 5 dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

39.2.iii Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo konstatohet se ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 7.7.1995. Në datën 30.5.1998 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në vijim, në datën 4.11.2013 është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ku vazhdon edhe aktualisht. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuar të dhëna negative për etikën e gjyqtares. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Etleva Gjamo përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Etleva Gjamo. Për gjyqtaren Etleva Gjamo në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në 5 dosjet e vëzhguara subjekti ka disponuar me vendime të ndërmjetme, duke arsyetuar shkakun ligjor të tyre. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Etleva Gjamo të mos ketë respektuar rregullat procedurale.

39.2.iv Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte, 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Etleva Gjamo për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Duhet evidentuar se nuk ka pasur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi për shkaqe të

organizimit të trupit gjykues apo stafit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar me 3 gjyqtarë vetëm në 1 rast dhe në 4 rastet e tjera ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Në asnjë rast nuk është konstatuar vonesë në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari.

C/1. Rivlerësimi i aftësisë profesionale

40. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të miratuar nga KLGJ-ja;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

40.1 Në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe grupit të punës në raportin e tij të vlerësimit, në tërësi nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me gjykimin dhe procedurat gjyqësore të ndjekura nga subjekti, në të tria dokumentet ligjore të llojit vendim gjyqësor¹⁵⁴, si dhe në pesë dosjet gjyqësore¹⁵⁵ të përzgjedhura me short. U vërejt se vendimmarrjet e ankimuarra janë lënë në fuqi. Rezultoi se çështjet gjyqësore janë vënë në lëvizje brenda afatit 7-ditor, sikurse e parashikon neni 25/1 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe se në të gjithë rastet është disponuar me zbatimin e afatit 10-ditor për të depozituar pala e paditur prapësimet, kërkimet për pyetjen e dëshmitarëve, të ekspertit, konfirmimin e adresave të palëve në proces, etj.

40.2 Në lidhje me të dhënat nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren, subjektin e rivlerësimit, janë paraqitur 6 ankesa (1 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 4 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

Ankesat (1 e vitit 2014 dhe 2 të vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Ankesa e vitit 2015, pas verifikimit, bazuar në informacionin periodik ardhur nga kryetari gjykatës, është arkivuar, pasi pretendimet kanë rezultuar të pabazuara. Ndërsa, 2 ankesat e vitit 2016 i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik, ku njëra është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe ankesa tjetër bazuar mbi informacionin periodik, paraqitur nga kryetari gjykatës.

40.3 KLGJ-ja¹⁵⁶ nuk ka konfirmuar propozim/e për masë/a disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit përgjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

40.4 SPAK-u¹⁵⁷ nuk ka konfirmuar kallëzime apo procedime penale në emër të subjektit të rivlerësimit.

Gjetje të tjera

41. Komisioni administroi kopjen e dosjes gjyqësore¹⁵⁸, që i përket paditësit P.F.

¹⁵⁴ Vendimet nr. ***, datë 9.7.2014, nr. ***, datë 22.6.2015 dhe nr. ***, datë 29.1.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

¹⁵⁵ Që i përkasin: vendimit nr. ***, datë 1.6.2015, me objekt “kthim shume”, vendimit nr. ***, datë 18.7.2014, me objekt “deklarim i pasaktë i shënimeve në aktin dëftesë pjekurie”; vendimit nr. ***, datë 17.12.2015, me objekt “kundërshtim akti administrativ; vendimit nr. ***, datë 6.10.2015, me objekt “shpërblim dëmi për kontratë sipërmarrjeje”, vendimit nr. ***, datë 20.6.2014, me objekt “shfuqizim urdhri për zgjidhje të kontratës së punës dhe pasojave financiare”.

¹⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020.

¹⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2020, e administruar në informacionin e Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2020.

¹⁵⁸ Dërguar nga Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 17.6.2022.

Nga aktet e administruara rezulton se çështja administrative ka si palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, IEVP-në Korçë, me objekt gjyqësor “shfuqizim urdhri i largimit nga puna dhe pagesën e dëmshpërblimit me pagën e një viti”.

41.1 Çështja administrative është regjistruar në datën 12.4.2021 dhe ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.6.2021.

41.1.i Rezulton se çështja është vënë në lëvizje në datën 14.4.2021, nëpërmjet procesverbalit përkatës (i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe sekretarja gjyqësore), pra brenda afatit 7-ditor të përcaktuar në ligjin nr. 49/2012, i ndryshuar. Në dosje janë administruar njoftimet përkatëse për palën e paditur për zhvillimin e seancës përgatitore datë 4.5.2021, duke u lënë detyrat konkrete që pala ndërgjyqëse të depozitojë prapësimet, listën e personave që kërkohet të pyeten, etj., njoftime të cilat rezultojnë të konfirmuara nga pala e paditur. Njëkohësisht, në dosje është administruar edhe njoftimi i datës 4.5.2021, bërë palës së interesuar, Avokaturës së Shtetit, njoftim i konfirmuar nga kjo e fundit për mospjesëmarrje në gjykim, duke ia deleguar institucionit përkatës përfaqësimin në këtë gjykim edhe të saj/Avokaturës së Shtetit. Sipas procesverbalit të datës 4.5.2021, palët kanë konfirmuar marrjen dijeni të seancës, (Avokatura e Shtetit dhe DPBurgjeve), por nuk kanë paraqitur prapësimet. Në procesverbal është pasqyruar prezenca e palëve ndërgjyqëse, vendimmarrja për vijimin e procesit në mungesë të palëve ndërgjyqëse që kanë rezultuar të kenë dijeni, si dhe caktimi i seancës gjyqësore. Në seancën e radhës është pasqyruar konfirmimi i Avokaturës së Shtetit për mospjesëmarrje në këtë gjykim. Sipas procesverbalit të radhës rezulton se janë pasqyruar të gjitha hapat procedurale nga shpallja e trupës gjyqësore, prezenca e palëve, kërkesat paraprake për përfaqësim në gjykim, etj. Gjithashtu, në dosje janë administruar edhe konkluzionet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse, për të cilët është kërkuar koha e nevojshme për përgatitje dhe njëkohësisht vërehet se procesverbali gjyqësor ka pasqyruar këtë fakt dhe shtyrjen për këtë shkak. Gjykata, me vendimin e saj, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, shfuqizimin e urdhrin datë 17.2.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për largimin e paditësit nga policia e burgjeve si akt jo në përputhje me ligjin dhe detyrimin e palëve t'i paguajnë paditësit një dëmshpërblim prej 10 pagash mujore dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera si të pabazuar në prova dhe në ligj.

41.1.ii Aktualisht çështja është në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit mbi ankimin e palës së paditur.

41.2 Për sa trajtuar më, sipër trupi gjykues nuk konkludon në shkelje të kryera nga subjekti me fokus favorizimin e palës paditëse, përkundër, konstatoi ndjekjen e rregullt të procedurës gjyqësore të çështjes objekt gjykimi. Nga ana tjetër, trupi gjykues nuk ka kompetencë të analizojë zgjidhjen e themelit të çështjes dhe as të zëvendësojë logjikën e subjektit.

42. Komisioni administroi kopje të dosjes gjyqësore¹⁵⁹ të gjykuar në vitin 2020, me palë paditëse “****” shpk, i paditur Inspektorati Sanitar Shtetëror/Inspektorati i Kontrollit të Shëndetit, me objekt “kundërshtim gjobe”. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, që i përket vendimit nr. ***, datë 30.9.2020, rezultoi se pala paditëse “****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor M.B, ka paditur ISHSH-në, dega Korçë, me objekt “shfuqizim vendimi gjobe”, datë 10.2.2019, vendim i lënë në fuqi edhe nga Komisioni i Ankimit në Tiranë. Çështja është regjistruar në datën 1.7.2020.

42.1 Nga aktet e dosjes rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet e duhura procedurale, duke nisur nga vendimmarrja e datës 2.7.2020 për lënien e një afati 5-ditor për plotësimin e të metave të padisë (depozitimi i ekstraktit të QKB-së) sipas nenit 21/1/b të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe njëkohësisht edhe bërjen e njoftimit përkatës palës paditëse.

¹⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 13.6.2022, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Gjithashtu, gjithnjë sipas akteve të administruara në dosjen objekt gjykimi, vërehet se janë mbajtur procesverbalet vijuese për vazhdimin e gjykimit pas plotësimit të të metave të padisë, si dhe është bërë njoftimi palëve ndërgjyqëse. Edhe në këtë çështje rezulton se Avokatura e Shtetit ka deklaruar mospjesëmarrjen në gjykim, duke i lënë ndjekjen e procesit juristëve të institucionit përkatës/palës së paditur (për shkak se vlera e padisë është nën vlerën e përfaqësimit të detyrueshëm). U konstatua se procesverbalet në çdo rast pasqyrojnë prezencën e palëve, vijimin e gjykimit në mungesë, kur është rasti, për shkak të marrjes dijeni të datës së seancës, arsytet e shtyrjes për një periudhë më të gjatë, sikurse është rasti ku është pasqyruar se kjo vjen si pasojë e lejes së zakonshme, e cila kryet në muajin gusht. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur, pranimin e padisë duke shfuqizuar vendimin përfundimtar, datë 10.02.2020 që përmban dënimin me gjobë në shumën 300 000 lekë, si akt jo në përputhje me ligjin.

42.2 Në tërësi nga analizimi i kësaj çështje, trupi gjykues nuk konkludon në shkelje të kryera nga subjekti me fokus, favorizimin e palës paditëse, përkundër konstatoit ndjekjen e rregullt të procedurës gjyqësore të çështjes objekt gjykimi. Nga ana tjetër trupi gjykues nuk ka kompetencë të analizojë zgjidhjen e themelit të çështjes dhe as të zëvendësojë logjikën e subjektit.

C/2. Mbi denoncimet e paraqitura pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit. Në lidhje me 6 denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar si vijon:

43. Denoncim¹⁶⁰ i shtetasit E.T

43.1 Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejta në shkelje të procedurës ndaj subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi i është drejtuar gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë me dy padi. Në njërin ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Disiplinës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, si akt relativisht i pavlefshëm, rikthimin në pozicionin e punës, si dhe detyrimin e palës së paditur për t'i paguar paditësit pagën *bruto* nga momenti i largimit deri në momentin e kthimit në detyrë. Në padinë e radhës denoncuesi ka kërkuar detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, për t'i paguar paditësit pagën për orët shtesë në punë, si dhe dëmshpërblim moral dhe material. Denoncuesi ka depozituar dy vendimet përkatëse. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 11.11.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë së parë, ndërsa me vendimin nr. ***, datë 29.12.2017, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë vetëm për pagesën e orëve shtesë, ndërsa rrëzimin për pjesën tjetër të objektit të padisë.

43.2 Denoncuesi ankohet se në vendimmarrjen e parë subjekti nuk është shprehur për të gjithë kërkimin e objektit të padisë. Gjithashtu, ai i sheh të ndërvarura këto dy padi dhe në këtë drejtim ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarës nga çështja e dytë, ndërsa rezulton se kërkesa për përjashtim nuk është pranuar sipas vendimit nr. ***, datë 1.3.2017, marrë nga një tjetër subjekt.

43.3 Nga verifikimi i akteve të depozituara vërehet se subjekti në padinë e parë, duke qenë se ka vendosur rrëzimin e saj, ka ezauruar të gjithë kërkimin e objektit, ndërsa në vendimin e dytë, ku ka vendosur pranimin e pjeshëm, ka ezauruar, pra është shprehur edhe për rrëzimin për pjesën e mbetur të padisë.

43.4 Në të tilla kushte, trupi gjykues konkludoi se nuk qëndrojnë pretendimet e denoncuesit.

44. Denoncim¹⁶¹ i shtetasit F.M

44.1 Denoncuesi ankohet se gjyqtarja nuk merr në gjykim provat e paraqitura prej tij, por i referohet dokumenteve të hipotekës, të cilat i quan të falsifikuara. Denoncuesi sqaron se ka

¹⁶⁰ Nr.*** prot., datë 22.6.2018.

¹⁶¹ Nr. *** prot., datë 26.12.2018.

kërkuar sigurimin e padisë për pronën e pretenduar prej tij, por kërkesa i është rrëzuar. Ai nuk ka depozituar prova në mbështetje të denoncimit.

44.2 Nga të dhënat që prezanton denoncuesi, Komisioni konkludoi se çështja është në gjykim dhe se problematika që ai parashtron ka të bëjë me themelin e çështjes, me marrjen e provave për shqyrtim, etj. Në të tilla kushte, Komisioni nuk ka tagrin të vijojë trajtimin e saj.

45. Denoncim¹⁶² i shtetases V.L

45.1 Denoncuesja ankohet për vendimmarrje të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me padinë e ngritur prej saj për shkak të një ndërtimi, sipas saj të paligjshëm, i cili kryhej pranë banesës ku banonte. Denoncuesja pretendon se leja e ndërtimit për kryerjen e ndërtimit e dhënë nga Bashkia Korçë ka qenë në kundërshtim me ligjin dhe për këtë fakt ajo e ka kundërshtuar atë, me pretendimin se ndërtimi prish trashëgiminë kulturore. Denoncuesja pretendon se është shtyrë data e shpalljes së vendimit me pa të drejtë dhe se nuk është konsideruar aktekspertimi.

45.2 Denoncuesja ka depozituar disa dokumente dhe njëkohësisht ka konfirmuar se ka ushtruar ankim ndaj vendimit të shkallës së parë. Dokumentacioni i depozituar pasqyron korrespondencën e mbajtur nga ndërtuesit me institucionet publike, aktekspertimin, vendimin gjyqësor të subjektit të rivlerësimit nr. ***, datë 18.12.2018, sipas të cilit është vendosur rrëzimi i padisë së denoncueses me cilësinë e paditëses, si i pabazuar në prova dhe ligj.

45.3 Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion lidhur me pretendimin në tërësi të denoncueses, dhe kryesisht lidhur me ankesën e saj, se data e shpalljes së vendimit ishte shtyrë pa të drejtë.

45.4 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka sqaruar se në çështjen e ngritur prej saj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, të regjistruar në datën 20.12.2017 nga paditësja, është kërkuar edhe “Sigurimi i padisë për pezullim të zbatimit të lejes së ndërtimit”, miratuar me vendimin nr. ***, datë 9.5.2017, të KRRT-së Bashkia Korçë, në favor të të paditurit N.R. Kjo kërkesë është rrëzuar prej saj me vendimin datë 26.12.2017, pasi është vlerësuar se në momentin e paraqitjes së kërkesës subjekti në favor të të cilit ishte dhënë leja kishte përfunduar ndërtimin dhe në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kishte punime për të cilat gjykata të vendoste pezullimin e tyre deri në zgjidhjen e çështjes, duke konstatuar se paditësja nuk rezultoi që ta kishte ushtruar një të drejtë të tillë gjatë zbatimit të lejes së ndërtimit dhe kryerjes së punimeve, me qëllim që gjykata të çmonte kërkesën në përputhje me rrethanat faktike dhe gjendjen e punimeve që pretendonte se cenonin të drejtën e saj të pronësisë. Subjekti ka sqaruar kryerjen e veprimeve të tjera si, dëgjimin e parashtrimit të palëve, marrjen dhe shqyrtimin e provave, marrjen e provës me ekspert nga lista e ekspertëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, shqyrtimin e aktekspertimit, diskutimet e palëve, etj.

45.5 Subjekti ka sqaruar edhe mbi pretendimet e ankueses lidhur me aktekspertimin, për të cilin ka bërë vlerësimin e tij në raport me provat e tjera të shqyrtuara në arsyetimin e vendimit, duke shqyrtuar ligjshmërinë e pretendimeve të palës paditëse sipas natyrës se kërkimeve të saj të parashtruara në padi dhe gjatë gjykimit dhe në përputhje me parimin e nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe për aq sa kërkohet. Paditësja ka pretenduar pavlefshmërinë absolute të vendimit për dhënien e lejes dhe në këto raste gjykata e ka përqendruar analizën e saj në vendimmarrje brenda kuadrit të pavlefshmërisë absolute të pretenduar. Po kështu, edhe sa i takon pretendimeve të paditëses se leja ishte në kundërshtim me ligjin, subjekti ka sqaruar se ka konstatuar dhe arsyetuar se është dhënë leje për “rikonstruksion” dhe jo ndërtim të ri, siç ajo ka pretenduar, dhe po kështu ka

¹⁶² Nr. ***prot., datë 25.2.2019.

arsyetuar duke referuar në kuadrin ligjor për rastet e zonave historike dhe të mbrojtura monument kulture, ku respektohen distancat e tipologjisë arkitektonike në zonë.

45.6 Subjekti, lidhur me pretendimin tjetër të denoncuesit: (a) ka qartësuar ndjekjen e procedurës së mbylljes së procesit gjyqësor, konform nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka sqaruar se në kushtet kur të tre palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit kanë kërkuar kohë për të formuluar pretendimet përfundimtare me shkrim, gjykata ka pranuar kërkesën, konform nenit 34/6 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke caktuar seancën tjetër për depozitimin e konkluzioneve, ku në të ciblën palët i kanë depozituar konkluzionet me shkrim; (b) ka sqaruar natyrën komplekse të çështjes, si dhe ngarkesën që ka pasur, pas të cilave ka çmuar të ushtrojë të drejtën e parashikuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: *“1. Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. 2. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë”*.

Subjekti ka deklaruar se shpallja e vendimit është caktuar për në datën 14.12.2018, ora 10:15, ku në këtë seancë i padituri N.R, i datëlindjes 1938, është paraqitur vetë pa praninë e avokatit të tij O.M, për të cilin ai relatoi mosparaqitjen për arsye shëndetësore, si dhe ka pretenduar se ka probleme me dëgjimin dhe nuk mundet të kuptojë atë çfarë do të thotë gjykata.

Ndodhur përpara kësaj situate të paparashikuar, ajo ka vlerësuar se për të garantuar një proces të rregullt ligjor, gjykata duhet t’u japë mundësi palëve dhe të garantojë që të kuptojnë atë çfarë ndodh gjatë një procesi gjyqësor dhe, për këtë arsye, ka pranuar kërkesën dhe ka shtyrë shpalljen e vendimit për në datën 18.12.2018, ku ka qenë prezent paditësja, i padituri dhe avokati i tij, ku në këtë datë është shpallur edhe vendimi.

45.7 Subjekti ka theksuar se bazueshmëria e vendimit shqyrtohet nga Gjykata Administrative e Apelit. Në mbështetje të deklarimeve subjekti ka depozituar procesverbalet¹⁶³ e seancave dhe kalendarin e gjykimeve të printuara nga sistemi.

45.8 Subjekti ka sqaruar se kjo dosje ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe gjykimi nuk ka përfunduar.

45.9 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe provave të depozituara, konstatoi se subjekti ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore në ndjekjen e këtij procesi gjyqësor. Po ashtu, nga procesverbalet e administruara konstatohet se përshkruhen të arsyetuara shkaqet e shpalljes me vonesë të vendimit gjyqësor, për shkak të një procesi të rregullt ligjor dhe, për pasojë, trupi gjykues konkludon se pretendimet e denoncueses nuk qëndrojnë dhe se nuk diktohen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.

46. Denoncim¹⁶⁴ i shtetasit P.XH

46.1 Denoncuesi ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor për një çështje pronësie për të kundërshtuar vlerën e shpronësimit të pasurisë së tij dhe truallit përkatës, duke paditur Bashkinë Korçë dhe Ministrinë e Zhvillimit Urban. Në ankim denoncuesi i kërkon Ministrisë së Drejtësisë të vëzhgojë rastin jo vetëm për gjyqtaren, por edhe për ekspertin, i cili sipas tij nuk e ka kryer aktekspertimin, e ka zvarritur bërjen e tij, ka shpërdoruar detyrën dhe se duhet t’i kthejë shumën e paguar për aktin. Në parashtrimin e tij qartëson për një proces gjyqësor të nisur në vitin 2015, duke vijuar të citojë: *“...ende deri sot në vitin 2016”*. Procesin nuk ka përfunduar, ndërsa konstatohet se denoncimi në Komision është depozituar në vitin 2019.

¹⁶³ Procesverbal seance datë 27.11.2018; procesverbal seance datë 6.12.2018; procesverbal seance datë 14.12.2018; procesverbal seance datë 18.12.2018; kalendarin e seancave datë 6.12.2018.

¹⁶⁴ Nr. *** prot., datë 21.8.2019.

46.2 Në tërësi, nga trajtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues nuk vërejtí fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.

47. Denoncim¹⁶⁵ i shtetases F.P

47.1 Denoncuesja ankohet për vendim të padrejtë dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Ajo ka qartësuar se themeli i çështjes është pjesë e ankimit, ndërsa pretendon për vendosjen e shpenzimeve gjyqësore të cilat, sipas saj, e kanë rënduar financiarisht. Ankuesja, së bashku me vajzat e saj, ka ngritur padi ndaj Komandës Mbështetëse pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me pjesëmarrjen edhe të Avokaturës së Shtetit, për shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror (dëm biologjik, moral, ekzistencial) ndaj shtetit, për shkak të vrasjes së ndodhur djalit të saj në vitin 2003, gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak. Më parë, sipas të dhënave të denoncueses, por edhe arsyetimin të vendimit gjyqësor, gjykata ka dhënë një vendimmarrje në favor të babait të të ndjerit për dëmin e shkaktuar dhe, në këto kushte, gjykata mbi këtë padi në vitin 2018, me vendimin nr. ***, datë 24.12.2018, ka vendosur rrëzimin e saj. Nga verifikimi i vendimit vërehet se është pasqyruar në dispozitivin e tij edhe detyrimi për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, sikurse parasheh neni 310 i Kodit të Procedurës Civile.

47.2 Në tërësi, nga trajtimi i këtij denoncimi, trupi gjykues nuk konkludoi në problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

48. Denoncim¹⁶⁶ i shtetasit K,J

48.1 Denoncuesi ankohet për qëndrim të kundërligjshëm të subjektit të rivlerësimit në vendimmarrjet e saj, pasi ka pasur më parë vendime gjyqësore të formës së prerë, nr. ***, datë 2.4.2015 dhe nr. ***, datë 24.7.2015, si dhe për paaftësi profesionale. Lidhur me pretendimet e tij, ai nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës. Denoncuesi ka sqaruar se vendimmarrjet kanë ardhur si rezultat i padive të ngritura për marrëdhënie punësimi për shkak të ristrukturimit të institucionit punëdhënës, Këshilli i Qarkut Korçë. Në tërësi, duket se denoncuesi ankohet për themelin e çështjes. Denoncuesi nuk jep të dhëna nëse ka ushtruar të drejtë ankimore.

48.2 Për sa më sipër, Komisioni¹⁶⁷ i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi pretendimet e denoncuesit, si dhe të depozitojë dokumentacionin justifikues.

48.3 Subjekti në parashtrime ka shpjeguar se gjykimet e zhvilluara prej saj datojnë prej viteve 2014 - 2019, pasi nga ana e tij janë ngritur një sërë padish që janë gjykuar jo vetëm nga ana e saj, por edhe nga gjyqtarë të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

48.4 Subjekti ka shpjeguar gjerësisht arsyet e inicimit të gjykimeve të cilat lidhen me marrëdhënien e punësimit që ka lindur ndaj denoncuesit për shkak të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Korçë, ka sqaruar historikun e proceseve të gjykuara prej saj, por edhe nga të tjerë subjekte.

48.5 Subjekti ka qartësuar se vendimmarrjet e saj janë të arsyetuara, janë gjykuar dhe janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa ka depozituar 8 vendime gjyqësore¹⁶⁸, ku denoncuesi është me cilësinë e paditësit apo të paditurit.

48.6 Trupi gjykues, në tërësi të trajtimit të këtij denoncimi, konstatoi se vendimmarrjet e subjektit (të pretenduara si të padrejta nga denoncuesi) kanë objekte të ndryshme gjykimi dhe se themeli i tyre i është nënshtruar procesit të gjykimit nga gjykatat e tjera të gjetura jo në

¹⁶⁵ Nr. *** prot., datë 15.11.2019.

¹⁶⁶ Nr. *** prot., datë 20.19.2019.

¹⁶⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁶⁸ Vendim nr. ***, datë 16.6.2014; vendim nr. ***, datë 07.12.2015; vendim nr. ***, datë 26.2.2016; vendim nr. ***, datë 16.3.2017; vendim nr. ***, datë 18.5.2017; vendim nr. ***, datë 23.11.2017; vendim nr. ***, datë 30.11.2017; vendim nr. ***, datë 16.4.2019.

kundërshtim me ligjin. Në tërësi, lidhur me këtë denoncim, nuk u vërejtën problematika të natyrës procedurale që të mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

49. Për sa u arsyetua më sipër, Komisioni, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “e aftë”.

Vlerësimi tërësor i çështjes

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

- Lidhur me kriterin e pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

- Lidhur me kriterin e figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.

- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko - profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Etleva Gjamo, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka

Firdes SHULI
Anëtare